



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
TË MBAJTUR MË 16 SHTATOR 2010**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 16. SEPTEMBRA 2010. GODINE**

**SHTATOR – SEPTEMBAR
2010**

E enjte, 16 shtator 2010, ora 10:00

Drejton seancën: kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministër, ministra të Kabinetit qeveritar,

Po i hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kemi numrin e nevojshëm të deputetëve për t'ia filluar seancës.

Ju njoftoj se në pajtim me nenin 15, paragrafi 3 dhe neni 42 të Rregullores së Kuvendit, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia paraqesim rendin e ditës për mbledhjen e sotme plenare.

Andaj, procedojmë sipas rendit të ditës.

Pika e parë e rendit të ditës:

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare, të mbajtur më 6 shtator 2010

Pyes, a keni vërejtje në këtë procesverbal? Nuk ka vërejtje. Konstatoj se Kuvendi miratoi Procesverbalin e mbledhjes plenare, të mbajtur më 6 shtator 2010.

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Interpelanca e kryeministrit të Kosovës, zotit Hashim Thaçi, sipas kërkesës së deputetit Emrush Xhemajli, mbështetur edhe nga disa deputetë të tjerë

Në pajtim me rregullat procedurale, deputeti Emrush Xhemajli dhe grupi i deputetëve nënshkrues kanë parashtruar kërkesë për ta ftuar në interpelancë kryeministrin e Kosovës, zotin Hashim Thaçi, lidhur me shkëputjen dhe rinegocimin e Marrëveshjes për sigurime shoqërore ndërmjet Zvicrës dhe Kosovës.

Në bazë të nenit 44 të Rregullores së Kuvendit, punimet e Kuvendit për shqyrtimin e një interpelance mund të zgjasin deri në 3 orë. Propozuesi i kërkesës për interpelancë ka në dispozicion 10 minuta në fillim të debatit dhe 5 minuta në fund të tij. Koha e diskutimit për kryeministrin është 15 minuta, nga koha e ndarë për pozitën. Kryeministri ia merr një kohë pozitës. Deputetët, pa grup parlamentar mund ta shfrytëzojnë të drejtën e fjalës deri në 2 minuta. Koha e mbetur ndahet proporcionalisht ndërmjet grupeve parlamentare. Kjo është Rregullorja e Punës që e kemi miratuar në këtë Kuvend.

Ftoj deputetin Emrush Xhemajli, që në emër të grupit të deputetëve nënshkrues dhe në cilësinë e propozuesit, para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë kërkesën për interpelancë.

EMRUSH XHEMAJLI: I nderuar kryetar i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi,

I respektuari kryeministër, zoti Hashim Thaçi,

Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë dhe qytetarë të Republikës së Kosovës që jeni apo keni punuar në Zvicër,

Duke iu përgjigjur shqetësimeve të qytetarëve të Republikës së Kosovës që punojnë apo kanë punuar në Zvicër, në bazë të Rregullores së Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, neni 44.1 lidhur me interpelancat, ne një grup prej 32 deputetësh kemi kërkuar këtë interpelancë lidhur me prishjen dhe rinegocimin e Marrëveshjes për sigurimet shoqërore ndërmjet Zvicrës dhe Kosovës.

Me qenë se çështja për të cilën po flasim lidhet me disa ministri, atë të Punëve të Jashtme, Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, me Ministrinë e Shëndetësisë, të Administratës, atë të Integritetit, kemi thirrur në interpelancë kryeministrin e Republikës së Kosovës, zotin Hashim Thaçi.

Të nderuar pjesëmarrës në këtë seancë,

Më 1 prill 2009, Enti Federal i Sigurimeve Shoqërore njoftoi se nga 1 prill 2010 nuk do të vazhdohet më Marrëveshja për sigurimet shoqërore ndërmjet Zvicrës dhe ish –Jugosllavisë, në raport me Kosovën.

Përmes një note për këtë masë, Zvicra kishte paralajmëruar Kosovën që nga dhjetori i vitit 2009. Arsyeja e parë zviceran për vendimin e tillë është se marrëveshja në fjalë nuk i përgjigjet më legjislacionit aktual të dy shteteve. Sidoqoftë, duhet të qartësohet se vendimi i Qeverisë zvicerane nuk është diskriminues, sepse është në pajtim me rregullat e marrëveshjeve ndërkombëtare ndërshtetërore dhe ligjet e Zvicrës, por pasojat e kësaj gjendje janë të rënda.

Marrëveshja për sigurimet shoqërore ndërmjet Zvicrës dhe Kosovës e rregullon trajtimin e barabartë të shtetasve të dy vendeve në raport të legjislacionet e vendeve përkatëse.

Marrëveshja në fjalë rregullon edhe të drejtat për përfitime nga sigurimet shoqërore të shtetasve nëse kthehen në vendlindjen e tyre, duke siguruar kështu barazinë reciproke nga përfitimet dhe me këtë ajo definon gjithashtu edhe organet që marrin përsipër t'i zbatojnë dispozitat e ligjeve në të dy shtetet.

Me prishjen e marrëveshjes nga 1 prill 2010, nga ky vit, janë duke u dëmtuar mijëra qytetarë të Republikës së Kosovës, llogaritet të jenë të prekur rreth 170 mijë veta, të cilëve u takon pensioni i pleqërisë, pensioni invalidor, kompensimi nga fatkeqësitë, sigurimet shëndetësore. Gjithashtu, hiqet edhe e drejta për shtesat e fëmijëve për punëtorët, fëmijët e të cilëve kanë vendbanim në Kosovë. Këtu ka nevojë të sqarohet se në Zvicër aplikohet dhe funksionon sistemi i sigurimeve shoqërore ku ata që janë të përfshirë në ekonomi, punëdhënësit edhe punëmarrësit kontribuojnë që gjeneratat të mbajnë gjeneratat të tjera përmes arkave të sigurimeve ku kontribuuesit më vonë janë përfitues, ndërsa shteti ndërton rregullativën. Në rastin tonë bëhet fjalë për qytetarët e Kosovës që kanë kontribuar në këto arka të sigurimeve shoqërore, pra bëhet fjalë për marrjen e parave të veta, jo të buxhetit shtetëror zviceran nga këto arka ku i kanë dhënë më herët.

Arsyeja dhe qëllimi i këtij mocioni është që kjo çështje të bëhet një nga përparësitë e Qeverisë së Republikës së Kosovës, sepse rinegociimi i marrëveshjes është duke shkuar ngadalë dhe, e dyta, përmes mocionit të deputetëve Kuvendit të Kosovës do t'i jepet mundësia të japë rekomandimet e veta.

Rinegociimi i Marrëveshjes për sigurime shoqërore Zvicër – Kosovë në bazë të praktikave të ngjashme do të zgjasë shumë dhe këtu nuk po flasim për kohën, sepse ende nuk dihet sa. Është për t'u falënderuar puna e grupit të deputetëve në Parlamentin zviceran, në krye me deputetin Uli Lojen Berger, që ka bërë të mundur ngritjen e kësaj çështjeje në Bundesratin zviceran. Gjithashtu, është për t'u përshëndetur edhe puna e Sindikatës Unia në Zvicër, që mbron punëtorët e prekur nga prishja e kësaj marrëveshje, e cila me kohë ka ngritur zërin e saj.

Nga ana tjetër, dua të shfrytëzoj rastin të them se qytetarët e Republikës së Kosovës nuk duhet të bien pre e spekulatorëve dhe agjencive, të cilët gurbetçarët i informojnë gabim, me qëllim përfitimi se gjoja u bie mirë nëse i tërheqin mjetet nga arkat e sigurimeve të pleqërisë dhe të invaliditetit.

Përkundrazi, ata përgjithmonë e humbin të drejtën që të marrin mjete nga këto arka që janë të parapara të rriten bashkë me standardin jetësor në Zvicër. Qëllimi i vetëm i këtyre mashtruesve është marrja e 10% në shuma e këtyre mjeteve që shpesh janë shuma të mëdha.

Edhe një herë ju falënderoj dhe u thërras që të diskutojmë së bashku dhe në fund të nxjerrim rekomandime. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Ftoj kryeministrin e Kosovës, zoti Hashim Thaçi, që ta marrë fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuar kryetar Krasniqi,

I nderuar deputet Xhemajli,

Të nderuar deputetë,

Mbrojtja shëndetësore dhe sociale janë fushat të cilat Qeveria e Republikës së Kosovës i ka gjithmonë në listën e vet të prioritetëve. Këto të drejta janë përfshirë në kapitullin e dytë edhe të Kushtetutës, ku janë rregulluar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Sipas normave kushtetuese, edhe sigurimi social edhe përkujdesja shëndetësore rregullohen me ligje të veçanta. Kur janë në pyetje të drejtat e qytetarëve të Republikës së Kosovës të punësuar edhe jashtë vendi, çështja e sigurimeve shoqërore rregullohet me konventa ndërkombëtare të kësaj fushe, përkatësisht me marrëveshje ndërshtetërore të lidhura ndërmjet shteteve.

Në rastin konkret të çështjes së ngritur nga deputeti Xhemajli, të ngritur shumë drejt, të drejtat e të punësuarve shtetas të Republikës së Kosovës në shtetin e Zvicrës kanë qenë të rregulluara me Marrëveshjen bilaterale për sigurimet sociale të lidhura ndërmjet Qeverisë zvicerane dhe ish-Federatës Jugosllave në vitin 1962.

Marrëveshja për sigurimet sociale e lidhur ndërmjet Zvicrës dhe ish- Jugosllavisë, në raport me Kosovën, rregullonte trajtimin e barabartë të shtetasve të dy vendeve në raport me legjislacionet shtetërore apo kombëtare.

Përveç detyrimeve ligjore, marrëveshja në fjalë rregullon edhe të drejtat për përfitimin nga sigurimet sociale të shtetasve nëse kthehen në vendlindje, duke siguruar kështu barazinë reciproke nga përfitimet dhe ... gjithashtu edhe organet kompetente që zbatojnë dispozitat e ligjeve në të dy shtetet.

Në dhjetor të vitit 2009, Këshilli Federal i shtetit të Zvicrës ka vendosur një marrëveshje ndërshtetërore, të cilat kanë qenë të lidhura në mes shtetit të ish- Jugosllavisë dhe Konfederatës zvicerane, të cilat ishin në fuqi në kohën e pavarësimit të shtetit të Kosovës, në mënyrë që të mos vazhdohen në raport me Kosovën.

Nga ky vendim, zbatimi i kësaj marrëveshje në raport me Kosovën përfundon më 31 mars 2010. Njëra prej arsyeve kryesore të ndërprerjes së kësaj marrëveshje, sipas informacioneve zyrtare të Ambasadës së Zvicrës në Republikën e Kosovës, është se legjislacioni i aplikueshëm në Kosovë nuk është plotësisht në harmoni me legjislacionin e aplikueshëm të shtetit të Zvicrës në këtë fushë.

Të nderuar deputetë,

Pasojat e ndërprerjes së kësaj marrëveshje janë se qytetarëve tanë u pamundësohet realizimi i së drejtës në pensionin e pleqërisë, pensionin familjar, invalidor, si dhe në shtesat për fëmijë, të cilët pas pensionimit vendosin që të jetojnë në Republikën e Kosovës. Fatmirësisht, ky numër nuk është aq i madh, ashtu siç prezantohet apo paraqitet nganjëherë në opinion, por realisht numri i të

kthyerë në Kosovë është mjaft simbolik. Përkundër kësaj, institucionet relevante të Republikës së Kosovës janë angazhuar dhe do të përkushtohen që kjo çështje të zgjidhet në kohë sa më të shkurtër e të mundshme edhe nëse është fjala vetëm edhe për një qytetar.

Që nga momenti i njoftimit lidhur me ndërprerjen e kësaj marrëveshje, Qeveria e Kosovës, përkatësisht dikasterët e saj kanë ndërmarrë hapa konkret për zgjidhjen e këtij problemi.

Të nderuar deputetë,

Në shkurt të këtij viti ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale ka zhvilluar një takim me ambasadorin e Zvicrës në Prishtinë, ku është diskutuar në lidhje me vendimin e Qeverisë zvicerane si dhe mundësinë e gjetjes së një zgjidhjeje për këtë çështje. Kam qenë i angazhuar dhe personalisht me autoritetet zvicerane, me të cilët kemi diskutuar për tejkalimin e kësaj gjendjeje dhe jemi në rrugë të mbarë. Gjatë këtyre takimeve ramë në dakord që të formohet një grup teknik nga Kosova, nga shteti i Kosovës për të zhvilluar kontakte me qëllim të arritjes së një marrëveshje konkrete ndërmjet shtetit të Kosovës dhe Zvicrës. Pas këtyre takimeve, në kuadër të Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale është formuar grupi teknik profesional për negocimin e një marrëveshje të re ndërmjet dy vendeve.

Të nderuar deputetë,

Në të njëjtën kohë, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme, në mënyrë zyrtare i është proceduar një notë verbale Ambasadës së Zvicrës, më 6 maj 2010, përmes së cilës kjo ambasadë është informuar për përbërjen e grupit teknik të palës shtetërore kosovare, si dhe është kërkuar që sa më parë të caktohet takimi ndërmjet përfaqësuesve të dy shteteve.

Në funksion të realizimit të kërkesës sonë, pala zvicerane përmes Ambasadës së Kosovës në Bernë të Zvicrës ka caktuar datën e mbajtjes së takimit të parë ndërmjet përfaqësuesve të dy vendeve. Takimi i delegacionit është mbajtur, më 1 dhe 2 shtator 2010 në Bernë të Zvicrës. Gjatë këtyre takimeve është shkëmbyer informacioni nga fushat e sigurimeve sociale të dy shteteve dhe me legjislacionin aktual që e rregullon edhe këtë sferë. Pas takimeve të zhvilluara në Bernë, ministrinë përkatëse të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe organet përkatëse shtetërore të Zvicrës janë në vazhdimësi duke punuar në shkëmbim të informacioneve në fushën e sigurimeve shoqërore.

Zyrtarë zviceranë në vazhdimësi janë në kontakt me zyrtarët e Qeverisë së Republikës së Kosovës për shkëmbimin e informacioneve dhe të përvojave. Me qenë se mospërputhja e legjislacionit të dy vendeve është njëra prej arsyeve kryesore të ndërprerjes së kësaj marrëveshje, në kuadër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, përkatësisht të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale janë ndërmarrë masa konkrete për krijimin e legjislacionit adekuat të sigurimeve sociale.

Në përfundim e sipër është drafti final i Projektligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti i Kosovës. Po ashtu, në kuadër të strategjisë legjislative të vitit 2010 është i përfshirë edhe Projektligji për Fondin Pensional në Republikën e Kosovës.

Drafti fillestar i këtij projektligji është përgatitur në bashkëpunim me specialistët e Bankës Botërore dhe të Bankës Qendrore të Kosovës. Sipas parashikimeve, këto dy akte ligjore gjatë muajit nëntor dhe dhjetor nga Qeveria e Kosovës do të procedohen në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Qeveria e Republikës së Kosovës do të vazhdojë t'i kryejë të gjitha obligimet e veta në raport me palën zvicerane për t'ju mundësuar qytetarëve tanë, bashkatdhetarëve tanë që t'i realizojnë të drejtat e tyre me ligj.

Si kryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Kosovës do të vazhdojë që të mbikëqyrë, edhe unë personalisht, përmbylljen e suksesshme të marrëveshjeve bilaterale me shtetin zviceran, në një afat sa më të shkurtër kohor. Ju faleminderit shumë!

Drejtimin e mbledhjes e merr anëtarë i Kryesisë, zoti Ibrahim Gashi

KRYESUESI: Faleminderit, zoti kryeministër!

Kalojmë te përfaqësuesit, përkatësisht kryetarët e grupeve parlamentare dhe deputetët.

T'ju njoftoj se konform Rregullores së re, koha për diskutim është ndarë sipas madhësisë së grupeve parlamentare, si vijon: Për Grupin Parlamentar të PDK-së 40 minuta, Grupin Parlamentar i LDK-së, 30 minuta, Grupin Parlamentar të AAK-së, 18 minuta, Grupin Parlamentar i AKR-së, 14 minuta, Grupin Parlamentar i LDD-së 14 minuta, Grupin Parlamentar "7+" 10 minuta, Grupin Parlamentar SLS, 11 minuta, Grupin Parlamentar për Integrim, 10 minuta dhe deputetët pa grup parlamentar, nga 2 minuta.

Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, fjalën e ka deputeti Ramadan Avdiu.

RAMADAN AVDIU: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zoti kryeministër, zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Të respektuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës falënderon deputetin Emrush Xhemajli dhe grupin nënshkrues të këtij mocioni, përmes të cilit i kanë dhënë mundësi edhe Qeverisë edhe Kuvendit, të njoftojë Qeveria për hapat e ndërmarrë, por edhe opinionin e gjerë, veçanërisht bashkatdhetarët tanë, të cilët janë të prekur apo janë të privuar nga e drejta e tyre për realizimin e pensioneve invalidore dhe shtesave të fëmijëve të atyre, të cilët janë kthyer në Kosovë.

Vendimi i Qeverisë zvicerane natyrisht që i ka privuar nga e drejta një pjesë simbolike të bashkatdhetarëve tanë, po veçanërisht ata të cilët kanë gëzuar nga Zyra Federale për Sigurime Sociale dhe të drejtën e pensionit invalidor dhe janë kthyer në Kosovës, sikurse edhe bashkatdhetarët të cilët jetojnë, punojnë në Zvicër, por fëmijët i kanë në Kosovë e janë privuar nga shtesat e fëmijëve. Marrëveshja e nënshkruar me ish- Jugosllavinë ka qenë, do të thotë, në fillim të viteve 60-ta dhe natyrisht që janë bërë ndryshime, ndërrime të mëdha. Tani Kosova si shtet i pavarur është e detyruar që të vazhdojë dhe të negociojë në mënyrë që të nënshkruhet marrëveshje e re. Është për t'u përgëzuar dhe për t'u përshëndetur edhe puna edhe hapat e ndërmarr nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe ne si grup parlamentar inkurajojmë Qeverinë që me përpjekje të shtuara të harmonizojë dhe të rregullojë kornizën ligjore dhe ta harmonizojë pra kornizën ligjore që e mbulon këtë materie, sikurse edhe të përshpejtojë procesin e rinegocimit të marrëveshjes në mënyrë që bashkatdhetarët tanë t'i gëzojnë prestacionet financiare që u takojnë nga Zyra Federale për Sigurime Shoqërore në Zvicër.

Pra, edhe një herë ne do ta inkurajojmë dhe do ta nxisim Qeverinë që me përpjekje të shtuara të angazhohet në këtë drejtim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deputetja Nurisha Hula.

NURISHA HULA: Faleminderit, kryesues i Kuvendit!

Kabinet qeveritar, deputetë të nderuar,

Unë, së pari falënderoj Kryesinë e Kuvendit që na ka lejuar, respektivisht anëtarët e Komisionit Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, që në bazë të ftesës që na kanë bërë

Unioni i Sindikatave në Zvicër, ne kemi shkuar prej datës 10 gjerë më datën 14 dhe kemi zhvilluar aktivitete, respektivisht një seminar 2 ditor ku kemi marrë të gjitha informatat e duhura për të cilat nuk kemi pasur informata të plota, me qëllim që ne të kërkojmë këtu përmes Parlamentit dhe të sensibilizojmë Qeverinë, që çështja e mërgimtarëve tanë të rregullohet në nivel institucional. Do të thotë Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, gjithashtu Qeveria duhet të ngre Ministrinë e Mërgatës dhe ministri i kësaj ministrie duhet të jetë përfaqësuesi i mërgatës, me qenë se ne kemi miratuar Ligjin për mërgatën këtu në Parlamentin e Kosovës.

Ndërprerja e marrëveshjes për pensionet e mërgimtarëve tanë ka qenë një hap i ngutshëm, por kisha thënë që të mos flasim më për atë marrëveshje, por të shkojmë në drejtim të duhur ndërinstitutional, domethënë, ndërmjet Kosovës dhe rreth Zvicrës që të plotësohet infrastruktura ligjore. Ne e dimë të gjithë që ende nuk e kemi Fondin e sigurimeve shoqërore, nuk e kemi Ligjin për pensionet dhe Ligji i punës është në procedurë e sipër, prandaj kërkesë edhe e Unia-s së Sindikatës në Zvicër dhe takimit që kemi pasur me deputetët parlamentarë të Parlamentit të Zvicrës kërkohet infrastruktura e plotë ligjore, do të thotë, kjo pako e ligjeve që do të ngre edhe përmirësimin, respektivisht ngritjen e procedurës së krijimit të një marrëveshje të ndërsjellë ndërmjet institucioneve.

Qasje tjetër e rëndësishme ishte edhe ajo e pensioneve për të cilat në Kosovë duhet të keni vlerësime të sakta dhe për këtë ne nuk kemi pasur një mekanizëm profesional që do të vlerësonte çështjen drejt, statistikën e mërgimtarëve tanë që janë në Kosovë e që gëzojnë të drejtën e pensioneve të cilët kanë punuar dhe kanë dhënë kontributet e tyre në Zvicër, prandaj, edhe këtu duhet të ngritet një mekanizëm profesional që do të vlerësonte dhe do t'i identifikonte statistikën e sakta të mërgimtarëve tanë që janë këtu dhe që gëzojnë të drejtën e pensioneve dhe të bëhet ky vlerësim dhe në nivel institucional, do të thotë në nivel ministror të jepen të dhëna të sakta për të gjithë ata që gëzojnë të drejtën e pensionit që kanë punuar dhe që kanë dhënë kontributet në Zvicër.

Gjithashtu, ne kemi pasur një takim edhe me ambasadën tonë në Zvicër edhe aty ambasada, përfaqësuesit, respektivisht ambasadori kanë probleme financiare me qenë se buxheti është i ndarë, mirëpo nuk ndahen mjetet në kohë të duhur që ata t'i plotësojnë dhe t'i rregullojnë çështjet e tyre në ambasadë.

Prandaj, unë e përshëndes edhe Qeverinë që edhe kryeministri u deklarua se janë në procedurë çështjet, prandaj, do të ishte shumë e nevojshme që në mënyrë më të shpejtë të vihen marrëdhëniet ndërministrare që të ngritet kjo marrëveshje edhe pse kërkon procedurë të gjatë dhe kërkon një angazhim më të avancuar nga ana qeveritare.

Prandaj, unë shpresoj se së shpejti ne deri në fund të vitit 2010 do të kemi këtë pako të ligjeve dhe do të bëjmë vlerësimin e gjithë mërgimtarëve tanë, mund të bëhet edhe në nivel qeveritar, por edhe në nivele komunale, t'i identifikojnë në statistikën e tyre dhe t'i vlerësojnë dhe të bëjnë raportet dhe t'i dorëzojnë në nivel qeveritar për t'i dhënë vlerësimet që janë parakusht për ngritjen e një marrëveshje të rëndësishme për mërgimtarët tanë. Unë ju përshëndes dhe ju faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!

Lus regjinë që ta matë kohën e mbetur për secilën grup pas diskutimeve të para. Kalojmë te Grupi Parlamentar i AAK-së, fjalën e ka deputeti dhe shefi i Grupit, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryesues!
Zoti kryeministër,

Deputetë të nderuar të Kuvendit të Kosovës,

Punëtorët tanë, njerëzit tanë shkojnë në Zvicër për të punuar, për të gjetur punë, kanë shkuar në kohë, të cilat kanë qenë shumë të vështira për Kosovën. Arsyeja pse në Zvicër, është se Zvicra është një vend i cili ka mund të afrojë punë për qytetarët e vendit, domethënë, është një vend i zhvilluar e vendi i zhvilluar, do të thotë, vend i cili respekton rregullat, normat, datat, ku ka sundim të ligjit, fillimisht, përndryshe sikur të mos kishte qenë kështu, atëherë ndoshta edhe zviceranët kishin ardhur për të punuar te ne. Zvicra, një kohë të gjatë ka pasur qeveri të cilat, të paktën kanë parë çka ka rreth e rreth, të mos themi më tepër. Tani kur flasim për rregullat, domethënë e vetmja mënyrë për të pasur një vend të zhvilluar ekonomikisht, një vend ku njerëzit ndihen mirë, është mirë që të ketë rregulla, ligje dhe të respektohen ato ligje pikërisht prej shtetit fillimisht e më tutje prej individëve. Një farë fjale thotë:” nuk mund të ketë futboll të mirë aty ku kërcënohen referat”, nuk mundet edhe te ne të ketë rregulla të mira kur njerëzit që duhet për t’i mbrojtur ato kërcënohen, ndërsa të tjerët që janë mbi nuk e kanë as një pikë vullnet për t’i respektuar.

Tani, dy çështje më rënë në vesh fillimisht para se të kaloj te pjesa për të cilën dua të flas. Kryeministri i Kosovës tha që do të arrihet një marrëveshje, uroj që të arrihet marrëveshja dhe jam në favor të kësaj marrëveshje, mirëpo, para se të thotë se do të arrihet marrëveshja tha që problemi qëndron te mosharmonizimi i legjislacionit ndërmjet Kosovës dhe Zvicrës. Përderisa, kur foli për legjislacion nuk na tha se cilin ligj duhet ta ndryshojë Kosova, në mënyrë që të harmonizohet ky legjislacion, me qenë se problemi qenka legjislacioni. Kryeministri, të paktën nëse problemi është legjislacioni, ka qenë dashur të na thotë që duhet të ndryshohen 1, 2 ose 3 ligje, pa marrë parasysh cilat janë, në mënyrë që ne ta harmonizojmë legjislacionin tonë me atë të Zvicrës ose t’i themi Zvicrës, ndërroni ju ligjet, harmonizoni me ne. Domethënë, diçka duhet të bëjmë nëse problemi është legjislacioni, atëherë duhet të dëgjojmë cili ligj duhet të ndryshohet e jo të themi se do të arrihet marrëveshja, sepse kur thua do të arrihet marrëveshja po na del që ndoshta marrëveshja është problemi e jo legjislacioni. Kjo është çështja e parë.

Çështja e dytë që më ra në vesh është diçka që kryeministri nuk duhet për ta thënë. Tha është një numër i vogël i qytetarëve, nuk është aq i madh sa po trumbetohet. Çka është me rëndësi a është numri i vogël a është numri i madh? Çka e ndryshon situatën e këtyre njerëzve fakti që mund të jetë numër më i vogël ose numër më i madh, numër i vogël, i madh mund të ndijë prej njerëzve të statistikës e jo prej kreut të ekzekutivit, prej shefit të shtetit efektivisht, jo në letër.

Çështje tjetër është se u tha se do t’i kemi parasysh, i kemi parasysh. Shikoni, për t’i pasur parasysh: problemet, brengat, vërejtjet e qytetarëve të Kosovës nuk domethënë të shkojmë në shtëpi e të qajmë me lot se sa keq janë ata njerëz, por të punojmë, t’i kryejmë obligimet të cilat dikush i ka me kushtetutë t’i kryejë, s’ka nevojë hiq të mërzitet, vetëm ta kryejë punën, krejt thjesht është edhe krejt njerëzit ndihen mirë nëse kurrkush nuk mërzitet as nuk qanë po veç e kryen pjesën e vet të punës që e ka me përkushtim të vendit të punës edhe me Kushtetutë.

Çështja tjetër është se na u tha që në mars të vitit 2008 është ndërprerë ose është marrë ky farë vendimi, ndërsa në shtator të vitit 2010 është mbajtur takimi në Zvicër. Po flasim për më shumë se dy vjet gjatë, po flasim për më shumë se dy vjet hapësirë në të cilën kushedi kujt i ka pasur t’i bjerë në mend, me siguri ministrit të Punës, po e ka pasur ndonjë punë tjetër ministri i Punës, kush e di çfarë pune e ka pasur. Suma – sumarum, duhet thënë se dikush këtu fajet i ka ose i ka Kosova ose i ka Zvicra, duke iu thënë se Zvicra s’mund t’i ketë fajet se i ka punët e veta edhe i këqyrë financat e veta edhe është një vend shumë preciz, vendi më preciz në botë e po ju them, është vendi më preciz për shkak se ne shkojmë të punojmë atje, nuk vijnë ata te ne, domethënë, këtu Qeveria e Kosovës i ka fajet edhe nganjëherë, të paktën nganjëherë, rrallë, të paktën kur kem të bëjmë me çështje kaq emocionale, duhet të dalim e të themi po, kemi pasur faj, Ministria e Punës nuk ka

qenë azhure sa ka qenë dashur të jetë, kryeministri ka pasur punë të tjera ta këqyrë pavarësinë edhe rezolutat, nuk na i ka ra në mend ta kryejmë këtë punë, do ta kryejmë sa më shpejtë që është e mundur edhe të bëjmë një farë, të paktën minimumin për ata pak qytetarë aq pak sa janë që të mbërrijnë t'i marrin të mirat që u takojnë për shkak të punës së vet të gjatë që e kanë kryer.

Në fund më duhet të përsëris edhe pse jam nënshkrues i kërkesës, duhet ta falënderoj deputetin Xhemajli që i ka ra në mend të diskutojë për këtë çështje e ndoshta duhet të na bjerë në mend të diskutojmë edhe për çështje të tjera që kanë të bëjnë me diasporën tonë siç janë sigurimet që i paguajnë dyfish, siç janë mënyrat e komunikimit, siç janë transporti ajror që e bëjnë shumë shtrenjtë e çështje tjera të cilat i ngarkojnë drejtpërdrejt, ata e të mos flasim për administratën e Kosovës e cila i mbanë një kohë të gjatë para sporteleve. Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, fjalën e ka deputetja Rita Hajzeraj.

RITA HAJZERAJ: Faleminderit, zoti kryesues.

KRYESUESI: Më fal, kryeministri deshi një përgjigje.

KRYEMINISTRI HASHTIM THAÇI: Faleminderit!

Deputetë të nderuar!

Do të isha ndërlidhur tek çështja, a është faji i Kosovës apo i Zvicrës? Nuk është faji as i Zvicrës, as i Kosovës, faji është që kemi qenë nën ish -Jugosllavi dhe tërheqja apo përkushtimi ynë që pas shpalljes së Kosovës shtet të pavarur dhe sovran për marrëdhënie bilaterale i gjithë ky proces është në këtë drejtim, pra, faji qëndron se Kosova ka qenë nën ish -Jugosllavi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti kryeministër!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, fjalën e ka deputetja Rita Hajzeraj.

RITA HAJZERAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar kryeministër, të nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Shteti zviceran ka qenë dhe vazhdon të jetë njëri nga shtetet mike të Kosovës. Këtë status ky shtet e ka merituar me kontributin që e ka dhënë për Kosovën dhe qytetarët e saj. Ishte vendi i cili mirëpriti një numër të madh të qytetarëve tanë jo vetëm gjatë viteve të 90-ta, por edhe më herët, duke iu afruar një trajtim dinjitoz dhe duke integruar në shoqërinë zvicerane gjithë punëtorët dhe azilkërkuesit nga Kosova. Andaj, sot disa dekada më vonë gjej rastin ta falënderoj për mbështetjen që u ka afruar qytetarëve tanë dhe për këtë jemi mirënjohës përjetësisht.

Kolegë të nderuar,

Këtë hyrje të shkurtër dhe këtë falënderim i cili besoj thellë se buron nga zemra e çdo qytetari të Republikës së Kosovës, e bëra me një qëllim të caktuar, e bëra vetëm për treguar se shteti mik zviceran nuk është fajtor për vendimin që ka marrë, pra për ndalimin e përkohshëm të pensioneve për qytetarët kosovarë që jetojnë tashmë në Kosovë, por fajtores është Qeveria e Republikës së Kosovës e cila me neglizhencën e saj ka bërë që të ndodhë një gjë e tillë.

Qindra, mijëra familje kosovare kanë përfituar pensione zvicerane në sajë të një marrëveshje për sigurimet sociale, që Qeveria zvicerane pat arritur me Jugosllavinë qysh në vitet e 60-ta. Dhe, sigurisht sikur çdo marrëveshje bilaterale ndërshtetërore kur subjektet që janë nënshkruar se sa e ndryshojnë statusin siç ka ndodhur me shpërbërjen e Jugosllavisë dhe kësaj marrëveshje i ka kaluar

validiteti. E fatkeqësia më e madhe në këtë rast është se Qeveria e Kosovës, sikur edhe në shumë raste të tjera edhe këtu nuk arriti të tregojë se është e gatshme t'i ushtrojë kompetencat e veta shtetërore duke e përtërirë atë marrëveshje apo duke arritur një marrëveshje të re me të cilën do të rregullohej kjo çështje me shtetin zviceran. Pra, për këtë fajet sigurisht se nuk i ka shteti zviceran, fajin e kemi ne që nuk po dimë të sillemi si shtet dhe t'i mbrojmë interesat e qytetarëve tanë.

Zoti Kryeministër, është e vërtetë që qëndrimi i Kosovës apo Kosova nën Jugosllavi para disa vitesh, është faji kryesor i gjithë kësaj marrëveshje bilaterale, mirëpo, ju e dini shumë mirë që shteti i Kosovës që 2 vjet e gjysmë është shtet i pavarur dhe se ne kemi obligim t'i kompletojmë ligjet dhe legjislacionin që t'i arrijmë këto marrëveshjet bilaterale siç i kanë arritur edhe shtetet tjera siç janë: Sllovenia, Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi, të gjitha këto shtete kanë pasur po të njëjtat probleme me këtë marrëveshje bilaterale siç e kemi edhe ne si Kosovë.

Si rezultat i neglizhencës dhe mosveprimit të Qeverisë së Kosovës që nga fundi i muajit mars qindra- mijëra familjeve kosovare, që kanë qenë përfitues të pensioneve të pleqërisë apo të pensioneve invalidore dhe qindra fëmijë që kanë qenë përfitues të shtesave të fëmijëve, meqë prindërit e tyre vazhdojnë të punojnë në Zvicër, u janë ndaluar ato. Pra, nuk janë pak kur bëhet fjalë për qindra familje që deri më tani kanë përfituar të ardhura si rezultat i punës dinjitoze që kanë bërë më herët në atë shtet. Andaj, pikërisht për këtë është dashur që me kohë të reagojë Qeveria e Kosovës dhe ju zoti Kryeministër, sepse keni obligim karshi atyre qytetarëve.

Sigurisht që ky vendim i Qeverisë zvicerane nuk ka qenë i papritur, sepse po bëhet gati një vit i cili na ka njoftuar për një prishje të marrëveshjes bilaterale, ndërsa asnjë iniciativë nuk është marrë nga Qeveria e juaj dhe konkretisht nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies e Sociale.

Zoti kryeministër,

E keni pasur dhe e keni obligim që të veproni për t'i mbrojtur interesat e atyre familjeve që sot iu është mohuar pensioni zviceran e që shumë nga ato po rrezikojnë të kthehen në raste sociale dhe ta ngarkojnë edhe më tutje buxhetin dhe ashtu të ulët të Kosovës që ndan për këto kategori.

E keni për obligim të veproni që t'i mbronë interesat e mbi 170 mijë personave që aktualisht jetojnë dhe shumica nga ata punojnë në shtetin zviceran e që në të ardhmen pasi të pensionohen atje të kthehen dhe të jetojnë në Kosovë, ndërsa me këtë vendim ata nuk mund të përfitojnë asnjë të drejtë të tillë.

E keni për obligim që gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës t'i bëni të ndihen krenarë duke u treguar se shteti nga i cili e kanë prejardhjen përkujdeset për ta dhe interesat e tyre.

Përveç këtyre po ashtu e keni edhe një obligim tjetër që ta urdhëroni Policinë e Kosovës që t'i gjejë dhe t'i qojë prapa grilave ata huliganë të cilët i kanë penguar, madje duke i kërcënuar me jetë hetuesit e Entit shtetëror zviceran për sigurime sociale që kanë qenë duke e bërë punën e tyre për të hetuar manipulimin eventuale të pensioneve zvicerane jashtë Zvicrës. Ju këtë nuk e keni bërë, kjo përkatësisht zgjidhja e këtij rasti nga Policia e shtetit do të ishte një indikator i mirë për sundimin e ligjit dhe rendit në shoqëri, slogan ky të cilin ju asnjëherë nuk e hiqni nga goja. .. nga Zvicra do të duhej ofruar siguri të njëmend që ata të mund të kryejnë punën e tyre dhe duhet një herë e mirë ta kuptoni se sloganet boshe nuk kënaqin vendet që janë ajka e sundimit të rendit dhe ligjit në botë siç është Zvicra.

Për fund zoti kryeministër, të gjithë për këtë çështje kanë vepruar, tani është koha edhe ju që të veproni.

Unë e kam edhe një pyetje për ju, zoti Kryeministër, me që e përmendët që ka qenë një delegacion nga Kosova, i kryesuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Bernë, më 1 dhe 2 shtator, dua të di se çfarë niveli i takimit ka qenë ky takim në Bernë, a ka qenë në nivel zyrtar nga ana e Zvicrës, sepse nga ana e Kosovës po e dimë dhe kur u premtoni qytetarëve të Kosovës jo vetëm qytetarëve të Kosovës që jetojnë në Kosovë, por edhe atyre në Zvicër kompletimin e legjislacionit. Faleminderit!

KRYESUESI: Kryeministri e ka kërkuar fjalën, i ka 15 minuta, regjia le t'i matë minutat edhe të kryeministrit!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Të gjitha delegacionet që kanë qenë në Bernë dhe në të gjitha takimet të cilat janë zhvilluar ndërmjet Kosovës dhe Zvicrës kanë qenë delegacione zyrtare dhe takime ndërshtetërore të interesit të përbashkët. Ndërsa, ju morët parasysh apo morët si shembuj të këtyre marrëveshjeve ndërshtetërore që kanë arritur më herët disa vende që kanë qenë në ish- Jugosllavi, morët për shembull: Slloveninë, Kroacinë, Bosnjën, Maqedoninë, të cilat janë pavarësuar para 20 vjetësh edhe Mali i Zi para 5 vjetësh, do të thotë, ne i kemi 2 vjet, prandaj që t'i përfundoni të gjitha këto marrëveshje bilaterale ndërshtetërore do të duhej të çliroheshim në '90-tën, kur të gjitha vendet tjera arritën ta shpallin pavarësinë e të njiheshin edhe ndërkombëtarisht, kështu që përsëri po them, fajtor është pse kemi qenë nën ish- Jugosllavi, përsëri po e ritheksoj dhe do ta ritheksoj gjithmonë, fajtor për të gjitha prapambetjet është pushtimi serb. E tash është kapitulli i ri.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti kryeministër!

Faleminderit, deputete Hajzeraj.

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, fjalën e ka deputetja Qamile Morina.

QAMILE MORINA: Faleminderit, zoti kryesues!

Kryeministër, deputetë të nderuar dhe ministra,

Sikurse edhe raportoi zoti Xhemajli, iniciuesi i interpelancës si dhe disa anëtarë të Komisionit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale kemi qenë të ftuar nga Sindikata zvicerane Unia për njoftim sa më të përafërt me ndërprerjen e marrëveshjes për sigurimet shoqërore ndërmjet Zvicrës dhe Kosovës si pjesë përbërëse e ish-Jugosllavisë. Gjithashtu, ne si delegacion jemi takuar dhe me disa parlamentarë zviceranë, të cilët ndanin mendime me ne se vendimi i Qeverisë zvicerane ishte i padrejtë dhe i ngutshëm. Do të doja të shfrytëzoj rastin dhe shpreh mirënjohje dhe falënderim për përfaqësuesit e sindikatës Unia që në mënyrë të palodhshme po punonin për të drejtat e tyre, deputetët e Parlamentit zviceran që me shumë përkushtim angazhohen për rinegocimin e marrëveshjes me Kosovës, si dhe të gjithë stafin e ambasadës tonë në krye me zotin Malaj për mbështetjen pa rezervë që treguan gjatë qëndrimit tonë në Zvicër.

Sikurse që i është bërë e njohur gjithë opinionit kosovar në fillim të këtij viti institucionet tona janë paralajmëruar me mundësinë e prishjes së marrëveshjes, meqë marrëveshja definonte qartë edhe organet që duhej të garantonin zbatimin e marrëveshjes dhe gjithashtu përafrimin e legjislacionit të dy shteteve.

Kështu që nga prilli i këtij viti Enti Federal i Sigurimeve Shoqërore ndërpreu marrëveshjen për sigurimet shoqërore dhe në këtë mënyrë dëmtoi me mijëra qytetarë të Kosovës të cilëve u takojnë pensioni i pleqërisë, invalidor si dhe shtesat e fëmijëve duke i kushtëzuar këta qytetarë që e drejta në përfitime bëhet me ruajtjen e vendbanimit në Zvicër. Pa mëdyshje anulimi i një marrëveshje të

tillë rëndon pozitën e qytetarëve tonë të cilët duhen të vendosin se ku do ta kalojnë pleqërinë e tyre, me të vetmin qëllim që mos bëhet eksportimi i përfitimeve jashtë shtetit të Zvicrës.

Si arsye për anulimin e marrëveshjes nga ana e palës zvicerane bëhet fjalë për mungesën totale të zbatimit të deritanishëm të marrëveshjes nga pala kosovare si dhe mungesa e partnerëve seriozë të barabartë në nivel profesional për bisedime në rrafshin e marrëveshjes ndërshtetërore.

Gjithashtu një nga arsytet tjera potencohet mungesa e regjistrimit civil në Kosovë. Për të kuptuar dimensionin e problemit duhet theksuar se më se 10% e popullatës së Kosovës jeton në Kosovë, që do të thotë diku mbi 170 mijë kosovarë. Numri, me të vërtetë, zoti Kryeministër mund të jetë simbolik tani për tani, mirëpo të gjithë këta 170 mijë qytetarë janë kandidatë potencial i përfitimit të pensioneve në të ardhmen dhe duhet të mendohet në këtë drejtim. Dhe, shumë nga këta kosovarë për më shumë se 50 vjet ishin pjesa aktive e fuqisë punëtore në Zvicër dhe gjithashtu kontributi i tyre ishte i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik si dhe sigurimin e skemave shoqërore duke i paguar kontributet e tyre në Zvicër. Atëherë është më se e nevojshme që në këtë moment të ngremë zërin e arsyes që të merret vendim për fazën kalimtare për vazhdimin e marrëveshjes gjer në arritjen e marrëveshjes së re e cila sipas zyrtarëve zviceranë do të marrë kohë me vite për t'u arritur.

Shtetasit tanë në Zvicër kanë nevojë për mbështetjen tonë për realizimin e të drejtave të tyre. Vendi jonë ua ka borxh bashkatdhetarëve tonë të cilët gjithmonë i dolën në ndihmë vendit tonë si para, gjatë dhe pas luftës.

Ajo që duhet cekur dhe që është shqetësuese është se në mungesë të informacioneve përkatëse ish-kontribuuesit e sigurimeve shoqërore po bien pre e përkthyesve dhe avokatëve matrapaz të cilët mezi po presin të sigurojnë me pak punë fitime të majme në dëm të kontribuuesve të cilët kërkojnë kthimin e kontributeve nga arka zvicerane, me çka ata përfundimisht humbin të drejta tjera për përfitime që dalin nga sigurimet shoqërore e të cilat do t'i realizonin me arritjen e marrëveshjes. Ajo që kemi kuptuar nga deputetët zviceranë është se nga Kosova kërkohej veprime konkrete dhe sa më shpejtë për fillimin e negociatave për arritjen e marrëveshjes që obligon Qeverinë tonë që të tregojë pjekurinë dhe seriozitetin e saj. Edhe atë konkretisht kërkojnë garantimin e kontaktit të rregullt ndërmjet organit të Entit Federal për Sigurime Shoqërore të Zvicrës, me organin përkatës në Kosovë, i cili duhet të zotohet për luftimin e keqpërdorimeve.

Andaj, Lidhja Demokratike e Dardanisë angazhohet që qëllimi i këtij mocioni sot është që të nxisë Qeverinë që të trajtojë me shumë seriozitet dhe t'i japë përparësi zgjidhjes së kësaj marrëveshje duke mos i bërë që qytetarët tonë të dallohen nga qytetarët e ish-republikave të Jugosllavisë, të cilët praktikisht të gjithë arritën t'i ripërtërijnë marrëveshjen e tyre. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!

Në emër të Grupit Parlamentar "7+", fjalën e ka kërkuar deputeti Xhezair Murati.

DŽEZAIR MURATI: Hvala, gospodine predsjedavajući!

Pozdrav premijeru, zameniku, ministrima i kolegama!

Mislim da je inicijativom za ovu debatu gospodina Emruša Džemajlija, da se nalazimo upravo u fazi analize jednog praktičnog problema koji pogađa evo veći broj građana Kosova i objašnjenja premijera danas koji je dao hronološka objašnjenja kako je došlo do raskida ovog sporazuma, kako je on bio potpisan, kako je došlo do raskida, mislim da je bačena jedna jasna slika koju sada imamo pred sobom. Mislim da i dosadašnji pokušaji Vlade da se ovaj problem shvati kao značajan,

zaslužuju pohvalu jer mi se ipak kao mlada država suočavamo i suočavaćemo i sa drugim problemima koji budu eventualno sutra nastali na relaciji razvijenih zemalja i naše države.

S toga, ja smatram da je poslednja delegacija koja je posetila poslednjeg vikenda Švajcarskoj iz Komisije za zdravstvo, rad i socijalnu politiku i gospodin Džemajli mogli su konkretno da se upoznaju sa ovim problemom i mi smo imali takođe iz naše grupe člana delegacije koja je putovala za poslednji vikend i mam dosta informacija o ovome. Mi mislimo da, recimo, kada je Unija sindikata Švajcarske istakla da Kosovo gubi jedan milion eura mesečno samo po pitanju ne isplaćivanja dečijih dodataka, to govori u prilog tome kolika je šteta recimo za neostvarivanje prava koja zaslužuju.

Kao glavni prioritet pregovora o kojima i koleginica Qamile Morina govorila, jeste taj da nedostaje naša zakonodavna legislatura odgovarajućih zakona kako bi smo brže rešili problem. Ovo o čemu govorimo da će pregovori između Kosova i Švajcarske trajati najmanje 2. godine, govori u prilog tome da moramo požuriti i sa pripremom civilnog registra i sa bržim usvajanjem Zakona o penzionom, odnosno invalidskom i dečijem osiguranje. To je osnovna pretpostavka nastavka pregovora.

Mi apelujemo na Vladu da se i nadalje ovaj problem shvata vrlo ozbiljnim, kako je to i to shvatala, što je iz diskusija mojih kolega do sada rečeno, dakle da Vlada nastavi da shvata ovaj problem kao ozbiljan, jer on i jeste ozbiljan i da Vlada samim tim svojom snagom omogući da na što većem nivou budu ovi pregovori. Ja sam od našeg člana grupe koji je putovao poslednjeg vikenda saznao da naš ambasador i osoblje naše ambasade su vrlo detaljno upoznati sa ovim problemom i da su spremni da takođe lobiraju i pomognu, za šta se i nalaze u Švajcarskoj. Ako kažemo da imamo 170 hiljada zvanično lica sa Kosova koja su u Švajcarskoj, a da imamo i još i druga lica koja nisu registrovana, govori u prilog tome da je zaista u pitanju oko 10% stanovnika Kosova. Znači, mi apelujemo na Vladu da se uradi što pre civilni registar i da što pre usvojimo odgovarajuću legislaturu kako bi smo bili ravnopravan pregovarač sa Švajcarskom, da ne bi bili inferiorni i da se kaže nemamo odgovarajuće saradnike.

Mi pozdravljamo ovu inicijativu, zahvaljujemo i Vladi šta je činila i nadamo se da će i nadalje činiti, i pre svega predlažu oве debate, gospodinu Džemajliju. Hvala vam!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, nuk është paraqit kurrkush, ndërkah në emër të Grupit për Integritet, fjalën e ka kërkuar edhe Vezira Emrush, edhe Branislav Grbiq. Do të flas Branislav Grbiq, në emër të grupit.

BRANISLAV GRBIĆ: Zahvaljujem predsedavajući!

Uvaženo Predsedništvo,

Uvaženi premijeru, zamenice, ministri,

Dame i gospodo narodni poslanici,

Inicijativa koju je pokrenuo poslanik Emruš Džemjali u vezi rešavanja statusa naših građana Kosova koji žive i rade van prostora Kosova, konkretno radi se o Švajcarskoj, je jedno od bitnih tema za rešavanje statusa građana Kosova. To je ono što smatramo da je jako bitno u smislu da je Švajcarska jedna od prvih država koja je priznala nezavisnost Kosova. I u tom kontekstu sigurno da i inicijativu premijera i Vlade Kosova da se taj problem reši, trebamo pozdraviti. Međutim, u celom tom kontekstu ima jedan, da ne kažem problem, ali i jedan kontinuitet, a to je da imamo jedno neažurno i neadekvatno Ministarstvo za rad, koje smatram da je moglo mnogo, mnogo bolje i mnogo pre i mnogo kvalitetnije da odradi neke zakone koji su jako bitni. Tako da mislim da to

ministarstvo ne prati inicijativu premijera tako da, gospodinu premijeru, vi možete sa vašim autoritetom da ubrzate napore tog ministarstva, da ukažete i samom ministru da su građani Kosova u jako nepovoljnom položaju.

Dosta dugo je jedan, da kažem, vakumski pritisak i siromaštvo i privreda je u jakom lošom stanju, tako da te penzije koje bi primali u Švajcarskoj veoma dobro došle za dalji prosperitet građana Kosova. I u tom kontekstu sigurno je dobro da mi imamo neke polazne osnove, polazne zakone koji će biti uslov za pregovore i sa Vladom Švajcarske. Ja vidim da tu vi možete vašim autoritetom da postignete to, da to Ministarstvo ubrza svoje zakonske regulative i da svi mi učestvujemo u nekom procesu koji će biti u korist građana Kosova. Hvala, još jednom!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Në emër të grupeve parlamentare, do të thotë, u kryen diskutimet e para. Kalojmë te deputetët e pavarur. Fjalën e ka deputeti Driton Tali, do të thotë i ka 2 minuta, e kështu me radhë.

DRITON TALI: Mua m'i ka dhënë edhe 2 minuta deputeti Dugolli, i nderuar zoti kryesues.

KRYESUESI: Deputetët e pavarur, janë të pavarur.

DRITON TALI: Okej, mos ta humbi kohën!

Sidoqoftë, zoti kryeministër, ju në fjalimin tuaj thatë se Qeveria e Kosovës sigurimin social e ka pasur gjithmonë prioritet dhe e ka. Po ashtu, zoti Kryeministër, thatë se kjo çështje e ngritur nga deputeti Xhemajli është shumë e drejtë. Unë, po ashtu, si një nga mbështetësit e këtij mocioni, nuk e kam të qartë pse atëherë Qeveria nuk ka reaguar me kohë? Sipas informatave që m'i ka dhënë personalisht deputeti shumë i nderuar zviceran, Uli Lai Benger, ai thotë se Ministria juaj e Punëve të Jashtme, më 21 dhjetor, personally, pra në dorë e ka marrë notën verbale prej Ambasadës së Zvicrës në Kosovë dhe ju nuk keni ndërmarrë asnjë veprim, derisa Qeveria e Zvicrës, siç u tha, më 1 prill e ka bërë publike këtë vendim. Unë nuk e kam të qartë pse e keni neglizhuar dhe a është marrë dikush nga Ministria e Punëve të Jashtme apo nga kushdo qoftë personat përgjegjës në përgjegjësi për këtë neglizhencë që i ka dëmtuar aq shumë me qindra- mijëra bashkëqytetarë tanë.

Pra, jam shumë i bindur se po të reagonit me kohë, Qeveria e Zvicrës do të kishte mirëkuptim, do ta gjente një kompromis mes Qeverisë së Kosovës, ata do ta kuptonin se Kosova është shtet i ri, se nuk kemi mund të gjitha ligjet t'i koordinojmë dhe do të na jepnin kohë, por ju e keni neglizhuar, nuk e kam të qartë si neglizhohet një shtet i cili ka bërë aq shumë për ne, a është çështje e mos dijes....?

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Vazhdojmë me deputetin tjetër të pavarur, zoti Naim Rustemi.

NAIM RRUSTEMI: Faleminderit!

Gjithashtu, edhe unë do t'i ngre shqetësimet e ngjashme që u ngritën edhe me parafolësit e tjerë edhe nuk po mund ta kuptoj si është e mundshme që një deputet zviceran të vijë e të llobojë nga Zvicra në Kosovë për të drejtat e qytetarëve të Kosovës, edhe më pastaj ne flasim për qëndrime etike, për një kod moral. Këtu nuk kemi të bëjmë me një kod moral. Edhe unë kisha nderin që takova një njeri të tillë dhe gjatë diskutimit të gjitha fajet ai ia hidhte Qeverisë së Kosovës, sepse Qeveria e Kosovës ka qenë e paralajmëruar se Zvicra është duke rishikuar Marrëveshjen për sigurime shoqërore, qysh prej 21 dhjetorit të vitit 2009 dhe ka qenë e dijshe se do të shkëputet marrëveshja me vendet e ish- Jugosllavisë. Kjo ka qenë një çështje që e ka ditur edhe Qeveria, por ndoshta nuk brengoset shumë, sepse njerëzit e tillë, ata që kanë punuar larg prej familjeve të

veta janë mësua pak të heqin, janë mësuar pak edhe të japin para nëpër të gjitha fondet, duke filluar 3%, “Vendlindja thërret”, ndoshta edhe u është harruar kontributi i atyre qytetarëve dhe s’është brengosur kurrkush për ta. Edhe unë e falënderoj shumë deputetin Xhemajli si majtist, sepse ky brengoset për të mirat edhe për gjendjen e qytetarëve të Kosovës, po nuk po e kuptoj shumë kolegun tim Tali, që është ultra majtist edhe po iu qëndron shumë besnik ideve të tij marksiste dhe leniniste se nuk po e gjen fuqinë që të jetë adapt me ndryshimet që po i sjell koha.

Sa për Qeverinë, ne po e dimë që është djathtiste, s’ka problem, punëtorët punojnë, punojnë, ne i gëzojmë të mirat e tyre, s’ka problem.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Ia nxore një minutë kolegut tënd.

Një minutë për replikë, fjalën Talit.

DRITON TALI: Unë, me të vërtetë si ultra majtist që jam, nuk e kam të qartë pse kjo Qeveri kaq kompetente, prej 21 dhjetorit deri më 1 prill, nuk reagon, më shumë se 4 muaj janë në pyetje. Dhe këtu vijmë na tregojnë se sa janë të interesuar për sigurimet sociale, që është po ashtu një karakteristikë e të majtëve. Mbase zoti kryeministër edhe më tuje ka nostalgji për vitet e tij të 90-ta dhe s’mund po del prej asaj farë lëvozhge. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka kryeministri, meqë është apostrofuar drejtpërdrejt.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Unë sot jam këtu që të përgjigjem në pyetjen mjaftë të sinqertë dhe të drejtë të deputetit të nderuar, Xhemajli, të përgjigjem në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe si kryeministër i Kosovës, të përgjigjem në çështjen e ngritur për t’u zgjidhur njëherë e përgjithmonë.

Nuk dëshiroj që kjo çështje e ngritur për t’u zgjidhur në mënyrë të drejtë, në mënyrë shtetërore ndërmjet shtetit të Kosovës dhe Zvicrës të keqpërdoret për primesa ideologjike dhe tandemit ultra majtist të grupit të pavarur apo duetit të pavarur. Kjo çështje nuk është ideologjike është interes shtetëror, shoqëror qytetar, është në interesin e gjithëve.

Besoj se askush nuk ka nostalgji për ato vite që ju përmendët, por unë jam shumë krenar me të gjitha vitet e jetës sime së bashku me qytetarët e Kosovës. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit, kryeministër!

Para se të vazhdojmë me diskutimet, veç një njoftim për kohën e shpenzuar. Partia Demokratike e Kosovës ka edhe 29 minuta në dispozicion, Lidhja Demokratike edhe 26 minuta, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, 12 minuta, Aleanca Kosova e Re, 8 minuta, Lidhja Demokratike e Dardanisë, 8 minuta, Grupi “7+” edhe 6 minuta dhe Grupi për Integritet edhe 8 minuta.

Vazhdojmë me radhën e deputetëve. Fjalën e ka deputetja Flora Brovina.

FLORA BROVINA: Ju faleminderit!

Përshëndetje, kryesues!

Përshëndetje, zoti Kryeministër, Kabinet qeveritar që jeni këtu!

Kolegë, kolege,

Komisioni për Shëndetësi pasi që më kishte dhënë detyrë të flas edhe në emër të Komisionit, ka treguar interesim posa ka kuptuar për këtë problematikë që i atakon qytetarët tanë në Zvicër dhe ata që ndodhen këtu e që janë të varur nga puna e kryer e prindërve të tyre në Zvicër.

Ne kemi pasur takime të ndërsjella me parlamentarë zviceranë, Komisionin për Çështje Sociale edhe me sindikalistë dhe ekspertë të cilët kanë mund të na shpjegojnë detajisht sistemin për sigurime shoqërore në Zvicër, por edhe problemet që dalin pas shkëputjes së marrëveshjes që ka qenë e lidhur ndërmjet të Jugosllavisë dhe Kosovës e që në të vërtetë kanë përfituar nga kjo marrëveshje edhe qytetarët e Kosovës.

Qytetarët e Kosovës janë qytetarë në Zvicër që kontribuuan në mbushjen e sigurimeve shoqërore gati një gjysmë shekulli, qysh prej vitit 1962 dhe kontributi i tyre në ndërtimin e shtetit të Zvicrës është i jashtëzakonshëm, sikur që është i jashtëzakonshëm dhe kontributi në mbushjen e fondeve sociale. Prandaj, ata me të drejtë kërkojnë kthimin e këtij kontributi tani kur duhet t'i gëzonin këto investime. Për fat të keq, kjo me shkëputjen e marrëveshjes që ndodhi me 1 prill të vitit 2010 e që ishte paralajmëruar më 1 prill të vitit 2009 nga Enti Federal i Sigurimeve Shoqërore të Qeverisë së Zvicrës kur Kosova mbetet pa marrëveshje dhe këta qytetarë i humbin këto të drejta. Numri i njerëzve që atakohen vërtet pajtohem me kryeministrin në fillim është shumë i vogël, por prej vitit në vit, të gjithë qytetarët që ndodhen atje dhe mendohet se janë populli i katërt në Zvicër, u tha këtu përafërsisht afër 200 mijë qytetarë do të kenë të humbur këtë të drejtë të sigurimeve shoqërore.

Unë nuk do të flas atë që thanë kolegët e mija se tani mund të veprojnë matrapazët dhe të vihet te mashtrimet e tyre, por kujtoj se kjo e drejtë mund të garantohet me një marrëveshje shumë të ngutshme dhe me përgatitjet tona në lidhje me marrëveshjen.

Sa i përket sigurimeve shoqërore Qeveria jonë bart obligimet e saja në përmbushjen e legjislacionit i cili nuk është lehtë të bëhet mbasi që është një periudhë e vështirë dhe secili legjislacion sa i përket sigurimeve është ligj që e kërkon edhe përmbushjen e buxhetit, e që ne e kemi pak më të vështirë.

Një ndër çështjet më kryesore sigurisht që është listat e sakta të regjistrimeve civile e që ne garantuam se këto lista na nevojiten pikë së pari edhe për shkak të përgatitjes tonë për integritet evropian, vërtet për liberalizimin e vizave dhe për kartat biometrike dhe besojmë që në fund të vitit ne do ta kemi këtë mundësi që këtë garancion edhe sikur e premtuan ta kemi të gatshëm.

Disa nga ligjet sigurisht më të vështira do të jetë Fondi për sigurimet shoqërore në Kosovë, sepse përpjekja është bërë kaheerë dhe kemi pasur pengesa edhe nga Fondi Monetar Ndërkombëtar edhe për shkak të buxhetit të vogël. Se dëmi është shumë i madh dhe do të ndikojë në buxhetin tonë, dihet se shumë nga këta njerëz marrin pjesë në remitancat që kthehen në Kosovë dhe këto do të shkojnë në dëm shumë të madh.

Në anën tjetër, Komisioni parlamentar mendon se, domethënë, duhet të veprohet sa më shpejtë në nxjerrjen e marrëveshjes dhe qysh sot për këtë të ngarkohen disa ministri, Ministria e Punëve të Brendshme, domethënë, ta kryejë pjesën e vetë, Ministria e Punës të përgatitë kuadrin e aftë profesional që të fillojë njohjen e çështjeve të cilat mungojnë në marrëveshje dhe t'i përplotësojmë ato. Pastaj Ministria e Shëndetësisë ka obligimet e veta dhe zoti Kryeministër kërkojmë nga ju që personalisht të angazhoheni dhe këtë çështje ta vëni prioritet me interes për zgjidhjen e çështjes sa më parë dhe natyrisht keni mbështetjen e Komisionit për Punë dhe Mirëqenie Sociale, i cili do të monitorojë se si do të përfundojë kjo çështje. Në lidhje me marrëveshjet për punë me shtetet tjera ne kemi shumë probleme edhe me shtetet tjera. Është kërkesë edhe e punëtorëve dhe qytetarëve tanë të punësuar në Kroaci, të cilët gjithashtu kanë kërkuar një marrëveshje ndërshtetërore e besoj edhe me shtetet tjera fqinje që të mund t'i gëzojnë të drejtat e tyre në investimet, në sigurimet shoqërore në ato shtete ku kanë punuar. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!

Fjalën e ka deputeti Ahmet Isufi, le të përgatitet deputeti Riza Smaka.

AHMET ISUFI: Faleminderit, zoti kryesues!

Vendimi i Entit Federal të Zvicrës është vendim që vërtet ka cenuar interesin e qytetarëve të Kosovës, të cilët kanë punuar dhe vepruar në Zvicër dhe kryesisht është goditur pjesa më e ndjeshme e atyre që kanë punuar në Zvicër, janë invalidët, pensionistët, ata që kanë shtesa të fëmijëve dhe të gjithë ata që kanë gëzuar sigurimet shoqërore.

Këtu u tha që është numër i vogël, nuk kemi statistikë për të na treguar sa është i vogël, por i vogël apo i madh, është interes i qytetarëve të Kosovës dhe duhet parë si interes që duhet angazhim për te. Nuk mund të themi se është hap i ngutshëm i Zvicrës për arsye se një vit hapësirë i ka mjaftuar Qeverisë sonë, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale që ta rregullojë këtë çështje në momentin kur është lajmëruar dhe ka qenë publik vendimi, nuk ka qenë vendim i cili nuk është ditur. Nga 1 prilli i vitit 2009, deri më 31 mars 2010 është rrafsh një vit dhe është dashur një angazhim i Ministrisë drejtpërdrejt në mënyrë që të rregullohet kjo çështje.

Unë po ju sjell një shembull analog që është në Gjermani. Në momentin kur kam marrë informatën se po bëhet e njëjta, domethënë, sikur me punëtorët e Zvicrës, kam marr delegacionin nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe në Berlin kemi ndryshuar marrëveshjen e cila ka ekzistuar dikur me ish- Jugosllavinë. Pse Ministria një vit ka pritur dhe nuk e ka bërë një gjë të tillë apo kemi thjesht ministër i cili nuk e di rolin e vet, nuk i di përgjegjësitë e veta ose nuk kanë kohë të merren me këto çështje të qytetarëve tanë, por merren me do tjera. Duhet të dihet nuk ka më mundësi që dikush të vijë në Kosovë të marrë edhe t'i bëjë punët tuaja, por është obligim i gjithëve që kanë marrë përgjegjësi në nivelet institucionale t'i kryejnë këto obligime. Sot jemi më 16 shtator, nga 31 marsi i këtij viti këta qytetarë tanë të kanë probleme, sepse nuk mund t'i marrin sigurimet shoqërore. Është e vonuar krejt edhe ky angazhim i tashëm dhe është për të ardhur keq kur parlamentarët zviceranë ose shoqata Unia, sindikatë që është e përfaqësuar nga shqiptarët po ashtu merret me këto probleme kur ne kemi Ministrinë, kur kemi Qeverinë. Është një neglizhencë e cila nuk duhet të tolerohet dhe kjo qeveri duhet të sillet në raport me kërkesa dhe nevojat e qytetarëve të Kosovës kudo që janë ata. Nuk ka justifikim se nuk ka fajtorë, fajtor është ish- Jugosllavia, fajtor është ish- Jugosllavia për pjesën kur ka qenë, ajo është e vdekur më nuk ka nevojë për t'u marrë me te, po ka nevojë me punët e tashme të cilat po na presin në hapa të mëtutjeshëm për të treguar se kemi shtet. Unë po shoh edhe në nivelet më të larta ndërkombëtare kur merren vendime të mëdha tërë kohën Qeveria na torturon me hapat gjigant që ka marrë bashkësia ndërkombëtare, po ne do të merremi me punët tona këtu dhe nëse GJND-ja merr një vendim është pozitiv, është i mirëseardhur për popullin e Kosovës, për Qeverinë e Kosovës, për ne të gjithë. Por ne do t'i kryejmë obligimet tona që kemi para qytetarëve tanë për t'i dhënë edhe një imazh botës se ne po punojmë në raport me standardet që i kanë edhe të tjerët kur kanë në pyetje institucionet dhe shtetin.

Prandaj, unë kisha thënë që t'i bëhet presion më shumë Ministrisë përmes ambasadës tonë atje, përmes gjithë atyre deputetëve që mund të angazhohen në nivelin e shtetit zviceran që kjo çështje të mbyllet sa më shpejtë në mënyrë që qytetarët tanë të kenë mundësinë e marrjes së sigurimeve të tyre shoqërore që i kanë gëzuar edhe më herët. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Fjalën e ka deputeti Riza Smaka, le të përgatitet deputetja Zylfije Hundozi.

RIZA SMAKA: I nderuar zotëri kryesues,

Zotëri Kryeministër, zëvendëskryeministra,

Deputetë të respektuar,

Fillimisht, do ta them këtë, kryeministri është i zoti i shtëpisë, i Qeverisë, si quhet pater familias, major domus, nëse ministria respektive punon si duhet, natyrisht meritat afirmative i shkojnë kryeministrit edhe anasjelltas dhe shpeshherë kryeministri mund të fajësohet pa faj të tij personal vetëm për hir të përgjegjësisë objektive dhe kjo është e natyrshme. Unë ja shoh për të madhe me sinqeritet po them kështu, pa kurrfarë tendence absolute ministrive respektive se nuk është fjala veç për një që nuk kanë reaguar me urgjencë, ju lutem kjo është çështje juridike, e është çështje politike, e çështje sociale, e humanitare e ndërshtetërore- bilaterale që prek në ekzistencën e shumë njerëzve tanë që kanë dhënë shumë kontribut për familjet e veta dhe për Kosovës që janë shumë meritore për respekt, që është dashur të reagohej me urgjencë menjëherë e këto punë kanë mund të bëhen. Nuk është në rregull që thuhet ne do të bëjmë legjislacionin, sikur që kishte rast dhe pyetsha kur kjo punë, përgjigja ndër të tjera ishte me fjalë shumë të mira e tjera e tjera, por na do ta bëjmë këtë punë sa më parë që ajo i bie kurrë apo që mund të bëhet edhe kurrë ajo.

E tash, ju lutem, unë jam një nga peticionarët, do të thotë, e kam mbështetur këtë nismë për këtë interpelancë edhe pyetja substanciale për mua është- pse nuk ka reaguar Ministria përkatëse, vërtet edhe tjetra ministri kur është çështja e shumë matrapazëve, mjerisht tanë, ata njerëz tanë janë a, spekulantëve edhe që kanë bërë akte kriminale në falsifikimin e dokumenteve, kanë irrituar autoritetet zvicerane e tjera e tjera, kanë ngritur çështjen më pastaj pse të mos kooperasi me te në mënyrën më korrekte, më gjentile të mundshme, pse mos t'i ndjekim ne ata, pse ne kem burgje, pse mos t'i burgosim ata, ata, ato që kanë falsifikuar shumë dokumente edhe aty është nisur, si të them, ndër tjera?

Mbetet, çka mbetet, mbetet që Qeveria, unë konsideroj kështu, ta mbajë një seancë speciale për këtë çështje, t'i caktojë detyrat edhe afatet e ministrive edhe më pastaj aty është vendi për rikonfigurim të caktuar, po e zëmë, jo veç bëjmë kombinime sikur në lojën e shahut, shpeshherë ministra shumë kompetent i zhvendosim me ndonjë ministër inkompetent.

Mua më vjen keq si një nga qytetarët e Kosovës, që bie fjala del puna se falsifikatorë të këtushëm kanë kontribuar, ndër të tjera atje, më pastaj ne brenda dy vjetëve është dashur këtë instrument juridik ndërkombëtar ta përtërimë, nisma duhet të jetë e jona, përsistenca duhet të jetë e jona, sepse është interesi i këtij vendi, i këtyre qytetarëve. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputetja Zylfije Hundozi, le të përgatitet deputetja Kaqusha Jashari.

ZYLFIJE HUNDOZI: Faleminderit, zoti kryesues!

Është e dhimbshme të dëgjojmë që edhe një herë po bëhet diskriminim ndaj qytetarëve tanë që janë me punë në shtetet e Evropës Perëndimore dhe në këtë rast në Zvicër. Ndërprerja e sigurimeve shoqërore është bërë për faj të Qeverisë së Kosovës e cila ka qenë paraprakisht e paralajmëruar për shkëputje të marrëveshjes në të cilën rregullohen të drejta për përfitime nga sigurimet shoqërore nëse kthehen ata në vendlindjet e tyre. Edhe pse Qeveria është paralajmëruar se duhet ta rregullojë legjislacionin e vet, pikëpyetje këtu është se a kemi të bëjnë vetëm me legjislacion, me qëllim që marrëveshja të vazhdojë, Qeveria nuk ka bërë asgjë që kjo marrëveshje të vazhdojë e jo të veprojë me shpejtësinë e duhur.

Çështja e dytë është edhe ankesa që Qeveria zvicerane i ka parashtruar për keqpërdorimet që janë bërë gjatë vlerësimit të aftësisë së kufizuar të personave që kanë aplikuar për pension invalidor në

institucionet e Kosovës dhe kjo paraqet edhe një element i cili e ka shtyrë Qeverinë e Zvicrës që të ndërmarrë këtë hap.

Më vjen keq që kryeministri gjatë paraqitjes së vet e minimizon rëndësinë e kësaj çështjeje dhe minimizon numrin e personave që kanë pësuar nga shpërbërja e kësaj marrëveshjeje. Edhe nëse është në pyetje një njeri, Qeveria duhet të bëjë çmos që të përgatisë dhe të gratifikojë punën e mundimshme të punëtorëve tanë në shtetet e jashtme, pse kemi luftuar për shtet, të mos mbesim jetimë, e jo të pësojmë, domethënë, gjithashtu për shkak se Qeveria jonë nuk është e aftë që ta përballojë këtë problem.

Shpresoj që Qeveria të angazhohet maksimalisht, t'i eliminojë të gjitha pengesat dhe t'i plotësojë kërkesat e Qeverisë zvicerane për harmonizimin e legjislacionit nëse kjo është në pyetje në mënyrë që qytetarët tanë t'i gëzojnë pensionet sa më shpejtë.

Gjithashtu, Qeveria të vendosë mekanizma që nuk do t'i lejojnë keqpërdorimet dhe korrupsionin gjatë vlerësimit të invaliditetit, gjegjësisht aftësisë së kufizuar të punëtorëve tanë, në mënyrë që të kthehet besimi te Qeveria zvicerane që ne e meritojmë nënshkrimin e një marrëveshjeje të tillë. Faleminderit, për vëmendje!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!

Fjalën e ka deputetja Kaqusha Jashari, le të përgatitet deputetja Vezira Emrash.

KAQUSHA JASHARI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar kryeministër, ministra dhe kolegë deputetë,

Unë mendoj se në këtë kohë nuk duhet biseduar kush na ka faj, prej as përgjigje a na ka faj dikush më shumë a dikush më pak ne nuk kemi kurrfarë dobie. Çka më tutje, prandaj diskutimin po e shkurttoj për shkak të tjerëve. Të kërkohet vazhdimi i marrëveshjes, mendoj se është kot, është kryer ajo punë, një vit e kemi humbur, duhet pranuar, por ta kthejmë atë kohë nuk mundemi. Çka më tutje? Duhet ta bëjmë marrëveshjen direkte Zvicër – Kosovë dhe sa më shpejtë të bëhemi gati. Por, unë vetëm një problem e shoh këtu shumë serioz. Kryeministri në paraqitje e ka përmendur, por askush nuk hyri në atë problematikë, ai sa për ta kaluar e ka përmendur në lidhje me legjislacionin e Zvicrës dhe të Kosovës, që nuk është në përputhje, vërtet ne ende nuk i kemi aprovuar disa ligje, por do të jetë një problem shumë serioz.

Buxheti i Zvicrës nuk financon këto çështje të cilat i ka përmendur zoti Emrush. Atje ekziston parimi, solidariteti i gjeneratave. Është enti i cili e ka fondin edhe nuk prek fare buxhetin e Zvicrës. Ju lutem, Zvicra nuk është shtet as komunist, as socialist. Mund ta marrim shembullin edhe të tyre, mirë që ka ardhur kjo, por po më vjen keq prej njerëzve që i kanë humbur të drejtat momentale, se me siguri rregullohet. Ta marrim Gjermaninë, t'i marrim shtetet skandinave. Prandaj, këto i kanë rregulluar kështu. Ku jemi ne? Ne i kemi tri ligje, në Kuvend është Ligji i punës. Këto dy ende nuk kanë ardhur - Ligji për sigurime shëndetësore, Ligji për sigurimin pensional dhe invalidor. Në qoftë se edhe këto të tri ligjet, sikur ai që e patëm para dy seancave, shkojnë edhe e ngarkojnë buxhetin, nuk e shoh logjikën që mos të hulumtohet mirë çfarë shteti jemi duke ndërtuar. Na pranuan 71 shtete, më kthim nuk ka dhe mos të merremi ne në opinion me një trimëri që e bëjnë çka bëjnë, por të shikojmë se çfarë shteti do të bëjmë ne brenda, ku është njeriu ynë, aty është problemi. Në qoftë se këto ligjet i pranojmë kështu qysh janë në koncept, ta ngarkojnë buxhetin e Kosovës dhe gjithmonë ai buxheti i varfër ta marrë krejt popullatën, kemi për t'u ngulfatur shumë shpejt. Prandaj, unë e hapi këtë që e kam përmendur gjithmonë, por gjithmonë m'u ka gjuajtur vlerësimi për person tjetër. Unë po them këtu, parimi i solidariteti i

gjeneratave është shpëtim për Kosovën, për punëtorët tanë dhe për marrëveshje me Zvicrën ose për marrëveshje me shtetet tjera. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete!

Fjalën e ka deputetja Vezira Emrush, le të përgatitet deputeti Gani Buçinca.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala lepa na datu reč!

Pozdravljam sve kolege i vodećeg ove Skupštine, kao i premijera i prisutne ministre!

Jako mi je žao što danas imamo jako važno podignuto pitanje, gde su izgubili stečena prava građani koji su to imali to stečeno pravo u Švajcarskoj. Švajcarska Vlada je svoj zadatak izvršila na zakonit i korektan način, obavestila je Vladu Kosova, Ministarstvo, međutim vakumski se Ministarstvo nije pobrinulo da uđe u analizu problema koji je nastao. Ne kažem ovo iz prostog razloga jer ovakav problem može da nastane tekuće dalje u regiji gde se nalazimo.

Pošto smo čuli više puta od gospodina premijera da je kriva za ovo Jugoslavija i to što smo bili u takvom okruženju, ja mogu da kažem da smo u tom okruženju i u toj državi imali stečena prava koje smo mi danas izgubili i koja praktično gubimo. Znamo da i dalje, ne samo penzije iz Švajcarske, nego i domaći penzioneri su izgubili ovo pravo i krajnje je vreme da se ova Vlada i mi svi zajedno sa Vladom pobrinemo o bazičnim zakonima koji daju ljudska prava. Ustav, ja ću da vas posetim na ustav, član 49. Zakon o radu, član 50, Zakon o obaveznom penzijskom invalidskom osiguranju i član 51. - prava dece. Znači, mi sada govorimo o pravima, o stečenim pravima, o ljudskim pravima i ta prava, kada jedna kulturna država, kao što je Švajcarska razmatra u Parlamentu, ona ima pred sobom zakone, magistraturu na ime koje izdvaja budžet i, da kažem, odvojen budžet Ministarstva za rad i socijalno osiguranje i gde je došlo, normalno gde ljudi prepoznaju, gde znaju kako troše budžet, gde imaju analizu budžeta i gde znaju kako se nenamenski troše sredstva koja su našim građanima obustavili.

Mi ovde svi poslanici znamo da je Švajcarska bila prva zemlja koja nas je priznala, pa smo imali dosta vremena da uradimo analizu svih ovih problema koji su nastali, da izdvojimo, da kažem, ljude koji su manipulisali, zloupotrebljavali korišćenje tih penzija, dali su bila starosna, invalidska, penzijska, dečiji dodatak, bilo nam je mnogo mило da iz inostranstva dobijaju dečiji dodatak, a da su naša deca ovde izgubila pravo na dečiji dodatak u svojoj državi. Mi moramo ove stvari da regulišemo u zakonskoj strukturi, moramo da budemo prava država i moramo da znamo šta je početak i kraj i koji su zakoni neophodni.

Pošto sam u Komisiji za rad i socijalno osiguranje, imam dobru informaciju videla sam da su se potrudile dve naše kolegice koje su bile sada u poseti u Švajcarskoj, gde je podignuto ovo pitanje i verujte mi, samo sa infrastrukturom i sa institucionalnim predstavljanjem znamo da će ovaj problem biti rešen tak što ćemo mi ovde morati da radimo. Nije problem nastao zbog Švajcarske države, problem je ovde bio kod nas i taj problem mi ćemo ubuduće da imamo. Sada pred nama su jako važna tehnička pitanja gde će građani Kosova da traže stečena prava u regijama gde su postale nove regije, nova politička preströjavanja, gde će svako tražiti svoja prava na ime ovih stečenih prava.

Ja mislim da je više krajne vreme da napravimo jednu ozbiljnu komisiju, dali će to biti pri Ministarstvu za rad i socijalna pitanja i da podignemo ova pitanja i da imamo penzijsku šemu, da je ime ovih zakona koja sam nabrajala, Zakon o penzijskom, Zakon socijalnom, imamo kulturne fondove gde će biti izdvajanja iz budžeta i moram da podsetim da su ta izdvajanja svih tih zemalja koje je nabrojao nama gospodin premijer, Thači, da sve te zemlje imaju PIO fond, penzijsko invalidsko osiguranje i kod nikog nije ugašen, da smo imali na ime Pravilnika UNMIK-a isto

obavezu za takvu organizaciju i zakone koje mi nismo poštovali, a danas kočimo i ne donosimo sami zakone. Evo to je glavni problem i taj problem moramo da rešimo. To su ljudska prava i kršenje ljudskih prava, kada je u pitanju Evropska komisija, smatra da je kršenje ljudskih prava osnovno pravo koje se zahteva od svih zemalja da bi ušli u Evropsku Uniju. Mi moramo da poštujemo svoja i ostala ljudska prava.

Na ime toga, kažem da Švajcarska Vlada ne snosi nikakvu odgovornost, da je odgovornost ovde na nana, ne kažem ni na Vladi, na nama i više ne možemo da prozivamo krivca, da je kriv taj ili ovaj, nego smo krivi mi. Hvala na datu reč!

KRYESUESI: Ju faleminderit, hvala! Fjalën e ka deputeti Buçinca, le të përgatitet deputeti Berim Ramosaj.

GANI BUÇINCA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Unë do të jem shumë i shkurtër dhe ju përsëndes të gjithëve!

Krejt ky diskutim sot është duke shkuar gabimisht. Unë, si deputet i Kuvendit të Kosovës, do të diskutoj jo si kryeministër, jo si ministër, jo si qeveritar, por si deputet i cili në karrierën e vet është angazhuar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Vendimi i shtetit zviceran për mos pagesën të ardhurave për qytetarët tanë, ka qenë vendim arbitrar dhe diskriminues. Unë iu bashkohem të gjithë atyre zërave në Zvicër, qoftë në Parlamentin zviceran, qoftë në shoqërinë civile, qoftë intelektual të cilët e kanë akuzuar Qeverinë dhe parlamentin zviceran se ka bërë një diskriminim ndaj qytetarëve të Kosovës. Ky është problemi themelor dhe jo këtu të shfrytëzohet kjo seancë për të ngritur akuza ndaj Qeverisë dhe ndaj kryeministrit.

Unë kisha propozuar që kur të kërkojmë prokuror në Kosovë, të vijmë dhe t'i kërkojmë këtu, nga opozita t'i marrim prokurorët e mos të kërkojmë me konkurs prokurorë tjerë në Kosovë. Problemi më i madh, torturë është ta dëgjosh sot opozitën që diskuton për këtë problem dhe si e keqpërdor një fatkeqësi të qytetarëve tanë që e kanë shkaktuar një shtet mik, i cili ju ka ndihmuar shqiptarëve në të kaluarën, por që sot e ka marr një masë diskriminuese. Një vendim politik që e kemi marrë ne më 17 mars, ka shkaktuar, ka pasur pasoja juridike. Edhe vendimi politik i Byrosë Federale për Sigurime Shoqërore në Zvicër ka qenë vendim politik, ka qenë vendim arbitrar dhe ka qenë në kundërshtim me të drejtën humanitare ndërkombëtare, ka qenë diskriminues për një kategori të caktuar të qytetarëve. Unë po ju them me përgjegjësi se Kosova, pas shpalljes së pavarësisë nuk ka mundur në asnjë rrethanë që brenda natës t'i rregullojë raportet bilaterale me shtet të cilat na ka njohur, e mos të flasim për ato që nuk na kanë njohur dhe është dashur Qeveria zvicerane ta ketë parasysh këtë. Këtë do të duhej ta kishte parasysh edhe Parlamenti i Zvicrës dhe do të duhej lënë një kohë të caktuar që ky problem të zgjidhet në rrugë diplomatike.

Ju e dini kur e kemi formuar Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe sa kohë është dashur të funksionalizohet kjo Ministri. Për t'u integruar në Evropë dhe për t'i pasur ligjet kompatible, neve na duhen 11.000 ligje t'i aprovojmë në parlament. Cila qeveri e një shteti të ri do të mund t'i aprovonte të gjitha këto ligje dhe t'i rregullonte raportet e shtetit të Kosovës me subjektet ndërkombëtare respektive. Këtu qëndron problemi themelor. Problem tjetër, përderisa Rezoluta 1244 është në fuqi, Zvicra duhet ta respektojë marrëveshjen të cilën e ka bërë Serbia, përkatësisht Jugosllavia, pavarësisht se kjo Rezolutë që është në fuqi, nuk është e favorshme për ne. Në raportet ndërkombëtare shteti zviceran duhet të ketë parasysh këtë dhe t'iu kthej menjëherë të drejtat qytetarëve tanë që i kanë fituar atje. Të drejtat i fituara njëherë, në asnjë rrethanë politike nuk mund të abrogohen, se janë në kundërshtim me të drejtën humanitare ndërkombëtare, në asnjë

rrethanë, se ekziston në të drejtën ndërkombëtare statusi i Apatridit. Një qytetar, në një rrethanë të caktuar politike-juridike mund të jetë pa atdhe, mirëpo shteti ku ai gjendet nuk guxon t'ia shkelë asnjë të drejtë sociale që e ka pasur ose të fituar më herët në atë shtet. Në këtë kuptim, unë lus që në rekomandime të angazhohet, të involvohet Parlamenti i Kosovës me Parlamentin Federal të Zvicrës dhe menjëherë t'u bëhet apel atyre që të kenë mirëkuptim dhe t'ua kthejnë të drejtat qytetarëve tanë përderisa në rrugë diplomatike nuk zgjidhet ky problem: Ju faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputeti Berim Ramosaj, le të përgatitet deputetja Teuta Hadri.

BERIM RAMOSAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje për Kabinetin qeveritar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Vërtet ne mundemi gjithë ditën këtu të merremi kush është shkaku e çka është pasoja e këtij procesi. Më së paku në këtë proces duhet akuzuar Zvicrën. Vetë fakti që Enti Federal i Sigurimeve Shoqërore ka iniciuar çështjen e ndarjes së Kosovës, respektivisht përfituesve nga Kosova prej shteteve të tjera apo republikave tjera të ish Jugosllavisë, tregon faktin se ata ne na njohin si entitet politik. Andaj, kanë ndezur sinjalin se duhet të sqarohet kjo çështje, respektivisht të krijojmë marrëdhënie të reja ndërshtetërore, jo vetëm në këtë çështje, por dhe shumë çështje tjera.

Unë nuk dua tash të bëjë rolin e atij që e njeh këtë fushë dhe dëshiron të japë zgjedhjen përfundimtare. Esenca qëndron këtu. Meqenëse është fjala për një marrëveshje ndërshtetërore që, normalisht, bëhet duke u mbështetur në një bazë të juridiksionit edhe të Kosovës, edhe të Zvicrës, andaj çështja e juridiksionit është çështje te ne e hapur. Mirëpo, duke marrë parasysh se po kërkojmë një mori ligjesh që rregullon këtë çështje, është fjala për Ligjin për sigurimin pensional, sigurimin shoqëror, ë përgjithësi, sigurimin shëndetësor dhe shumë ligje tjera të cilat, disa janë në proces, siç është Ligji i punës, por janë disa ligje tjera të cilat edhe në qoftë se janë në proces apo në procedurë të miratimit, duke u mbështetur në buxhetin e Kosovës, nuk kanë shans të implementimit, shtrohet çështja çka? Në qoftë se nisemi nga kjo premisë, atëherë del se na këtë çështje nuk mund ta zgjidhim edhe për shumë vite. Çështja është këtu. Meqenëse është çështja ndërministrore, nuk është çështja vetëm për ministrinë përkatëse, do me thënë një ministri, por shumë duhet të kyçen në këtë proces, prej Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Sigurimeve Sociale, kryeministrit dhe shumë të tjera, çështja është - hajde çka mund të bëjmë në këtë drejtim. Kryeministri duhet të marrë këtë çështje, respektivisht Kabineti qeveritar, se është fjala për një kategori të qytetarëve tanë, të cilët me remintancat e tyre kontribuojnë sot shumë në zhvillimin ekonomik të Kosovës. Në qoftë se nisemi nga kjo premisë, ata janë qytetarë shumë të nderuar, edhe kanë qenë më herët, nuk duam të lëshohemi në histori, por edhe sot, sepse nëse e shikojmë rolin e remintancave, në njërin anë, dhe rolin e qytetarëve të Kosovës në zhvillimin ekonomik, respektivisht në GJDP-në e Kosovës, del se faktori i jashtëm, respektivisht të gjithë emigrantët kosovarë që punojnë jashtë Kosovës, janë kontribuues të mëdhenj të këtij nivel të GJDP-së që është në Kosovë, andaj duhet të bëhet diçka në këtë drejtim.

Unë mendoj, jap edhe si propozim, edhe pse nuk jam jurist në këtë fushë, por duhet të bëhet një marrëveshje e re, në qoftë se ka nevojë tranzitore derisa të zgjidhen çështjet e juridiksionit të Kosovës, respektivisht legjislacionit përkatës. Dhe kjo ka mundësi të arrihet me Entin Federal të Sigurimeve Shoqërore, por duhet një komision, respektivisht një nivel ndërqeveritar t'u jap atyre garancione të plota se do të kemi regjistrin civil të plotë, nuk do të ketë lëshime në keqpërdorim, respektivisht lëshime në aspektin e definimit të saktë të atyre që janë të aftë dhe atyre që nuk janë të aftë, që edhe këtu dyshoj se me këtë nivel të tillë që e kemi mund të realizojmë, mirëpo këtu

duhet të japin garanci të forta dhe të lidhet një marrëveshje e përkohshme derisa të zgjidhen këto çështje dhe vërtet interesimi edhe i zotit Xhemajli, në këtë rast, edhe i shumë deputetëve këtu, është vërtetë të ngrihet një sinjal deri në shkallën më të lartë për Qeverinë e Kosovës, të ndërmarrë diçka. Nuk dëshirojmë ta akuzojmë askënd, por ta ngrehim çështjen në atë nivel që vërtet të zgjidhet çështja e këtyre njerëzve që, në fakt, janë njerëz tanë të cilët edhe pse është gjeneratë e dytë apo e tretë tash në Zvicër, sidoqoftë ata lidhjen me Kosovën e kanë ende shumë dinamike, shumë të qëndrueshme edhe në aspektin e të ardhurave që krijojnë, edhe në aspektin e eksperiencës që e sjellin në Kosovë, edhe në aspektin e kontributeve që i bëjnë prej të gjitha formave të mundshme.

Andaj, unë edhe në herë apeloj dhe respektoj të gjithë ata që kanë nënshkruar këtë kërkesë për interpelancë të Kryeministrit, apeloj që të bëjmë diçka në këtë drejtim. Ne si deputetë do ta bëjmë punën tonë në aspektin e legjislacionit, por punën e Qeverisë ne nuk mund ta bëjmë. Atë duhet ta bëjë Qeveria e Kosovës dhe ta marrë në konsideratë si çështje mjaft serioze. Andaj, edhe një herë po i bëjë apel edhe kryeministrit, edhe Qeverisë të merret më seriozisht me këtë çështje. Nuk është fjala te numrat, nuk është fjala te një numër a është simbolik a nuk është simbolik, është fjala për qytetarët. Nuk është çështje që e zgjidhë ambasada, ambasadori apo ambasada mund ta luaj rolin e fasilituesit shumë të mirë, por jo të atij partnerit serioz në zgjidhjen këtij problemi. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputetja Teuta Hadri, le të përgatitet Hajdin Abazi.

TEUTA HADRI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Ju përshëndes ministra dhe të nderuar deputetë!

Unë përshëndes njëherësh fjalën e kryeministrit, zotit Hashim Thaçi për fjalën e tij mjaft të përmbledhur rreth kësaj pike kaq të ndjeshme dhe vetë fakti që institucionet tona po debatojnë sot në këtë parlament, e shohim gatishmërinë e Qeverisë tonë që janë të gatshëm për të debatuar dhe njëherësh këtë proces ta çojnë më tutje. Njëherësh përshëndes edhe zotin Xhemajli, vërtet si deputet me përgjegjësinë e vet të deputetit e ka dhënë një kontribut shumë të madh sot në këtë seancë. Përshëndes edhe deputetët që e dhanë kontributin e vet, mirëpo të gjithë me punën që e treguan, treguan se të gjithë jemi të gatshëm që në këtë proces të ecim përpara. Njëherësh, si anëtare e Komisionit kam qenë edhe vetë prezent, kur zoti Uels ka ardhur në takim me anëtarët e Komisionit të Shëndetësisë dhe ka treguar për punën e Parlamentit të Zvicrës dhe vetë zotit Uels në punën që janë angazhuar për këtë kategori.

Unë, posaçërisht që mos ta zgjasë shumë, dua ta përshëndes njëherësh Ambasadën tonë në Zvicër, zotin Naim Mala, i cili me kontributin e vet që ka dhënë në këtë kohë, ka qenë mjaft aktiv në këtë çështje, njëherësh zoti Mala na ka sqaruar, ia ka dhënë edhe vet zoti Uels në Komisionin e Shëndetësisë dhe ka treguar se zoti Mala nuk ka dhënë kontribut vetëm si ambasador, por ka dhënë edhe kontributin e vet më të ... si qytetar i Zvicrës rreth kësaj kategorie. Kështu, mendoj se deputetët dhe Qeveria në të ardhmen, angazhimet më të mëdha do t'i bëjë lidhjet mes ambasadës tonë, që krenohen që këtë çështje nuk e kanë ngritur për të bërë manifestime kulturore, por është ftuar direkt zoti Mala në një çështje sociale, ku shqetësohet ai dhe të gjithë qytetarët tanë, prandaj për fjalën time, edhe pse jam anëtare e komisionit, ka pasur nevojë të flas më shumë, nuk dua ta zgjasë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete! Fjalën e ka deputeti Hajdin Abazi, le të përgatitet deputeti Eqrem Kryeziu.

HAJDIN ABAZI: Ju faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,
I nderuar zëvendëskryeministër,
Të nderuar ministra,

Ky problem vërtet është shqetësues për shumë aspekte, por në radhë të parë tregon këtu vështirësitë e shtet formimit tonë, kur ne po na kërkohen shumë gjëra përnjëherë t'i bëjmë, kurse mundësitë tona janë të kufizuara dhe unë druaj se kjo që po ballafaqohemi sot me shtetin zviceran, do të ballafaqohemi edhe me shtetet e tjera të Evropës ku ka mërgimtarë tanë. Natyrisht që mërgimtarët tanë në Zvicër kanë merita të mëdha për krijimin e shtetit tonë, qoftë si lëvizja atdhetare më herët, qoftë si punëtorë që kanë shkuar dhe i kanë mbajtur familjet e tyre dhe me këtë e kanë bërë të mundur qëndresën e popullit tonë dhe mos përruljen për shkak të varfërisë ekonomike, por këtu u tha edhe nga kolegët e tjerë, edhe tash pas lufte ata kapitalet e tyre mezi që presin të vijnë në Kosovë dhe këtu t'i bartin.

Kështu që përgjegjësia jonë në këtë drejtim, vërtet është e madhe ne do të jemi në krye të detyrës. Zoti Emrush Xhemajli, duke qenë se ka jetuar një kohë të gjatë atje dhe e ka ndier përgjegjësinë, u bë shumë mirë që ne, si të thuash, na e shtroi këtë çështje dhe tash ne të përpiqemi ta dinamizojmë sa më tepër që është mundur dhe nga ajo që parashtroi zoti kryeministër, u pa se vërtet Qeveria i ka bërë përpjekjet e veta dhe është në proces e sipër për të gjetur zgjidhje, por derisa të gjendet zgjidhja më adekuate, ne nuk do të mund të jemi të qetë sepse preket fati i drejtpërdrejtë i qytetarëve tanë.

Propozimi im është konkret dhe do të thotë që ne, nëpërmes komisioneve tona, pasi që të bisedohet me shtetin zviceran dhe këtu u thanë se cilat janë nevojat tona legjislative, të përpiqemi ta përshpejtojmë dinamikën e punës sonë në këtë drejtim, me qëllim që të ofrojmë mundësi që të mos i humbin këto të drejta, por t'i vazhdojnë të drejtat, vetëm se tash në emër të shtetit të Kosovës për të cilin kanë luftuar dhe kanë kontribuar shumë mërgimtarë shqiptarë në Zvicër dhe në Evropë kudo. Me këtë rast dua të theksoj se këto vështirësi dhe këto probleme me të cilat po ballafaqohemi, janë edhe në kuadër të mundësive tona tepër të kufizuara dhe me të vërtetë duhet të jemi të gjithë unik që të përpiqemi ta gjejmë një zgjidhje, të paktën të kërkojmë mirëkuptim nga Qeveria zvicerane derisa ne të përgatitemi që të mos cenohen të drejtat e qytetarëve të Kosovës në Zvicër. Duke qenë se Zvicra është një prej shteteve e cila që nga fillimi ka qenë e angazhuar për pavarësinë e Kosovës, unë kam besim se ata do të tregojnë mirëkuptim. Natyrisht, si shtet ata kërkojnë zgjidhje legjislative ose ligjore dhe ne duhet t'i kryejmë punët tona. Thjeshtë, ky është një shqetësim me të cilin vërtet duhet të preokupohemi dhe komisionet përkatëse ta marrin më seriozisht në këtë punë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputeti dhe anëtar i Kryesisë, Eqrem Kryeziu, le të përgatitet me hapësirën kohore që i ka mbetur Grupit të LDD-së, prapë Qamile Morina e ka kërkuar fjalën, pas zotit Kryeziu.

EQREM KRYEZIU: Ju faleminderit, zoti kryesues! Po kërkoj lejen tuaj që të përshëndes zëvendëskryeministrin, ministrat, natyrisht edhe deputetët e Parlamentit të Kosovës!

Unë e mora fjalën jo për të thënë diçka të re, por për faktin se kam pasur cilësinë e anëtarit të Kryesisë, kam pasur një kontakt me zyrtarët zviceranë, edhe me deputetin të cilin e apostrofoi zoti Xhemajli, edhe me përfaqësuesit e Sindikatës Unia. Ajo që në atë takim më la pa tekst, ishte konstatimi i deputetit zviceran se, si duket, autoritetet zvicerane, ndër ta edhe anëtarët e Parlamentit zviceran, janë të shqetësuar më shumë se sa Kosova për këtë fenomen. Këtë desha të them dhe, për pasojë, mua më vjen shumë mirë që me iniciativën e zotit Xhemajli dhe të tjerëve, sot është shqyrtuar kjo çështje e sigurimeve shoqërore të mërgatës sonë atje, do të thotë është një

temë e denjë për Kuvendin e Kosovës. Gjithashtu, më lejoni të them se me sa dëgjova edhe nga paraqitja e zotit kryeministër, është diagnoza shumë e saktë.

Problemi kryesor është se nuk komunikojnë infrastruktura ligjore e Kosovës me atë të Zvicrës. Unë do të isha për solucionin që e tha zoti Ramosaj, të cilin gjithashtu e falënderoj, se para se të shkoja unë në takim, e konsultova zotin Ramosaj, ku është, cilat janë ato pikat në të cilat do të duhej unë të mbështetesh. Në qoftë se kjo është e mundshme që përdërisa të formohet infrastruktura ligjore, e cila korrespondon me atë zvicerane dhe hyn në komunikim, atëherë ndoshta do të duhej bërë përpjekje thjeshtë politike, diplomatike dhe qeveritare që kjo punë të zgjidhet me një marrëveshje tjetër. Sidoqoftë, unë edhe një herë po them se më vjen shumë mirë për këtë fenomen të qytetarëve tanë që po bisedohet sot në Parlament. Ju faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputetja Qamile Morina, pastaj unë do ta shfrytëzoj edhe në rolin e kryesuesit, por do të flas si deputet.

QAMILE MORINA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Me vëmendje dëgjova diskutimet dhe kishte tendencë dhe disa diskutime që faji t'i hidhet Qeverisë së Zvicrës. Do të ishte shumë gabim i madh dhe do të duhej ata deputetë që diskutuan në këtë mënyrë, të kuptojnë se Zvicra është vendi me demokraci të lashtë dhe po ta lexonin materialin, do ta kishin të qartë që nuk qëndrojnë thëniet e tilla.

Në fillim të vitit, unë dua vetëm ta shpjegoj pse ka ardhur deri këtu. Në fillim të vitit 2008, Zvicra ka bërë revidimin e legjislacionit të vet për sigurimet shoqërore. Ajo këtë revidim të legjislacionit nuk e ka bërë vetëm për komunistin shqiptar, por e ka bërë për tërë legjislacionin e sigurimeve shoqërore, që përfshin të gjitha kategoritë. Iniciativa ka qenë nga qarqet politike për luftën ndaj abuzuesve të cilët shtiren të sëmurë me qëllim të përfitimit të pensioneve. Do të thotë, ne jemi dëshmitarë që kohët e fundit edhe tek ne kemi pasur. Ata kanë qenë të detyruar të organizojnë hetues të cilët në Kosovë do të bënin hulumtimin e këtyre njerëzve të cilët gëzojnë pensione invalide dhe përvoja e tyre ka qenë shumë e hidhur duke u kërcënuar. Do të thotë, nuk është çështja e arritjes së marrëveshjes që ne të kemi legjislacionin e njëjtë, është tepër e gabuar. Ajo fillestare, fillestare edhe kalimtare, do të thotë faza kalimtare, kërkohet që Qeveria e jonë të jetë garant i mbikëqyrjes së këtyre njerëzve që do të vijnë e do të jetojnë në Kosovë, ata ta kenë adresën ku mund t'i marrin informatat për njerëzit që do të jetojnë në Kosovë. Ajo që kërkohet dhe është e domosdoshme të bëhet, është që Grupi ndërmintor të caktojë në task-forcë, e cila do të kishte të qartë detyrat e veta për mbikëqyrjen e këtyre njerëzve.

Sa i përket legjislacionit, komentet tona kanë qenë që ne jemi të bindur që as legjislacioni i ish republikave të Serbisë nuk është i përafërt me legjislacionin e Zvicrës, që edhe e kemi marrë pohimin e tyre. Do të thotë, për fazën kalimtare është e nevojshme që Qeveria jonë të krijojë në task-forcë, e cila do të jetë garant e mbikëqyrës i këtyre njerëzve dhe do të mund të bashkëpunojë me Qeverinë e Zvicrës. Sa i përket, u përmend se një vit ata na kanë njoftuar neve, na kanë paralajmëruar, unë dua t'ju them që ka qenë 3 muaj dhe do të thotë në fillim të vitit 2010 dhe vendimi është marrë në prill të vitit 2010. Kjo ka qenë arsyeja që ne mendojmë se ka qenë e ngutshme kjo periudhë prej tre muajve dhe është dashur që t'i jepet hapësirë më shumë Qeverisë tonë duke pasur parasysh që ajo është e mbërthyer me shumë probleme tjera dhe kishte për të qenë e rrugës që të ishte një kohë më e gjatë. Ky ka qenë mendimi edhe i parlamentarëve të Zvicrës, që e kanë ndarë me ne. Kështu që unë kisha kërkuar që në një mënyrë të kemi të qartë që nuk është çështje e hedhjes së fajit apo pozitës-opozitës. Ajo që është kryesore sot, është që të gjejmë një zgjidhje për bashkatdhetarët tanë. Ju faleminderit!

KRYESUESI IBRAHIM GASHI: Ju faleminderit, zonja deputete! Edhe unë tash do t'i them disa fjalë lidhur me këtë. Së pari, përshëndes parashtruesin e këtij mocioni për interpelancë, deputetin Emrush Xhamajli, natyrisht edhe Qeverinë për reflektimin korrekt të menjëhershëm për ta proceduar dhe sidomos përshëndes të gjithë deputetët që dhanë kontributin, pa dashur t'i komentoj qasjet që kishin për të gjetur fajtorin dhe, si të them, për të potencuar konsekuencat e kësaj vonese.

Unë, sa po e kuptoj, çështja nuk është shumë e natyrës politike, çështja pothuaj krejtësisht e natyrës formale dhe teknike dhe, natyrisht, shteti i Zvicrës është shtet që në njëfarë mënyre ka legjislacion dhe ka, si të them, qëndrueshmëri juridike të konsoliduar dhe që nuk bën asgjë, domethënë, për hatër të dikujt ose për hir të situatave që i ka një shtet emergjent, qysh është Kosova pas daljes prej lute e në fazat e ndërtimit të shtetit. Ata kanë kërkuar vetëm që ne të kemi mirëkuptim dhe të adoptojmë një pjesë të legjislacionit për ta bërë, përkatësisht kompatibil me ligjet në fuqi për këto çështje që i ka shteti i Zvicrës dhe po mendoj se është edhe një çështje edhe më esenciale për të cilën, natyrisht, topi është te ne, nuk është te Zvicra, është çështja e dokumentacionit. Ata kanë ngritur problemet me dokumentacionin që e kanë dhe dikush e tha këtu se duhet të vazhdojë të respektohet Marrëveshja 1244. Unë konsideroj që kjo nuk mund të respektohet pikërisht për hir të dokumentacionit, se gjatë periudhës së ekzistimit të kësaj Marrëveshjeje 1244, në Zvicër dhe gjithkund në diasporë janë shfrytëzuar nga bashkëqytetarët tanë dy lloj dokumentacionesh, dokumentacionet e shtetit të Jugosllavisë, përkatësisht të Serbisë, dhe dokumentacionet e UNMIK-ut. Situata ka ndryshuar kur qytetarët tanë tash shkojnë për shkak të skadencave të atyre dokumenteve, shkojnë me dokumente të shtetit të Kosovës. Kjo nuk është e njëjtë dhe, natyrisht, shteti reagon dhe kërkon, si të them, reagimin tonë për të bërë, në njëfarë mënyre për të dhënë garancione për validitetin dhe në njëfarë mënyre vërtetësinë e atyre dokumenteve dhe kjo, për fat të keq, në disa raste nuk është dhënë me kohë nga ana jonë dhe ka krijuar alibinë që ata të reagojnë se ka keqpërdorime përmes dokumentacionit. Në këtë kuadër, po mendoj që situata bëhet e ngutshme që të reagojmë te çështja e regjistrave civilë, përkatësisht te çështja e dokumenteve të shtetit të Kosovës, të cilat i shfrytëzojnë bashkëvendësit tanë në Zvicër dhe këto, natyrisht, nuk mund t'i japë kush përveç ministrive përkatëse dhe Qeverisë, domethënë garancionet për validitetin dhe për vërtetësinë e këtyre dokumenteve. Ne jemi në një fazë tash të nxjerrjes së dokumenteve me standardet e Bashkimit Evropian, që duhet të fillojnë ... Prandaj, po mendoj se krejt çështjet që i ngritëm, duke ju dhënë edhe konotacion politik, mendoj se nuk janë të tilla. Këtu po flas si deputet. Mendoj që janë më shumë të natyrës formale, juridike dhe teknike se sa të natyrës politike sepse, tek e fundit, shteti i Zvicrës qëndrimin e tij karshi zhvillimeve politike në Kosovë e ka bërë të njohur me kohë veprimet e tij në procedurat para shpalljes dhe sidomos pas shpalljes së shtetit me njohjen e tij. Ju faleminderit!

Fjalën e ka, deputeti Arsim Bajrami dhe i fundit i paraqitur është anëtari i Kryesisë, deputeti Sabri Hamiti.

ARSIM BAJRAMI: Ju faleminderit, i nderuari kryesues! Do të diskutoj pikërisht në frymën që diskutuat edhe ju, por paraprakisht dëshiroj ta falënderoj deputetin Xhemajli që e ka ngritur këtë interpelancë, së paku për të na treguar se ekziston mocioni i interpelancës dhe duhet praktikuar në kontrollin politik.

Çështja që po e diskutojmë është një çështje që është e dhimbshme, por është një çështje që duhet ta marrim pa emocione dhe duhet ta trajtojmë pa emocione, duke e zhveshur nga aspektet politike. Pa marrë parasysh politikat aktuale të Qeverisë zvicerane ndaj emigracionit, unë mendoj që është një çështje të cilën Zvicra e ka praktikuar edhe në raport me shtetet tjera që janë shpëputur pas

shkatërrimit të Jugosllavisë dhe është Kosova vendi i fundit që po ndeshet me këtë problem. Mua më kujtohet para 4-5 viteve problemi ka qenë aktual në Maqedoni dhe në vendet tjera.

Unë shoh dy segmente të zgjidhjes së problemit dhe dëshiroj që Kuvendi të miratojë rekomandime, siç propozoi edhe zotëri Xhemajli në ekspozenë e interpelancës, që të dalë me disa rekomandime dhe unë mendoj që kjo çështje mund të zgjidhet në dy segmente, në segmentin legal dhe atë pragmatik, pra dy janë segmente. Segmenti legal, që ne duhet sa më shpejt të adoptojmë legjislacionin. Ky është legjislacion i ri, nuk bëhet fjalë për harmonizimin e ligjeve tona me ligjet zvicerane, sepse ne nuk kemi këso ligje, por duhet sa më shpejtë këto ligje të miratohen dhe unë e quaj neglizhencë faktin që ministria përkatëse nuk i ka ... këto ligje edhe për faktin që qytetarët tanë janë ndeshur me këtë problem.

Mirëpo, legjislacioni, siç tha edhe kryeministri, do të vonohet. Nuk ka gjasa para këtij viti dhe po supozojmë që ligjet do të jenë të gatshme në fillim të vitit të ardhshëm, më 2011. Unë e di se edhe nja 6 muaj apo një vit merr kohë edhe përgatitja dhe nënshkrimi i marrëveshjes me Qeverinë Zvicerane, janë procedurat adekuate dhe kjo është një kohë e gjatë, e cila këtë problem sa do ta rrisë dhe për këtë unë mendoj se ne do të gjejmë një zgjidhje pragmatike, një zgjidhje që disa deputetë e përmendën në atë mënyrë që këtë problem do të mundohemi ta zgjedhim me kontakte të drejtpërdrejta me Qeverinë zvicerane, duke kërkuar mirëkuptim nga ata që të fillojë të rrjedhë procesi i sigurimeve sociale dhe pensionale për faktin që është një shtet i ri dhe janë në përgatitje e sipër ligjet adekuate.

Unë mendoj që kjo mund të bëhet në dy mënyra. Mënyra e parë që në nivelin më të lartë politik të Qeverisë, në nivel të kryeministrit ose të ministrit të Punëve të Jashtme të insistohet në arritjen e një memorandumit të mirëkuptimit, një memorandum të mirëkuptimit që nuk është një akt legal, por që është një shprehje e vullnetit të mirë me të cilin do të kërkohet nga Qeveria zvicerane mirëkuptim për faktin që ne jemi shteti i ri dhe nuk kemi mundur me kohë t'i bëmë këto ligje. Në atë memorandum mirëkuptimi të deblokohen pagesat e sigurimeve pensionale dhe të sigurimeve tjera dhe të jepet zotimi i fortë politik se deri në mesin e vitit të ardhshëm këto ligje do të adaptohen dhe do të fillojnë procedurat e menjëhershme të nënshkrimit të marrëveshjes.

Unë mendoj se Qeveria zvicerane është duke bërë një veprim që e ka bërë edhe me shtetet tjera. Zvicra është një shtet ligjor, një shtet që nuk ka politika diskriminues ndaj askujt, por ka marrë këtë veprim në mënyrë që vërtet ne të përgatitemi, sepse ne nuk mund të thirremi në marrëveshjet që i ka nënshkruar ish Jugosllavia, nuk është mirë edhe ne si deputetë të insistojmë që të marrim atë që është e mirë nga Rezoluta 1244. Në fakt, ne nuk duhet fare të thirremi në trashëgiminë juridike të marrëveshjeve ndërkombëtare të ish-Jugosllavisë. Është e vërtetë që këto janë pasoja të dhimbshme. Është e vërtetë që ky vakum ligjor ka krijuar dhe pasojat e dhimbshme, por ne duhet në veprimet politike dhe në strategjinë legjislative përparësi t'iu japim kryesisht ligjeve dhe veprimeve të cilat i shmangin dëmet që mund të pësojë një pjesë e diasporës tonë dhe unë mendoj që kjo çështje me një vullnet të madh politik, me një trajtim çfarë edhe u premtua nga kryeministri, por me një përkushtim vërtet të madh politik mund të insistohet me një qeveri mike, siç është Qeveria zvicerane, që të arrihet një memorandum mirëkuptimi, i cili do të ishte me një vlefshmëri të caktuar kohore derisa ne të bëhemi gati që vërtet t'i përmutshim të gjitha obligimet.

Është edhe një segment tjetër, është segmenti i besimit. Në fakt, ne me regjistrat e gjendjes civile duhet ta shtojmë besimin, duhet ta shtojmë besimin sepse Qeveria zvicerane ka konstatuar se në tërë ish Jugosllavinë ka pasur akte manipulative, ka pasur veprime të cilat e kanë ulur besimin dhe unë mendoj që me regjistrin civil të qytetarëve ne duhet ta shtojmë besimin dhe duhet të bindim

Qeverinë zvicerane se jemi një shtet, i cili vërtet funksionon me rregulla dhe standardet më të larta sa i përket regjistrimit civil.

Unë do të përkrahja plotësisht të gjitha angazhimet të cilat kanë qenë në këtë drejtim dhe do të insistoja që ne në fund të miratojmë disa rekomandime dhe të insistojmë që kjo çështje të zgjidhet sa më shpejt. Kuptohet, nuk do të mund të zgjidhet menjëherë, por të gjejmë një zgjidhje të përkohshme, cili do të jetë opsioni i vetëm që do t'i shmangte dëmet e mëtejshme të qytetarëve tanë që jetojnë përkohësisht në Zvicër.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! I fundit nga deputetët, i paraqitur për diskutim lidhur me këtë pikë, deputeti Sabri Hamiti

SABRI HAMITI: Ju faleminderit, zoti kryesues i seancës!

Zoti zëvendëskryeministër, ministra,
Kolegë deputetë,

Ne dëgjuam mendime, unë do të thosha mjaft racionale rreth çështjes që është shtruar sot nga grupi i deputetëve për interpelancë. Problemi ekziston dhe prek shumë njerëz, shumë familje, por problemi u pa që nuk mund të zgjidhet përnjëherë, por duhet të zgjidhet në mënyrë sistematike dhe sistimore. Ky tip zgjidhjeje, u pa edhe këtu që kërkon patjetër hartimin e ligjeve themelore të kësaj veprimtarie dhe këtë hartim nuk duhet ta lidhim me rastin, por unë mendoj se është domosdo të hartohen, sepse ne duhet të mendojmë edhe për këtë çështje, por edhe për çështjen e sigurimeve dhe të pensioneve të njerëzve brenda Kosovës, mos të ngrehim vetëm teori sociale të veçanta prej rasti në rast, por të shohim ku e kemi problemin më themelor.

Ajo që u quajt këtu disa herë kontratë, marrëveshje e re me Kosovën, po shihet që nuk ka të bëjë vetëm me ligjet, tash po kaloj në praktikën, por ka të bëjë me atë se kush garanton sjelljen sipas ligjeve dhe kontratave përtej Kosovës me njerëzit që i marrin ato beneficione, por jetojnë në Kosovë. Unë këtu po ndalem, veç se po ju dëshmoj që kam parë emision dokumentar shumë interesant të Zvicrës para nja një jave, ku shtrohet në një film dokumentar nja 30 minuta ky problem dhe lidhet pikërisht me Kosovën. Unë mund ta përmend edhe emrin, por edhe mund të mos e përmendë, është një mjek që është i njohur në Kosovë, e që është dënuar për sjellje, për thyerje të kodit zviceran, është dënuar edhe me burg, edhe me para, që është një shumë shumë e madhe. Desha të them që mua një kolegë ma tha tash, ajo është punë milicie që t'i ndjekë njerëzit të cilët nuk i përmbahen ligjit. Po, nëse është në Zvicër, por kemi të bëjmë edhe me njerëz që jetojnë në Kosovë dhe nuk u përmbahen atyre sjelljeve, kodeve. Nëse Kosova si Qeveri hynë në marrëveshje me ta, është e detyrueshme që t'i ndjek kjo dhe këtu kemi të bëjmë me garantimin e sjelljes në bazë të ligjeve dhe të konventave ndërkombëtare. Dhe, unë, në të vërtetë fjalën e mora për mos ta marrë edhe një herë në emër të Grupit. Unë i lexova rekomandimet që i ka përgatitë grupi që ka kërkuar interpelancën dhe unë i përkrah plotësisht edhe në emër të grupit të LDK-së të gjitha këto rekomandime. Ndoshta pasi dëgjova diskutimit shumë interesant të kolegut Arsim, mendoj se mund të hyjë dhe një pikë - Memorandumi i përkohshëm i mirëkuptimit derisa të bëhen këto zgjidhje sistimore.

Përndryshe, të gjitha ofrimet tjera të rekomandimeve, që janë bërë në emër të Grupit, 7 janë, nëse i shtohet edhe kjo, propozimi i Arsimit është e teta, Grupi ynë do t'i votojë dhe mendoj se janë shumë të mira, sepse reflektojnë atë që u tha tërësisht këtu dhe reflektojnë kërkesat, udhët që duhet t'i bëjë Kuvendi karshi Qeverisë për një çështje kaq të rëndësishme. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Hamiti!

Fjalën e ka deputeti, përkatësisht parashtruesi i mocionit për interpelancë, deputeti Emrush Xhemajli.

Në emër të Qeverisë, nëse doni të jeni i fundit për t'i parashtruar ato, ka kërkuar zëvendëskryeministri. Zëvendëskryeministër, e keni fjalën, për arsye që parashtruesi të jetë i fundit.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Ju faleminderit, zoti kryeses!

Zoti Xhemajli besoj që ka mirëkuptim për arsye se parashtruesi i mocionit është i fundit dhe ai i cili jep rekomandimet dhe votohen apo jo.

Ju faleminderit për diskutimin e të gjithë deputetëve dhe angazhimin që e bënë. Po mendoj se e arritura e parë e këtij Kuvendi është që për herë të parë po flasim për një temë racionale, për jetët e njerëzve. Natyrisht, ne kemi fol shumë mirë dhe për jetët apo do të thosha për fatin kolektiv dhe më pak për atë individual.

Unë mendoj se edhe kjo është një shenjë e maturisë së institucioneve tona dhe me siguri që në këtë drejtim edhe Qeveria e ka dhënë dhe do ta japë kontributin e vet. U përmendën me të drejtë dhe pa drejtë disa data, disa informata që unë nuk dua t'i them, por problemi ka lindur në vitin 2010, jo në 2008, besoj të gjithë e dinë. Po ashtu, dua të them se janë disa probleme, që në radhë të parë janë legale dhe pastaj janë probleme që dikush e ka perceptimin politik.

Ndryshimet legale që kanë ndodhur në raport me Kosovën, kanë kërkuar jo vetëm me Zvicrën, por edhe me vendete të tjera rishikimin e marrëveshjeve që kanë qenë paraprake. Ne jemi në proces edhe me Austrinë, edhe me Gjermaninë dhe me disa shtete të tjera, që disa prej tyre apo marrëveshjeve do t'i rinënskruajmë, disa do t'i përmirësojmë, por disa vetëm emrin. Në këtë drejtim kemi bërë angazhime konkrete dhe me Zvicrën. Unë e di dhe u përmendën disa raste që mund ketë pasur neglizhencë, unë nuk e mohoj që brenda Qeverisë dikush ka pasur ndonjë veprim neglizhent dhe ne do të jemi korrekt në këtë drejtim, nëse dikush nuk e ka përcjellë çështjen ashtu si duhet. Por, po ashtu besoj, të gjithë ne e pranojmë se kjo nuk varet nga vullneti i njëanshëm. U dhanë propozime shumë të mira, por besoj se orientimi ynë i angazhimit do të jetë në dy drejtime. E para, do të jetë në zgjidhjen afatshkurtër, që u përmend edhe nga profesori Bajrami, me të drejtë, dhe zgjidhja tjetër është afatgjatë dhe që kërkon një sistemim më të gjerë edhe në kuptimin juridik nga ne, por edhe të angazhimit me shtetin e Zvicrës.

Mirëkuptimin afatshkurtër, ne jemi të gatshëm si Qeveri ta bëjmë një memorandum të tillë, po ashtu jemi të gatshëm që ta përmirësojmë gjendjen e regjistrave civilë. U përmendën dy probleme. Problemi i parë, që e përmendi deputetja Hundozi në vlerësimet për aftësinë e kufizuar, pra për aftësinë e veprimit, sido që ta quajmë, dhe unë po them, ka mundur të ketë ndonjë lëshim dhe unë e ftoj edhe deputeten Hundozi dhe të tjerët që janë anëtarë të atij komisioni, të jenë korrekt në këto vlerësime, sikur që janë vlerësimet apo gabimet e tjera që mund të jenë në shënime që japin nga regjistrat civil dhe në momente të caktuara, e përmendi deputeti Hamiti, mund të ketë edhe individë të tillë, por unë besoj që do të marrim masa adekuate. Keqpërdorimi i tretë, që po ndodhë ditëve të fundit, është nga individët të cilët në emër të zgjidhjes së këtij problemi, në mënyrë individuale një nga një, po bëjnë matrapazllëk, nëse më lejohet ta them kështu. Edhe këtu duhet të ketë veprime konkrete nga ana e organeve tona.

Dhe, krejt në fund, më lejoni të them që ne do ta marrim shumë seriozisht këtë punë, edhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, ministri, në veçanti zëvendësministri, por po e them që

nga sot do të angazhohet edhe Zyra e kryeministrit. Ne do të jemi ata që do të kemi angazhim konkret, përgjegjësi konkrete për çështjen dhe do t'i raportojmë edhe Kuvendit drejtpërdrejt.

Përndryshe, rekomandimet që vijnë nga Kuvendi do t'i respektojmë në tërësi dhe unë jam i bindur që të zgjidhet ky problem, i cili besoj që është problem akut për shtetasit tonë që kanë punuar dhe vepruar në Zvicër, por është problem i cili mund të na përsëritet edhe në rastet e tjera apo me shtetet e tjera. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti zëvendëskryeministër!

Fjalën e ka, siç thashë, parashtruesi i mocionit, deputeti Emrush Xhamajli.

EMRUSH XHEMAJLI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I përshëndes të gjitha diskutimet shumë konstruktive që u mbajtën këtu. Përshëndes edhe angazhimin e Qeverisë. Unë vetëm desha të tërheq vëmendjen para se t'i lexoj rekomandimet. Numri i të prekurve, edhe unë në fillim kam menduar se është i vogël nga kjo prishja e marrëveshjes, mirëpo direkt preken së paku 170.000 punëtorë atje, ndërkaq indirekt shumë më tepër njerëz që janë këtu në Kosovë. Unë mund t'i marr vetëm dy shembuj. I pari është sipas marrëveshjes së mëhershme. Një gurbetçarë që ka punuar atje, ka mund të sëmuret këtu dhe është kontrolluar këtu te mjeku. Kanë qenë valide vërtetimet që janë lëshuar këtu dhe me ato ju kanë kompensuar kur është kthyer në Zvicër. Kjo më nuk është, kështu që pa përjashtim, të gjithë kanë mundësi të sëmuren ata që vijnë këtu, kështu që nuk kemi çka e diskutojmë numrin sa janë të prekur, është e saktë kjo.

E dyta, te shërbimet për pagesat për shtesat fëmijërore. Numri i atyre që kanë fëmijë këtu dhe janë duke jetuar atje dhe vijnë këtu shtesat, më herët janë kompensuar, sot nuk kompensohen. Shtetasi i Republikës së Kosovës Imri Blinishti, i ka 5 fëmijë këtu. Më herët për secilin nga ata ka marrë 200 franga zvicerane, ndërkaq tash nuk e merr asnjë. Shuma mujore është 1000 franga, shuma vjetore është, qitja lapsin, së paku 12.000 franga. Nëse kjo është pak, nëse bëhet fjalë këtu për cikërrima, atëherë unë nuk e di çka e quajmë diçka me rëndësi, unë nuk e di kriteri çka është pak këtu në Kuvendin e Kosovës.

Tash, për të mos marrë kohë, te rekomandimet. Nuk po e lexoj preambulën, se e keni të gjithë, po i lexoj vetëm pjesën e rekomandimeve.

Me qëllim që sa më parë të jetë e mundur të rinegociohet, të nënshkruhet dhe të zbatohet Marrëveshja për sigurime shoqërore ndërmjet Kosovës dhe Zvicrës, Kuvendi i Kosovës jep këto rekomandime për Qeverinë e Kosovës:

1. Kuvendi i Kosovës i rekomandon Qeverisë që në fushën e politikave sociale të ketë prioritet rinegocimin e Marrëveshjes për sigurimet shoqërore me Zvicrën.
2. Kuvendi i Kosovës i rekomandon Qeverisë t'i sjellë me përparësi në Kuvendin e Kosovës ligjet e nevojshme që hapin rrugë për nënshkrimin e Marrëveshjes për sigurimet shoqërore ndërmjet Kosovës dhe Zvicrës: Ligjin për sigurimet pensionale, Ligjin për sigurimin invalidor, Ligjin për sigurimet shëndetësore, përkatësisht përshtatjen e tyre që e bënë të mundur nënshkrimin e Marrëveshjes për sigurime shoqërore Kosovë – Zvicër.
3. Me ligjet që miratohen në Kuvend dhe me aktet nënligjore të Ministrisë përkatëse, të parashihet eksportimi i mjeteve nga përfituesit e sigurimeve shoqërore.

4. Të formohet Grupi punues ndërmënistror që merret me çështjet që kanë të bëjnë me koordinimin e aktiviteteve që e bëjnë të mundur arritjen e Marrëveshjes Zvicër-Kosovë për sigurimet shoqërore.
5. Tash shteti ynë duet t'i japë të gjitha garancitë për transparencë të plotë lidhur me përfituesit e sigurimeve shoqërore që kanë qenë në Zvicër dhe janë kthyer apo do të kthehen në Kosovë. Këtu hynë rregullimi i regjistrimit civil dhe i mekanizmave mbikëqyrës që pamundësojnë abuzimin me pensionet invalide.
6. Të bëhet një takim i lartë qeveritar Kosovë - Zvicër lidhur me rinegocimin e Marrëveshjes për sigurimet shoqërore.
7. Të bëhen njoftimet e nevojshme për qytetarët e Republikës të Kosovës që jetojnë në Zvicër apo që janë në Kosovë, me qëllim që të dinë të sillen deri në nënshkrimin e marrëveshjes së re, për të mos rënë pre e spekulatorëve dhe agjencioneve që i dezinformojnë ata për qëllime të përfitimit, dhe
8. Të nënshkruhet Memorandumi i mirëkuptimit për zgjidhje adekuate deri në zgjidhjen sistimore të çështjes.

Këto ishin propozim - rekomandimet. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet Xhemajli!

Në vazhdim, referuar nenit 44, paragrafi 4, pika (d) të Rregullores, kërkohet deklarimi me votim për miratimin e tekstit të mocionit të propozuar. Në sallë kemi të pranishëm numrin e nevojshëm, pra janë 62 deputetë të pranishëm.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.

Votojmë tash:

Do të thotë, në mënyrë unanime konstatoj se me 62 vota "për", asnjë "kundër" dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi tekstin e mocionit të propozuar nga deputeti Emrush Xhemajli dhe grupi i deputetëve nënshkrues lidhur me shkëputjen dhe rinegocimin e Marrëveshjes mbi sigurimet shoqërore ndërmjet Zvicrës dhe Kosovës. Ju faleminderit.

Kalojmë në pikën tjetër:

3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për persona të zhdukur

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, janë përmbushur kushtet për shqyrtimin në parim të këtij Projektligji. Para se t'ia jap fjalën përfaqësuesit të Qeverisë, përkatësisht zëvendëskryeministrit, zotit Hajredin Kuçi, që në emër të Qeverisë dhe të deputetëve të Kuvendit të prezantojë Projektligjin. Dua që në emër të deputetëve të Parlamentit të Kosovës të përshëndes përfaqësueset e shoqatës "Thirrjet e nënave", në krye me kryetaren, zonjën Kumnova, që sot janë prezentë në Parlamentin e Kosovës.

Fjalën e ka zëvendëskryeministri Kuçi për ta paraqitur projektligjin.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Ju faleminderit, i nderuari kryesues!
Kryeministër,
Të nderuar deputetë,

Përfaqësues të shoqatës “Thirrjet e nënave”,

Zonja dhe zotërinj,

Jam i nderuar që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës mund ta paraqesë para jush Projektligjin për personat e zhdukur.

Nevoja për nxjerrjen e një projektligji të tillë konsiston në numrin e madh ende të personave të zhdukur, fati i të cilëve nuk dihet dhe nuk është zbardhur, si dhe po ashtu në ekzistimin e legjislacionit adekuat për rregullimin e kësaj fushe. Projektligji për persona të zhdukur ka për qëllim që të mbrojë të drejtat dhe interesat e personave të zhdukur dhe familjarëve të tyre, në veçanti të drejtën e familjarëve për të ditur fatin e personave të zhdukur në Republikën e Kosovës.

Projektligji përcakton të drejtat e personave të zhdukur, të drejtat e familjarëve për t’u informuar për fatin e personave të zhdukur, të drejtat e familjarëve lidhur me statusin ligjor të personave të zhdukur. Po ashtu, ky projektligj përcakton ndërprerjen e kërkimit për personin e zhdukur, duke përcaktuar që kërkimi për personin e zhdukur konsiderohet si i përfunduar kur të jetë i gjetur personi apo kur të jenë identifikuar mbetjet mortore të tij apo saj.

Në këtë projektligj përcaktohet se në qoftë se personi i zhdukur shpallet i vdekur sipas Ligjit të procedurës jokontestimore, përkatësisht neneve 59 dhe 72 të këtij Ligji, kërkimi për personin e zhdukur vazhdon derisa të jetë gjetur personi apo të jetë bërë identifikimi i tij apo i saj. Kjo gjë është bërë duke marrë parasysh ndjeshmërinë dhe shqetësimet e të afërme të personave të zhdukur.

Me këtë projektligj përcaktohen kompetencat dhe përgjegjësitë e Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur, si organi qeveritar më i lartë i cili koordinon aktivitetet e institucioneve vendore dhe bashkëpunon me institucionet dhe organizatat ndërkombëtare dhe akterët e tjerë me qëllim të zbardhjes së fatit të personave të zhdukur. Anëtarët e këtij komisioni do të jenë nga të gjitha institucionet që një apo në mënyrë tjetër merren me fatin e personave të zhdukur. Komisioni do të mbrojë të drejtat dhe interesat e personave të zhdukur dhe familjarëve të tyre. Ky Komision do të informojë familjarët e personave të zhdukur, duke bashkëpunuar me shoqatat që kanë të bëjnë me personat e zhdukur.

Me këtë Projektligj, po ashtu, krijohet regjistri qendror për personat e zhdukur. Në regjistrin qendror do të mbahen të dhënat të cilat janë marrë nga të gjitha burimet në dispozicion për t’i ndihmuar gjetjen dhe identitetin e personave të zhdukur dhe vendin dhe rrethanat e zhdukjes së tyre. Qasja në regjistrin qendror do t’u mundësohet familjarëve dhe përfaqësuesve ligjorë të tyre dhe organizatave të tjera që kanë mandatin për ta kryer kërkimin, gjetjen dhe identifikimin e personave të zhdukur.

Të dhënat nga regjistri do të jenë në dispozicion në pajtim me legjislacionin përkatës për mbrojtjen e të dhënave personale. Autoriteti mbikëqyrës për monitorimin dhe zbatimin e këtij ligji do të jetë Zyra e kryeministrit. Projektligji për personat e zhdukur është i përgatitur nga Zyra e kryeministrit, në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe standardet e BE-së dhe në konsultim edhe me shoqatat të cilat merren me fatin e personave të zhdukur.

Më lejoni krejt në fund, t’u ftoj ju, të nderuar anëtarë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, që ta përkrahni këtë projektligj dhe të jepni kontributin tuaj në përmirësimin eventual të tij. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti zëvendëskryeministër!

Në emër të Komisionit funksional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, fjalën e ka kryetari i komisionit, deputeti Fatmir Rexhepi.

FATMIR REXHEPI: Ju faleminderit!

Përshëndetje, zoti kryesues!

Përshëndetje për Qeverinë!

Të nderuar kolegë deputetë,

Po ashtu, në emër të komisionit që e drejtoj, përshëndetje për praninë e delegacionit të shoqatës “Thirrja e nënave”. Sot para veti e kemi Projektligjin ose draftin e parë lidhur me aktivitetet për institucionalizimin e mëtutjeshëm të njërës ndër çështjet që e preokupon sot shoqërinë e Kosovës, pra lidhur me fatin e personave të pagjetur dhe aktivitet e tjera që e presin Qeverinë, që besoj është edhe një hap i mirë, i rëndësishëm së veçantë, ashtu qysh u tha edhe nga zëvendëskryeministri këtu. Çështjet e adresuara në projektligj për fatin dhe familjarët të cilët janë në kërkim se sipër, mendoj që kërkojnë që edhe më shumë ne si institucione të vendit të bëjmë, të punojmë bashkërisht në mënyrë që qëllimi i këtij projektligji të japë rezultate të cilat i presin familjet dhe shoqëria e Kosovës.

Po ashtu, mendoj se shteti dhe qeveritë, jo vetëm e Kosovës, kanë edhe obligime të tjera që lidhen me konventat dhe zbatimin e tyre, respektimin e tyre kur është në pyetje fati i të pagjeturve, në konflikte të ndryshme dhe respektimi dhe zbatimi i tyre në këto relacione që do të ndihmonte shumë që t'i kemi rezultate, ato që kërkohen.

Lidhur me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, po ashtu, si dhe lirive fundamentale, që është njëra ndër sfidat kryesore edhe të shoqërisë sonë, por jo vetëm të këtij shteti dhe të kësaj Qeverie, por obligime edhe të qeverive tjera që kanë në raport me liritë dhe të drejtat e njeriut. Më lejoni të them se nga ajo që kam lexuar në projektligj, do të kisha pasur nevojë që si komision, para se të fillojmë së proceduari më vonë, përveç përkrahjes në parim, pra, të kemi edhe një sqarim nga sponzoruesi lidhur me emrin e projektligjit, a është emri adekuat apo ndoshta vetë emri do të asocion, do të thotë pak më ndryshe nga ajo që e kemi edhe komisionin parlamentar, pra që është Komisioni për të Drejtat e Njeriut dhe të Pagjeturit, pra mendojmë se duhet ta kemi një sqarim plotësues. Një çështje tjetër parimore që e kam parë këtu dhe që kam nevojë për sqarim nga ana e sponzoruesit, është lidhur me periudhën, fazat për të cilat hartohet dhe është qëllimi i projektligjit. Po të lexohet ajo, do të shihni, i kemi dy. Nuk e di a është ngatërresë a është adekuate, prandaj po lyp sqarim se këtu janë dy vitet e para, 1998 dhe 1999, pra atëherë kur ka qenë konflikti apo lufta e cila u imponua në Kosovë, si dhe në një pjesë të saj thuhet nga viti 1998 deri me 31 janar të vitit 2000, pra janë tri vite. Janë dy faza të ndryshme për të cilat ne kemi nevojë për të sqaruar arsyen pse është kështu, a duhet të mbetet e tillë, a duhet të ndryshohet. Pra, një te emri dhe te këto dy çështje parimore lidhur me fazat për të cilat periudhat kohore bëhet fjalë.

Prandaj, Komisioni mbetet i përkushtuar që pas leximit të parë, pas përkrahjes në parim të bashkëpunojmë edhe me shoqatat, edhe me Zyrën e kryeministrit edhe me komisionin qeveritar, edhe me shoqatën “Thirrja e nënave” dhe ato asociacione që bashkërisht të kemi një debat të përbashkët, të shohim se si do ta ndërtojmë përmbytjen sa më të mirë të këtij Projektligji, që realisht të jetë në funksion për misionin dhe qëllimin për të cilin është, qëllimin e adresimit, hartimit dhe aprovimit të këtij Projektligji.

Prandaj, në emër të komisionit, e përkrahim në parim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Kalojmë sipas grupeve parlamentare. Në emër të Grupit të PDK-së, fjalën e ka deputetja Nerxhivane Dauti.

NERXHIVANE DAUTI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuari zoti zëvendëskryeministër Kuçi,

Të nderuar kolegë deputetë,

Më lejoni që t'ju përshëndes të gjithëve, në veçanti përfaqësueset e shoqatës "Thirrjet e nënave" që janë prezentë sot në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës të paraqes mendimin lidhur me Projektligjin për persona të zhdukur. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e mirëpret dhe e përshëndet sjelljen në Kuvend të këtij ligji me rëndësi të veçantë për vendin, duke marrë parasysh se rregullon një çështje shumë të rëndësishme, që është një plagë e përgjithshme e vendit tonë, pra çështja e të pagjeturve në Kosovë.

Projektligji për personat e zhdukur zbatohet për personat e zhdukur dhe familjarët e tyre, të cilët u zhdukën gjatë periudhës 1 janar 1998 gjer më 31 dhjetor 2000, si pasojë e luftës në Kosovë, në vitet '98, '99, si dhe përcakton kompetencat dhe përgjegjësitë e Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur. Duke pasur parasysh që kanë kaluar shumë vjet nga lufta në Kosovë dhe ende ekziston një numër i madh i personave të zhdukur, fati i të cilëve ende nuk është zbardhur, duke u nisur nga fakti se nuk kemi infrastrukturë ligjore që rregullon këtë çështje, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e konsideron si shumë të nevojshëm nxjerrjen e këtij projektligji me qëllim të mënjanimi të zbrazëtirave ligjore që kanë ekzistuar gjer më tani.

Ky Projektligj ka për qëllim të mbrojë të drejtat dhe interesat e personave të zhdukur dhe të familjarëve të tyre, në veçanti të drejtën e familjarëve për të ditur fatin e personave të zhdukur, të cilët u zhdukën gjatë periudhës 1 janar '98 - 31 dhjetor 2000, pasojë e luftës në Kosovë në vitet '98, '99. Rëndësia e Projektligjit konsiston në krijimin e infrastrukturës ligjore, nëpërmjet të cilit rregullohet fusha e personave të zhdukur, të drejtat e familjarëve të personave të zhdukur dhe çështje tjera që kanë të bëjnë me komisionin qeveritar për personat e zhdukur.

Projektligji rregullon një përmbajtje shumë të rëndësishme dhe është hartuar, marrë në përgjithësi, relativisht mirë, por mund të procedohet më tutje me vërejtjet dhe rekomandimet në vijim. Vërejtjet, natyrisht se do të merren parasysh në Komisionin për të Drejtat e Njeriut dhe do t'i ketë parasysh Grupi ynë parlamentar, por unë do të përqendrohem në vërejtje konkrete. Së pari, Ligji, propozoj që Ligji të titullohet si Ligj për personat e pagjetur, jo për personat e zhdukur, siç figuron në Ligj. Së dyti, Projektligji në nenin 1, paragrafi 1 e kualifikon luftën çlirimtare si konflikt të armatosur, çfarë konsiderojmë se është kualifikim që nuk i përgjigjet natyrës së zhvillimit të luftës, prandaj rekomandojmë zëvendësimin e përkufizimit "konflikt i armatosur" me "luftë çlirimtare".

Në nenin 2, përkufizimi në nenin 1.6 konsiderojmë se është jo i plotë dhe se është i nevojshëm që në mesin e të dhënave, të shtohen të dhënat edhe për prindër ose së paku të njërit prind për arsye se në praktikë na paraqiten persona me emër dhe mbiemër të njëjtë, që mund të krijojnë huti për identitetin e sakët.

Nën 4, Projektligji nuk i definon mjaftueshëm kompetencat e Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur. Në nenin 12, parashihet shqyrtimi i ankesave nga ana e këtij komisioni, por nga teksti i

ligjit nuk kuptojmë nëse komisioni sjell vendime, ndaj të cilave mund të ushtrojë ankesë pala e pakënaqur.

Vërejtja tjetër është te kreu V, te dispozitat përfundimtare, duhet të riformulohet si vijon: “Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare”. Ligji duhet harmonizuar, propozoj që Ligji duhet të harmonizohet edhe me ligjet tjera të natyrës së afërt dhe më konkretisht me Ligjin për familjen, me Ligjin për procedurën jokontestimore dhe në veçanti me Ligjin për statusin e veteranëve, të invalidëve dhe të viktimave civile, ligj i cili është shqyrtuar më herët në këtë Kuvend dhe që është duke u shqyrtuar në shqyrtimin e dytë. Mendoj se, po qe se nuk bëhet një punë e tillë rreth harmonizimit të këtyre ligjeve me ligjin të cilin jemi duke shqyrtuar, do të kemi gabime të konsiderueshme.

Por, marrë në përgjithësi, ka qenë një kërkesë e përgjithshme e deputetëve të Partisë Demokratike në Komisionin për të Drejtat e Njeriut, që ligji sa më shpejt të procedohet në Kuvend, me qëllim se prej mbledhjes, konsideroj se prej mbledhjes së parë të këtij Komisioni e gjerë më tani ka qenë një kërkesë e pareshtur që fati i të zhdukurve të zbardhet, pra që të kemi një infrastrukturë ligjore të merituar dhe që të bëjmë punën tonë ashtu siç na ka hije në Kuvend dhe mos t’i mbajmë ... palët e interesuara, pra është një plagë shumë e rëndë për Kosovën në përgjithësi, prandaj konsideroj se duhet të mbahen dëgjime publike lidhur me këtë çështje, ku do të kemi një konsideratë të lartë ndaj kësaj kategorie shumë të goditur. Prandaj, duke i marrë parasysh këto vërejtje dhe këto sugjerime, mendoj se Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike do të japë kontributin e vet përmes deputetëve që i ka në këtë komision dhe me vërejtjet e parashtruara të miratohet në Kuvend. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, fjalën e ka deputeti dhe anëtari i Kryesisë, zoti Sabri Hamit.

SABRI HAMITI: Ju faleminderit, zoti kryesues i seancës!

Zoti zëvendëskryeministër,

Ministra,

Kolegë, deputetë dhe përfaqësues të familjeve që vuajnë që më shumë se një decenie për mospasje të informatave kryesore për më të dashurit e tyre. Ne kemi këtu një problematikë që ngërthen në vete edhe pasojën e një lufte çlirimtare, edhe traumat e saj edhe mbi një decenie të dhimbjes, e cila nuk ka gjetur adresën e vet në të dhëna reale për fatet e njerëzve konkret. Prandaj, mendoj që gjithë kjo e krijon edhe atë sentiment që u dëgjua rreth përkufizimit të ligjit ose të emrin të tij edhe nga kryetari i komisionit, edhe nga përfaqësuesja e nderuar e Grupit të PDK-së, e cila edhe është juriste e njohur, që të quhet Ligji jo për të zhdukur, por për të pagjetur, e cila në të vërtetë është formulim sentimentit dhe unë e kuptoj, por në esencë ligjit nuk i ndërron diçka të rëndësishme, domethënë substanciale nuk ndërron. Me rëndësi është që Ligji ka ardhur në Kuvend dhe me rëndësi që është që ligji duhet të kalojë. Dhe, unë, në emër të Grupit e përkrah në leximin e parë këtë ligj dhe bëj apel që kjo është një veprimtari që është lakuar në mënyra të ndryshme si çështje dhe nuk ka nevojë të kalohet shumë kohë që të vijë në leximin e dytë, pa marrë parasysh që do të duhej të diskutohet me grupacione të ndryshme gjatë këtyre ditëve, por unë kujtoj se është një ligj i cili duhet të bëhet më shpejt për të arritur te nënvizimi i tretë, në emër të grupit, që ky ligj të kalojë në leximin e dytë dhe të hyjë në fuqi sa më shpejt. Ky është mendimi ynë. Natyrisht që duhet të punohet, por mendoj që nuk duhet kohë shumë e madhe që ky ligj të kalojë deri në leximin e dytë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, fjalën e ka deputetja Zylfije Hundozi.

ZYLFIJE HUNDOZI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Një ndër çështjet më të dhimbshme në Kosovës është çështja e personave të zhdukur, e cila nuk është zgjidhur që 11 vjet, edhe pse përpjekjet e shumta të institucioneve të Kosovës nuk kanë mundur. Më së paku që mund të bëjmë pas gjithë kësaj kohe, është që të nxjerrim një ligj për personat e zhdukur, me qëllim që t'i mbrojmë të drejtat dhe interesat e këtyre personave dhe të familjarëve të tyre, në veçanti të drejtën e familjarëve për ta ditur fatin e personave të zhdukur, të cilët u zhdukën në periudhën janar 1998 - 31 dhjetor 2000. Mirëpo, me këtë projektligj vetëm po formalizohen strukturat që tashmë kanë ekzistuar. Edhe pse Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përkrah, në parim, ne kemi disa vërejtje të cilat shpresojmë që do të përmirësohen në komisionin funksional.

Në këtë Projektligj nuk parashihet asnjë përkrahje materiale për anëtarët e familjeve të personave të zhdukur, të cilat janë në gjendje të rëndë materiale, e cila është dashur të parashihet edhe pse ndoshta do të kishte ndikime buxhetore dhe ndoshta nuk do t'i kompensojë vuajtjet psikike të familjarëve të personave të zhdukur, që këtë kompensim mund ta bëjë vetëm kthimi i personave të dashur të tyre, por megjithatë së paku të harmonizohet me Ligjin për luftëtarët e UÇK-së, viktimat civile dhe familjarët e tyre që kanë kaluar në seancën e javës së kaluar në këtë parlament.

Nën dy, 17 nene dhe shumë paragrafë të këtyre neneve nuk janë përkthyer në gjuhën angleze ashtu siç duhet, gjë që paraqet një dëm të madh për shkak të domosdoshmërisë së harmonizimit të legjislacionit tonë me atë të Bashkimit Evropian. Përkthimi jo adekuat i neneve në gjuhën angleze, mund të çojë në keqkuptim, se ky ligj nuk është i harmonizuar me legjislacionin e Bashkimit Evropian, të kthehet nga ana e Komisionit Evropian, të rishqyrtohet në Parlament, të bëhet punë e dyfishtë pa pasur nevojë dhe të zgjatet implementimi i tij në praktikë.

Nën tre, e kam edhe një vërejtje që e tha edhe deputetja Nerxhivane Dauti, po përmendet termi "konflikti i armatosur", mendoj që tërë kohën, që 10 vjet kanë ekzistuar përpjekjet e institucioneve tona që kjo të thirret "luftë e armatosur", lufta që është bërë në Kosovë, e jo konflikt, edhe pse në përkthim faktikisht është e njëjta gjë. Besoj që nuk do të prishte punë edhe për ndërkombëtarët nëse në këtë projektligj lufta jonë thirret luftë e jo konflikt i armatosur.

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës në komisione funksionale, po edhe në komisionet kryesore do ta japë kontributin e vet që ky ligj të dalë sa më i mirë dhe të zbatohet sa më mirë në praktikë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, fjalën e ka deputeti dhe shefi i grupit, Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar kolegë,

Nuk di unë, kam shumë vërejtje në këtë projektligj, më mirë dua të them një hiq projektligj, i cili është dashur të pritet shumë vjet dhe po më befason nganjëherë edhe logjika e debatit këtu, sepse shumicën e këtyre deputetëve i kemi në legjislaturën e tretë, të cilët deri tash nuk kanë vepruar në drejtim të nxjerrjes të një ligji i cili do ta rregullonte statusin edhe të personave të pagjetur, por edhe të familjarëve të tyre. Nuk e di a është dashur të presë 10 vjet ky Kuvend për ta nxjerr një ligj hiq. Unë, po dua tash që të shkoj në disa pjesë të këtij ligji dhe të dëshmoj pse ky ligj nuk zgjidhë kurrëgjë, absolutisht.

Projektligji nuk e zgjidhë as statusin e personave të pagjetur dhe as statusin e familjarëve të tyre. Ma thoni, me cilin nen të këtij ligji, ata të cilët e kanë hartuar këtë ligj, zgjidhet statusi i personave të pagjetur dhe i familjarëve të tyre. Me asnjë prej neneve të këtij ligji, që i ka diku rreth 20 ose 22-23, nuk zgjidhet statusi i personave të pagjetur dhe i familjarëve të tyre.

Ajo që mendoj se është dashur të kihet në konsideratë, si duket ka mundësi që ka pasur trysni nga jashtë, dikush duhet të japë një përgjigje se në çfarë kohe llogariten personat e pagjetur ose personat e zhdukur në luftë.

Kolegë, lufta në Kosovë ka filluar në janar të vitit 1998 dhe ka përfunduar me 12 qershor të vitit 1999, dhe asnjë i zhdukur pas kësaj date nuk mund të figurojë në këtë ligj. Ky Ligj titullin duhet ta ketë “Ligji për persona të zhdukur ose persona të pagjetur në kohë të luftës”, sepse nuk mund të trajtohen njëjtë personat e zhdukur, të kidnapuar në kohë lufte, me personat të cilët zhduken pas kësaj date. Ne kemi të zhdukur edhe para datës, para janarit '98 dhe nuk mund të llogariten kategori e njëjtë me ata të zhdukur ose të pagjetur dhe këtu një gjë e tillë figuron. Nuk mund të jetë askush i zhdukur në këtë ligj pas datës 12 qershor. Ligjet e tjera i rregullojnë çështjet. Ne kemi edhe sot të zhdukur, do të kemi edhe nesër të zhdukur, por nuk trajtohen njësoj me këtë. Ky është ligj special dhe duhet të trajtojë vetëm këtë kategori të kësaj.

Po shkojmë te neni 5, thotë – “E drejta e familjarëve për t’u informuar për fatin e personave të zhdukur”. Kjo e drejtë që figuron në këtë ligj, është e drejtë ndërkombëtare, por çka do të veprojnë institucionet, çka do të veprojnë shteti i Kosovës që qytetarët, familjarët e të zhdukurve të mund të realizojnë këtë të drejtë të garantuar me norma ndërkombëtare. Ligji nuk përcakton mekanizma as forma se çfarë duhet të jetë.

Neni 6: “Të drejtat e familjarëve lidhur me statusin ligjor të personave të zhdukur”. Absolutisht nuk përmban asgjë përmes të cilës do të mund të realizoheshin të drejtat e familjarëve me këtë ligj. Për të mos marrë kohë më shumë, unë vetëm po shtroj një pyetje, ndoshta zëvendëskryeministri mund të na japë një përgjigje, se me mbështetje të këtij ligji, të këtij projektligji, cilat janë të drejtat dhe cilat janë obligimet e shtetit përkundrejt personave të pagjetur dhe familjarëve të tyre? Ma thoni, në cilën pjesë të këtij drafatligji e keni specifikuar se cilat janë të drejtat dhe obligimet e shtetit. Çka do të duhej të ndërmarrë shteti që qytetarët të mund të realizojnë këtë të drejtë, sepse keni parasysh, tash e shumë vjet kjo çështje ka mbetur kryesisht në mundësitë e familjeve dhe e dini që një numër shumë i madh i matrapazëve sot manipulojnë me familje të personave të zhdukur, duke iu thënë se familjarët e tyre gjenden në Serbi, gjenden në këto burgje, nevojiten kaq mjete për t’i liruar e tjera, e tjera dhe shteti nuk ka ndërmarrë asnjë veprim në drejtim që t’i mbrojnë këta familjarë, por po ashtu të përpiqet që në forma më të mira dhe më të shpejta ta zgjidhë statusin e këtyre personave.

Unë kam drojë që një ligj i tillë do të na mjaftojë që të themi se kemi Ligjin për persona të pagjetur, por në anën tjetër ky ligj nuk zgjidhë absolutisht kurrgjë, për më tepër i ngatërron shumë çështje të cilat ndoshta deri tash edhe kanë marrë një rrugëzgjidhje. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Në emër të Grupit parlamentar të LDD-së, deputetja Dritë Maliqi e ka fjalën.

DRITA MALIQI: Faleminderit!

Përsëendetje për të gjithë, në veçanti përsëendetje për pjesëmarrjen në këtë seancë të nënave apo “Thirrjeve të nënave” dhe për zemërsisht i përsëndes në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë.

Edhe Lidhja Demokratike e Dardanisë ka shqyrtuar me vëmendje Projektligjin për personat e zhdukur. Edhe pse kanë kaluar më tepër se 11 vite nga çlirimi i Kosovës kjo çështje nuk ishte rregulluar me ligj, edhe përkundër faktit se në vazhdimësi ne kemi kërkuar gjithherë, do të thotë, që sa më shpejt të sillet e të rregullohet përgjithmonë kjo çështje.

Përmbajtja e këtij projektligji nuk është substanciale. Ka më tepër karakter konstatues dhe përshkrues dhe nuk e rregullon në tërësi këtë çështje që përfshin një fokus – grup të martirizuar të popullit tonë të nderuar të Kosovës.

Statusi i personave të pagjetur dhe i familjarëve të tyre duhet të jetë më gjithëpërfshirës, më i qartë dhe më konkret, që vërtetë shteti të ketë vëmendjen dhe përkujdesjen e nevojshme për këtë kategori të veçantë të shoqërisë sonë kosovare.

Lidhja Demokratike e Dardanisë insiston që të respektohen në plotni kërkesat e drejta të shoqatave dhe asociacioneve të familjareve të personave të pagjetur. Vërejtjet dhe kontributin tonë do ta japim në amendamentimin e këtij projektligji në komisionet përkatëse. Andaj, edhe një herë, në parim Lidhja Demokratike e Dardanisë me Grupin e tij Parlamentar e përkrah këtë projektligj. Ju faleminderit!

Drejtimitin e mbledhjes e merr zoti Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit

KRYETARI: Në emër të Grupit 7+, deputetja Shpresa Murati e ka fjalën!

ŠPRESA MURATI: Hvala, predsedniče!

Pozdrav svima prisutnima u sali!

Nacrt zakona o nestalim licima koji je napokon došao u Skupštinskoj proceduri, je od izuzetnog značaja za sve građane iz razloga što nisu rasvetljene sudbine mnogobrojnih lica a posebno za njihove porodice koje su u stalnoj i dugotrajnoj patnji i neizvesnosti.

Nacrt zakona o nestalim licima uređuje pitanja koje se odnose na zaštitu prava i interesa nestalih lica i njihovih članova porodice, bez obzira na njihov etničku, versku ili bilo koju drugu pripadnost, nadležnost i odgovornost Vladine komisije za nestala lica, njen sastav, mandat, saradnju Komisije sa domaćim i međunarodnim organizacijama, reguliše centralni registar o podacima nestalih lica u skladu sa zakonodavstvom na Kosovu.

Kada je u pitanju sam tekst Nacrta zakona, smatramo da treba obratiti pažnju na član 6. posebno stav 4. koji je prilično nejasan i treba ga preformulisati. Takođe je neophodno precizirati rokove za donošenje podzakonskih akata.

Zbog značaja oblasti koje reguliše ovaj nacrt zakona, Parlamentarna Grupa “7+” podržava ovaj nacrt zakona i daće svoj doprinos u toku njegove dalje procedure kroz komisije, posebno Komisiju za ljudska prava, ravnopravnost polova i nestala lica, koja će ovaj nacrt zakona razmatrati u svojstvu funkcionalne komisije i verujem da će dati sve od sebe da se oblast nestalih lica uredi na najbolji mogući način. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar SLS, deputeti Mursel Halili e ka fjalën.

MURSELJ HALILJI: Hvala, gospodine predsedniče!

Gospodine zameniće predsednika Vlade,

Uvaženi ministri,

Dame i gospodo poslanici,

Uvaženi gosti,

Parlamentarna grupa SLS je razmatrala Nacrt zakona o nestalim licima i smatram da je veoma značajno da je ovaj nacrt ušao u skupštinsku proceduru. Takođe smatramo da će se usvajanjem ovog zakona omogućiti zakonsko uređenje i rasvetljavanje sudbine nestalih lica, što je veoma značajno za sve, obzirom da je to vrlo osetljivo pitanje.

Međutim, smatramo da sam tekst Nacrta zakona sadrži neke nedostatke. Naša primedba se odnosi na predložene vremenske okvire koje bi trebalo preispitati obzirom da su nestala lica bila i pre tih rokova koji su dati u ovom nacrtu zakona a i posle toga. Zatim, u potpunosti se slažemo sa odredbama o uspostavljanju centralne evidencije nestalih lica i još jedan dodatak je veoma bitan, smatramo da bi trebalo da se uspostavi jedna saradnja sa telima koja se bave istom problematikom u regionu jer bi to svima bilo od pomoći. Parlamentarna grupa LSL će u načelu podržati ovaj nacrt zakona. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit, Mursel! Në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, deputetja Vezira Emrush e ka fjalën.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala lepa na datu reč!

Pozdrav gospodine predsedniče Skupštine!

Pozdrav svim poslanicima i gostima, dragim gostima koji nas danas slušaju!

Mi kao Parlamentarna grupa razmatrali smo ovaj zakon. Pažljivo smo saslušali sve kolege koje su pre toga dali primedbe na ovaj zakon. Zakon je jako važan. Znamo da je u pitanju faktor čovek, nestala lica i konflikti koje smo imali pre i posle rata.

Ovaj zakon treba po pravilu da definiše status nestalih lica i pravo statusa za njihove porodice. Smatramo da zakon u celosti mogao bi da bude još, da kažemo, malo više... On je sažet, kratak, ali da ima neke okvire gde bi se neka delatnost ovog zakona, cilj ili namena, mogli proširiti i malo bolje bili transparentni u objašnjenjima pojedinih članova zakona.

Naročito smo zabrinuti kada je u pitanju ovaj zakon gde je sadržaj Nacrta zakona i svrha zakona, gde se daje do znanja da ne sme biti diskriminacije u odnosu na bilo koju zajednicu, pol, pripadnost, zato što znamo svi da su u ovim konfliktima, ratnim konfliktima stradali predstavnici svih zajednica.

Znamo da je postojala komisija, Vladina komisija pri Kabinetu premjera, da i dalje ima status u ovom zakonu ta ista komisija i jedinica za nestala lica, ali smo zabrinuti da u okviru 2009 – 2011 da nije data budžetska aplikacija za sredstva, potrebna sredstva za dalje ispitivanje ove oblasti, te smatramo da neće biti mnogo efekta od strane Vlade i ove Skupštine oko rešavanja ove oblasti.

Svi znamo da nas zbog ove oblasti naročito proziva Evropska komisija, koja nam je dala domaći zadatak da u okviru ovog poglavlja, kada su u pitanju nestala lica i status njihovih porodica, da moramo rešiti ovo poglavlje i da moramo krenuti posle 10. godina sa, normalno, unutra sa velikom institucionalnom angažovanošću, što smatramo da u ovom zakonu nije ništa institucionalno poboljšano, niti je dato nešto više mogućnosti od same Komisije i Jedinice za nestala lica, i smatramo da je i budžet isto tako mali - 200.000 koje su bile aktivne, te smatramo da za ovu oblast u ovom zakonu morala je da postoji dodatna budžetska aplikacija i da se malo ozbiljnije pozabavimo sa ovom oblašću i da jednom zauvek ono što možemo da rešimo, rešimo. Znamo svi da je u Medicinskom institutu 400 leševa koji čekaju identitet i mislim da smo trebali u ovom

zakonu da stavimo kao član da se angažuju forenzičari kako bi utvrdili pravo i, da kažem, identifikovali te leševe koji i dalje čekaju.

Imamo pojedine primedbe kada je u pitanju prevod, na primer, kod člana, kada su u pitanju troškovi okopavanja – ukopavanja, troškovi sharane, ali to ćemo dati u samoj funkcionalnoj komisiji i imam veliko poverenje u gospodu Nerxhivane Dauti koja radi u toj komisiji i smatramo da će to biti amandamentirano na jedan zakonski dobar način u samoj komisiji.

Pozdravljam ovaj zakon i podržaćemo ga kao Parlamentarna grupa. Hvala na pažnji!

KRYETARI: Faleminderit! Kemi përfundimin, do të thotë, të diskutimeve në emër të grupeve parlamentare. Të lajmëruar kemi dhjetë deputetë. Mendoj se të gjitha grupet parlamentare ishin unike në këtë drejtim. Nëse jeni dakord, mund të shkojmë në diskutimet 5-minutëshe. A jeni dakord? Atëherë, në 5 minuta. Vazhdojmë debatin. Do të thotë, i kemi 10 deputetë. Fjalën e ka deputeti Driton Tali.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të them të drejtën, sa i përket këtij ligji, unë edhe më tutje e kam siklet të vendosi sepse nuk di a ta përkrah për shkak të rëndësisë që ka, sigurisht edhe të emocioneve, apo të mos e përkrah për shkak se, siç u tha edhe nga parafolësit, me të vërtetë nuk sqaron asgjë. Është projektligj me shumë të meta, me shumë boshllëqe, shumë vakuume dhe është diskutabile çka po rregullojmë, pra duke filluar edhe nga datat, por edhe nga definicionet e tjera, e tjera.

Por, paraprakisht, më lejoni të them apo ta demantoj zëvendëskryeministrin për pikën e kaluar, sepse zëvendëskryeministri nuk e pranoj fajin e Qeverisë sa i përket reagimit të vonshëm. Po të reagohej me kohë, me siguri se Zvicra do të kishte mirëkuptim për sfidat e Kosovës dhe do të gjendej kompromisi për të gjitha, të them, që e ka bërë Zvicra për Kosovën, andaj gabimi është politik. Nuk është i natyrave tjera, zoti zëvendëskryeministër, dhe duhet si të tillë ta pranoni përgjegjësinë dhe personat përgjegjës të përgjigjen njëherë e përgjithmonë, të fillohet njëfarë disipline politike dhe qeverisëse në këtë vend, për hir të së nesërme.

Po kthehem përsëri te ligji, të cilin po e diskutojmë. Po them, merreni e lexoni nenet me radhë, do të shihni se sa është i pakuptueshëm, i pasqarueshëm. Merreni qëllimin dhe fushëveprimin, lexoni sa të doni herë, nëse mund ta kuptojë dikush se çka rregullon në esencë, le të vjen edhe mua të ma shpjegojë se, sinjerisht, unë nuk jam kah e kuptoj. Pos disa gjëra që i emëroni, që s'ke nevojë, thjeshtë, madje ta përdorësh edhe logjikën, të vetëkuptueshme që janë. Siç është, për shembull, këtu një paragraf, një nen, më falni, ku tregon se “njeriu i zhdukur deri kur konsiderohet...”, dhe mos ta lexoj se është teksti, sinjerisht po e them, joadekuat për një ligj.

Po them, mbase edhe do ta votoj për hir të rëndësisë që ka, me shpresë se komisionet gjegjëse do ta bëjnë përmirësimin e duhur të këtij ligji, aq shumë të nevojshëm. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro, zëvendëskryeministër, Kuçi!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti kryetar!

Zotëri Tali, replikë, pasi ma përmendi emrin! Ndoshta unë s'kam qenë i qartë ose ndoshta ju s'keni pasur vëmendje të theksuar! Unë e pranova që ka pasur neglizhencë dhe do të marrim masa.

Unë kisha dashur që ju ta lexoni transkriptin dhe në mbledhjen tjetër të më kërkonti falje. Faleminderit!

(Deputeti Tali, reagim)

KRYETARI: Unë po ta jap fjalën, por ti ke qenë jashtë rendit të ditës! Urdhëro!

DRITON TALI: Zoti zëvendëskryeministër, të kërkoj falje, singërisht! Gëzohem që më në fund do të merrni masa rigoroze ndaj Kabinetit qeveritar se, singërisht, kështu nuk qeveriset Kosova. Faleminderit!

KRYETARI: Kosovën e qeverisin ata që marrin vota prej qytetarëve të Kosovës. Fjalën e ka deputetja, Luljeta Shehu.

LULJETA SHEHU: Faleminderit, kryetar!

I nderuari kryetar,

Zëvendëskryeministër, ministër,

Të nderuar deputetë,

Të nderuara nëna që jeni të pranishme,

Projektligji për të zhdukurit është një projektligj me të cilin rregullohet një problematikë shumë e rëndësishme, që edhe pas 11 vitesh të përfundimit të luftës, çështja e të zhdukurve me 1.800 persona ka nevojë për një trajtim të përsheptuar. Mendoj se kjo çështje është shumë komplekse dhe kërkon qasje profesionale, angazhim serioz dhe me këtë projektligj do të hapet edhe një rrugë e re për shpejtimin e zbardhjes së fatit të të zhdukurve edhe pse është e pamundur të mbyllet tërësisht kjo kaptinë e dhembshme e të kaluarës tonë jo të largët. Mendoj që kjo duhet të jetë një ndër çështjet prioritare nga mekanizmat vendorë dhe ndërkombëtarë.

Ndërsa, sa i përket vërejtjeve, mendoj se duhet të shtohet edhe ndonjë nen, të shqyrtohet edhe çështja e atyre të zhdukurve, familjet e tyre, që nuk pajtohen me identifikimin dhe çka do të ndodhë me ato kufoma dhe ku do të bëhet varrimi i tyre.

Meqë identifikimi i mbetjeve mortore, në mënyrë si është bërë, nuk e ka formën e përmbyllur, do të ishte mirë që me një nen të veçantë të kompletohen mbetjet mortore në rastet kur ato nga Departamenti i Mjekësisë Ligjore janë të mundshme, është mirë kjo të rregullohet me këtë projektligj, sepse kemi shumë shembuj kur janë identifikuar edhe pjesë tjera të gjetjeve mortore të personave tashmë të identifikuar. Do të ishte mirë që Projektligji për të zhdukurit dhe Projektligji për statusin dhe për të drejtat e familjeve të zhdukurve të ishte një ligj i veçantë, ku do të lehtësoheshin shumë çështje që nuk është përcaktuar as në statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të UÇK-ës, viktimave civile të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe familjeve të tyre për të cilat kam diskutuar kur e trajtuam këtë projektligj.

Unë mendoj se për shkak të peshës dhe rëndësisë që e ka ky projektligj për këtë kategori shumë të ndjeshme duhet ta përkrahim dhe të japim kontributin tonë në komisionet gjegjëse bashkë me të gjitha propozimet nga ju të nderuar deputetë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Teutë Hadri.

TEUTA HADRI: Kryetar, ma caktove me gishta kohën, 2 minuta, por unë me 3 ndoshta do ta përmbyll.

Përsëritës edhe Grupin e delegacionit “Zëri i nënave”! Përsëritës shumë punën e tyre të palodhur dhe sakrificën e tyre që e kanë bërë që plotë dhjetë vite që edhe mua si deputete e këtij Parlamenti më kanë lënë në tension dhe kjo kategori e të zhdukurve të mos qitet në harresë.

Meqë e thanë edhe parafolësit e mi, unë nuk do të zgjatem në debat, sepse besoj të gjithë deputetët e kanë një qëndrim dhe një qëllim. Kemi dashur që sa më shpejt ky ligj të futet në Parlament, të diskutohet, pas shumë debateve dhe më tepër do të koncentrohem te çështja e vërejtjeve të mia që i kam te ky ligj. Mendoj se ka qenë një ligj mirë i punuar, nuk themi që ka qenë aq ligj i keq, por vërejtja ime do të jetë kryesisht te titulli, që e tha edhe zoti Makolli. Titulli do të duhej të definohet dhe të jetë titulli: Personat e zhdukur dhe të pagjetur prej vitit 1998 deri në vitin 1999. Periudha që ka hy këtu 2000, mendoj se kjo periudhë nuk do të jetë periudhë e luftës së UÇK-ës, luftës së armatosur në Kosovë. Se nëse futet, unë do të ndalesha te neni 2, te përkufizimet. Kam vërejtje personale, ku thotë “personi i zhdukur është një person ku vendndodhja...”. Kjo fjalë “vendndodhje” duhet të zhduket, se vendndodhje na lë të kuptojmë dhe na bën të ndjeshëm sikur këta persona të janë në ndonjë kazmat diku dhe ndodhen, prandaj është shumë e ndjeshme dhe kjo fjalë duhet të bie. Do të thotë, ky nen, nga fillimi deri në fund, sipas meje, është jo i qartë dhe duhet të formulohet një formulim i ri dhe mendoj se më mirë do të ishte ky përkufizim, ku thotë se “person i zhdukur është personi i cili i mungon familjes së tij/të saj dhe nuk ka asnjë informacion se është i gjallë, por i zhdukur nga lufta e armatosur e janarit 1998 deri 31 dhjetor 1999”. Sepse, personat e vitit 2000, nëse futen, atëherë zonja që e përmendi në emër të Grupit Parlamentar Nerxhivanja – konflikt të armatosur, plotësisht do të pajtohet kjo fjalë, sepse shqiptarët kanë pasur konflikt. Shihni te përkthimi serb, ku thotë “sukob” – përleshje, e kështu që duhet të iket.

Pastaj, kam vërejtjen e dytë, te neni 1.2, në fakt përkufizimi 1.2, te neni, prapë këtu thuhet “person – pjesëtar i familjes”, “familjar i personit të zhdukur pjesëtar”, sikur se ky futet dhe del, por duhet të jetë “anëtar i familjes” e mandej nëse ka ndonjë buxhet këtu do të futet kushdo dhe mendoni edhe më larg.

Vërejtje kam te neni 9, ku është bërë organizimi, nga çdo përfaqësues i institucioneve është futur nga një anëtar, mendoj se është bërë një lëshim, jo gabim. Shpresoj se nuk është gabim, se këtu patjetër duhet të futet edhe një anëtar i grupit të personave të zhdukur, familjarët e tyre që kanë dhënë edhe kontributin.

Dhe vërejtja ime e fundit, është te neni 12, te kompetencat e Komisionit qendror për Personat e Pagjetur, ku është para parë këtu, është caktuar fjala “mandat”, mendoj se ky mandat duhet ta ketë një përkufizim. Është një vit, dy vite apo do të jetë i përhershëm, kështu që mendoj se mandati duhet të jetë i përcaktuar që mos të kemi edhe implikime tjera buxhetore, se fatmirësisht ky ligj nuk ka pasur aq. Prandaj, i përshëndes të gjithë, i përshëndes nënat dhe deputetët që patën durim me dëgjua, prandaj amendamentet e mia shpresoj do t’ia jap komisionit përkatës. Faleminderit!

KRYETARI: Sigurisht dhe vërtet Ligji ka për qëllim ndoshta më tepër për një njohje morale, një satisfaksion moral për familjet se sa një formë tjetër, por juve, disa deputetëve, duhet t’ua tërheq vërejtjen. Të zhdukurit janë të zhdukur qoftë të periudhës së luftës, qoftë të pasojave që i ka sjell lufta dhe në kohë nuk besoj se mund ta kufizoni ligjin. Prandaj, të zhdukur janë të gjithë të zhdukurit, qoftë ata të luftës, qoftë ata edhe të pas luftës që nuk dihet ku janë. Kështu që, mos bëni politikë shumë. Ligji nuk është për politikë, as për histori. Vazhdojmë debatin. Fjalën e ka deputetja Njomza Emini!

NJOMZA EMINI: Faleminderit, kryetar!

I nderuari zëvendëskryeministër, Kabinet qeveritar,
Kolegë deputetë,

Unë ndiej obligim moral, edhe si deputete, që këtë projektligj ta përkrah fuqishëm. Mendoj se është një projektligj i rëndësishëm jo vetëm për familjet që kanë të zhdukur, por edhe për vetë ne qytetarët e Republikës së Kosovës.

Unë përshëndes po ashtu edhe përfaqësuesit e familjeve të zhdukur që janë këtu me ne sot, gratë “Thirrja e nënave”. Unë do të filloja me një mendim timin që familjet kanë të drejtë të dinë për të vërtetën për të afërmit e tyre dhe të trashëgojnë të gjitha benifitet. Unë nuk mendoj se ky nuk është një ligj i mirë, sikur që dëgjova disa deputetë që është - “hiq”. Unë mendoj se pajtohem edhe me juve, zoti kryetar, që ne kemi obligim moral që të përkrahim këtë projektligj dhe mos të bëjmë, siç e thatë edhe ju, politika. E vetmi qëllim i këtij projektligji është që të dihen ku janë të zhdukurit. Po ashtu unë mendoj se duhet të ketë edhe bashkësia ndërkombëtare presion ndaj Serbisë për gjetjen e të afërmeve të tyre. Unë mendoj se në këtë drejtim, me plotë përgjegjësi e them, se nuk është bërë edhe aq sa duhet ky presion sepse ata shumë mirë e dinë se ku janë të zhdukurit dhe do të duhej të zgjidhet kjo sa më shpejt, duke pasur parasysh edhe institucionet të cilat e kanë bërë edhe të pamundurën, por në bashkëpunim me bashkësinë ndërkombëtare të jetë presion i vazhdueshëm për personat e zhdukur.

Po ashtu, mendoj se këtu ka disa mangësi dhe për këtë ne edhe jemi në shqyrtimin e parë të Projektligjit. Më habit që disa deputetë që janë me mandat më shumë se sa unë që jam për herë të parë dhe i dëgjoj se përsërisin njëri tjetrin. Ajo se çka e mendoj unë është se duhet të kontribuojmë për atë dhe nëse kemi vërejtje t’i themi këtu, të rekomandojmë se çka atëherë nëse është gabim. Unë nuk do të zgjas shumë sepse kjo çështje është aq e ndjeshme sa që sa më shumë të flasim e bëjmë të pandjeshëm dhe këtu kemi shumë nëna të cilat i presin me padurim të afirmimit e tyre. Unë shpresoj që shumë shpejtë do të kthehen familjet e tyre personat e pa zhdukur dhe të bëjmë ne aq të pamundurën për ta qoftë edhe nga ana materiale por edhe nga ana institucionale të vendit. Kjo ishte ajo e tëra çka unë mendova, faleminderit për vëmendjen!

KRYETARI: Deputeti, Bujar Dugolli e ka fjalën. Shpresoj se do të jeni racional.

BUJAR DUGOLLI: Po, gjithsesi, kryetar! Faleminderit!

Unë konsideroj se para disa seancave ne patëm një ligj sistemor për kategoritë e dala nga lufta. Është mendim imi dhe mendoj se qëndron, sepse edhe kjo kategori për të cilën po diskutojë sot është kategori e dalë, kategori e luftës në Kosovë. Prandaj, pasi që ka ardhur ky ligj, u tha nga shumë deputetë, ka të meta, ndoshta për shkak se është kërkuar nga Piter Feit që të ketë një ligj të veçantë dhe ka ardhur si i tillë, por mendoj se ato dispozita që janë paraparë në ligjin që e përmenda e që e kemi shqyrtuar më herët, duhet të barten në këtë ligj sepse, si i tillë, ky ka shumë mangësi në të cilat do të duhej komisioni funksional t’i përmirësojë dhe futë në të për ta bërë ligj sa më komplet.

Unë i bashkohem shumë deputetëve që emri i këtij projektligji duhet të pësojë ndryshime se nuk korrespondon as me terminologji të njohura ndërkombëtare, se termi “të zhdukur” duhet të hiqet. Mendimi im është që ligji duhet të quhet – Ligji për personat e humbur në Kosovë gjatë periudhës së luftës në Kosovë. Kjo korrespondon edhe me terminologjinë në gjuhën angleze, por edhe serbe dhe është terminologji e njohur nga këto kategori edhe në vende tjera ku ka pasur luftëra.

Sa i përket periudhës, pajtohem se lufta ka pas pasoja edhe në muajt në vazhdim, por në rast se merret periudha kohore 1 janar 1998, atëherë ne nuk mund të dalim nga viti 1999, por mund të shkojë deri në 31 dhjetor 1999, por viti 2000, 2001 e më tutje nuk ndërlidhen me luftë dhe mendoj se 31 dhjetori 1999 duhet të jetë përkufizim i fundit që ne mund t’i trajtojmë këto kategori dhe këta persona të humbur gjatë luftës në Kosovë.

Termi “konflikt i armatosur” duhet të hiqet, sepse nuk ka pasur konflikt të armatosur, por ka pasur “luftë të armatosur”, edhe në përmasa të këtuhit, por edhe në përmasa ndërkombëtare sa i përket çështjes së Kosovës dhe termi “lufta e armatosur” duhet të futet, pa marrë parasysh a i pëlqen dikujt a nuk i pëlqen, sepse kjo ka ndodhur dhe është një fakt.

Te përkufizimet, mendoj se një çështje nuk është futur, që duhet të futet. Pika nën përkufizimet 1.1. duhet të futet: “personat e rrëmbyer”. Domethënë, nuk janë këta persona për të cilët po flasim, të cilët janë zhdukur, që po thotë dikush, apo kanë humbur nga vetë dëshira, por këta janë rrëmbyer nga dikush dhe përkufizimi – “persona të rrëmbyer” duhet të jetë nën përkufizimin 1.1. dhe të sqarohet çka quhet person i rrëmbyer, nga kush është rrëmbyer dhe informacionet që kanë qoftë familjarët, qoftë të afërmit mbi fatin e tij deri në ato momente kur është rrëmbyer.

Mendoj se me këto çështje që u thanë edhe nga të tjerët, mund të jetë një ligj i mirë, një ligj adekuat që do të ofronte ndoshta për zgjidhje këtë çështje shumë të ndjeshme dhe normalisht familjet e tyre do të kenë një përkujdesje nga shteti, sa i përket kësaj kategorie. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Unë, po e bëj një ndërhyrje të shkurtër, por realisht në çdo fjalor kur shpjegohet fjala luftë, thuhet lufta është konflikt i armatosur. Vazhdojmë. Fjalën e ka Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Për rëndësinë e ligjit nuk po flasim, por po flasim për disa defekte që mund të na sjellin në situatë që në komisionet parlamentare të kemi problem gjatë amendamentimit.

Qëllimi i projektligjit ka qenë që të përcaktohet statusi i qartë i një kategorie të caktuar të cilët kanë humbur gjatë luftës së fundit në Kosovë, periudha 1998 dhe 2000. Mirëpo, a është bërë me ligj, unë konsideroj se është lënë zbrazësi dhe pothuaj që në brendi të Projektligjit flitet prapë për afate të cilat i parashohin ligjet bazike për këtë kategori. Ndërsa qëllimi nuk ka qenë i Projektligjit të flasë për kategorinë e të zhdukurve, që të zhdukur konsiderohen në të gjitha periudhat, por ka dashur ta ndajë këtë periudhë dhe konsideroj që ka qenë dashur të ketë edhe afate speciale apo specifike për këtë kategori, sepse do të kemi probleme.

Neni 3, flet për ndalimin e diskriminimit dhe nëse e lexoni, flet për të gjitha kategoritë dhe kjo menjëherë bie ndesh me Ligjin që sapo e kemi kaluar që një javë – Ligjin për veteranë dhe viktimat civile. Domethënë, bie ndesh. Dhe, tani e kemi problemin në... ne e kemi patatën e nxehtë. Po më vjen keq që është sponsorizuar nga i njëjti sponzorizues, por me ndryshime plotësisht. Atje thotë, janë kategori të cilat i përkasin një kategorie të caktuar, tash në nenin 3 kemi, që thotë, janë të njëjtë. Dhe çka të bëjmë ne, që kemi për të sjellë amendamente?

Neni 6, është komplet i paqartë. Procedura kontestimore dhe gjykatat e kanë procedurën e qartë kur e shpallin personin të vdekur.

Zoti kryetar, e kemi problem, sepse ne duhet t'i sjellim amendamentet dhe nuk e dimë çka bëjmë. Po, në Komision, por nëse nuk e marrim një qëndrim në parim në këtë seancë plenare, në komision kemi probleme edhe më shumë se këto që po diskutohen. Për shembull, tash tregon, dhe vetëm ta lexoj. Thotë: “bëhet shpallja e personit të zhdukur për të vdekur nga gjykata”. Ju lutem, është komplet jashtë asaj që mund ta rregullojmë.

Ose, po e lexoj, nenin 7, paragrafi 3. Është komplet i paqartë. Çka kemi për të bërë në këtë? Thotë: kërkimi i personit të zhdukur vazhdon deri sa fati dhe nëse është e mundur..., mandej vazhdon. Komplet, i pakuptimtë. Ndoshta është lënë me qëllim pa kuptim, por ne duhet t'ia japim kuptimin. Dhe nuk e di qysh ia japim kuptimin dhe ku e kanë pas esencën. Nëse e kanë pasur për me cituar Ligjin e procedurës kontestimore, s'ka pas nevojë me nxjerrë ligj sepse atje është e shkruar shumë qartë dhe më qartë se në këtë ligj.

Dhe, të ndalem vetëm edhe për një, me qëllim që mos të ju marr kohë. Që në nenin 17 – për mbikëqyrjen. Mbikëqyrja thotë, monitorimi i zbatimit të këtij ligji është përgjegjësi e autoritetit mbikëqyrës të zyrës së kryeministrit. Nuk qëndron. Ndoshta për zbatimin po, por mbikëqyrja bëhet edhe prej autoriteteve tjera edhe prej institucioneve tjera dhe nuk duhet të shkojmë... Ose, neni 18, thotë – Komisioni qendror që bëhet këtu, t'i kryejë detyrat e saj pa paragjykim ndaj ligjit për mjekësinë ligjore. Nuk di qysh kemi me rregulluar, çfarë paragjykimi.

Dhe, neni 18, thotë: ... mandej vazhdon, neni 19, hyrja në fuqi. Prandaj, është mirë duke pas parasysh rëndësinë që e ka kjo kategori e njerëzve, është mirë të mendojmë a duhet të ketë, sepse për të drejta nuk flet ligji, në qëllim, thotë, flet për të drejtat, absolutisht jo. Këtu krejt qëllimi i ligjit ka qenë me rregullua statusin e kësaj kategorie që ka humb në këtë periudhë kohore.

Dhe e dyta, qëllimi ka qenë që t'i jepet legjitimitet Komisionit qendror që do të formohet me ligj, të drejtat dhe përgjegjësitë janë përcaktuar me një ligj tjetër, ndoshta është mirë që t'i bartim këtu, por të drejtat janë përcaktuar atje.

Prandaj, është mirë që t'i qartësojmë këto, e mos të kemi dilema, sepse edhe kështu po kemi probleme të shumta. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Ismajl Kurteshi. Racionalizoni kohën, sa të mundeni!

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit, kryetar!

Vërejtjet që unë i kisha planifikuar t'i bëj, i bënë deputetët në diskutimet e tyre paraprake, prandaj unë heq dorë nga diskutimi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit shumë, korrekt ishte! E ka fjalën Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuar zotëri kryetar,

Nuk ka diskutim se teksti i këtij dokumenti është i dobët dhe me të vërtetë i dobët. Është i paqartë dhe unë çuditë si njerëzit që e marrin një detyrë kaq serioze, të jenë aq pak seriozë për ta bërë një punë, së paku, në nivelin e normales, s'po them për diçka superiore! Kjo është një.

E dyta, ka vërejtje, por nuk do të ndalem. Do të ndalem vetëm në një prej tyre. Në qoftë se e marrim një person, një primus, ia dëmton auto-veturën sekundesit, po që të jetë ky fajtor, qoftë e vlerës 1.000 euro, po mund të jetë edhe 100.000 euro, aty menjëherë hapet procedura e zhdëmtimit. A këtu, është fjala për numër enorm të personave të humbur dhe angazhohem me pikëpamjen e zotit Dugolli që t'i quajmë persona të humbur, jo të zhdukur, dhe asgjë askujt. Medoemos angazhohem që komisioni ta ketë monitorimin, nëse s'gabo, neni ishte diku 17, që ta ketë edhe këtë prerogativë, që të përgatitë dokumentet e nevojshme sepse do të ketë të dhëna, dokumentet e nevojshme, do të thotë, instrumentet juridike për kërkesë padi civile për ri-mbursim të dëmit nga dëmtuesi fajtor. Kjo duhet të bëhet medoemos, këtë e bëjnë shtetet kontemporare, e kanë bërë edhe para neve. Momenti i fundit është, këtë adut, dikush thotë aty, ne duhet ta promovojmë sepse na

duhet për kundër-balancë makropolitike, e tjera. Gjithsesi, kjo shkon në interesin e të dëmtuarit të pafajshëm. I dëmtuari/e dëmtuara e pafajshme meriton mbrojtje, në këtë rast, të shtetit.

Unë angazhohem që koncepti i këtij dokumenti të jetë këtu i fokusuar më tepër, natyrisht disa norma duhet të riformulohen dhe të plotësohen, e tjera. Ju falënderohem!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Naim Rrustemi.

NAIM RRUSTEMI: Faleminderit për fjalën!

Shumë prej sugjerimeve u dhanë nga kolegët deputetë dhe mendoj se komisioni përgjegjës do t'i marrë parasysh të gjitha këto rekomandime, që mos të përsëriten më me të tjerat. E përshëndes që është ardhur ligji, fillimisht dhe rekomandimet që u dhanë prej kësaj sale do t'i marrë komisioni përgjegjës, do t'i inkorporojë në ligj.

Do të ndalesha unë vetëm në një pikë, në nenin 6 të këtij ligji, kur flitet për të drejtat e familjarëve në lidhje me statusin ligjor të personave të zhdukur, konkretisht me paragrafin 1, ku statusi civil të bashkëshortit apo bashkëshortes të një personi të zhdukur... Kisha pasur dëshirë që komisioni përgjegjës kur ta trajtojë këtë ligj, ta shikojë nga këndvështrimi se ne jemi në përpjekje për krijimin e një shoqërie etike. Dhe, sipas mendimit tim personal, ky nen është disi peng, peng i të gjallëve. Sepse, në rast se ne e mbajmë statusin civil të pandryshuar, pavarësisht rrethanave, nuk lejojmë në asnjë rrethanë të ndryshohet statusi civil i të gjallit, i personit familjar të gjallë, bashkëshortit në këtë rast apo bashkëshortes, atëherë në njëfarë forme ne nuk po i krijojmë perspektivë për të krijuar jetën. Unë e kuptoj se ligji është pak sa i prekshëm, është emocional, është emotiv, por ne në këtë shoqëri etike kemi respekt ndaj të pagjeturve, por në të njëjtën kohë kemi konsideratë për familjarët e tyre që të jetojnë në harmoni me disa principe etike. E në rast se kalon ky nen ashtu siç është – familjarët, të afirmimit e personave të gjetur, ndoshta do të realizojnë ambiciet e veta për të jetuar dhe për të jetuar në mënyrë sa më dinjitoze që e kanë të mundshme, por ky nen i parandalon, i pengon për të jetuar nga aspekti jetik, ata janë të detyruar që të marrin hapa alternativë për t'u liruar nga pengi i statusit civil.

KRYETARI: Faleminderit! Vazhdojmë! Fjalën e ka deputeti Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryetar!

Do të mundohem sa më shkurt të flas. Kur është fjala te ky ligj, duhet pasur parasysh rregullimin e statusit dhe të drejtave të personave të pagjetur dhe të familjarëve. Pse po e them këtë? Për arsye se edhe në Ligjin që e kemi pas në shqyrtim herën e kaluar për familje të dëshmorëve, veteranët, kategoritë tjera civile, kemi thënë se në paket nuk po mund të shkojmë, prandaj ndarja më mirë është të bëhet dhe për mendimin tim është që në këtë ligj duhet të definohet statusi dhe të drejtat.

Njëkohësisht, mendoj se duhet të jetë termi – të pagjetur, për arsye se ka dhjetë vite që edhe më tutje kërkesat janë të vazhdueshme deri në personin e fundit që konsiderohet i pagjetur, jo i zhdukur sepse derisa po gjenden mbetjet nga personat të cilët kanë pësuar në luftë nuk mund t'u themi të zhdukur. Prandaj, në terminologji duhet të kemi kujdes dhe unë konsideroj se në komision duhet të punohet shumë dhe mirë për shkak se është çështje shumë e ndjeshme, është e ndjeshme për familjarët, është e ndjeshme për të gjithë neve të cilët mendojmë se duhet të rregullohet kjo çështje me ligj dhe të kenë status dhe të drejtat e tyre. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Unë thashë se i fundit është Naser Rugova dhe deputeti Naser Rugova e ka fjalën.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuara nëna nga shoqata “Thirrje të nënave” që prezantoni sot në këtë seancë, ku po diskutojmë një projektligj shumë të rëndësishëm, edhe pse me një dekadë vonesë.

Unë do t’i them shkurt pesë çështje, që mendoj se duhet të trajtohen shumë seriozisht dhe vërtet ky ligj ta definojë mirë e qartë edhe statusin e personave të pa gjetur por edhe të familjeve të tyre.

Nën 1. Kam vërejtje te titulli i ligjit dhe përkufizimi i datave. Duhet të gjithë që vërtet të japim impute konkrete dhe ta definojmë mirë, sepse po bëjmë ligj. Nuk është rregullore kjo.

Nën 2. Ky ligj është shumë përshkrues. Duhet të jetë më substancial, ka mjaft paqartësi, vakuume dhe interfereime.

Nën 3. Asociacionet për shoqatat e familjarëve të personave të pagjetur duhet të jenë pjesë aktive dhe pjesëmarrës aktivë në hartimin e këtij ligji, në procedurat e mëtutjeshme.

Nën 4. Ky ligj duhet të harmonizohet me ligje tjera, në veçanti me Ligjin për të drejtat e veteranëve të luftës, pjesëtarët e UÇK-ës, invalidëve, pastaj viktimave civile e tjera.

Nën 5. Personat e të pa gjetur dhe të familjeve të tyre, duhet të kenë një tretman të veçantë sepse po e bëjmë një ligj të veçantë për ta dhe gjithashtu janë edhe disa çështje që lidhen me Ligjin për mjekësinë ligjore dhe autopsinë që ekspertët, edhe deputetë këtu që i kemi mjaft nga komisionet funksionale por edhe ekspertë tjerë, vërtet ta bëjmë një ligj si duhet dhe që shteti i pavarur i Kosovës të vë dorë dhe të përkujdeset në mënyrë dinjitoze për këtë kategori të veçantë të shoqërisë kosovare. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar deputetja Saniye Aliaj, krejt e fundit dhe shkurt!

SANIJE ALIAJ: Faleminderit!

Zoti kryetar, nuk e pata ndërmend ta marr fjalën, por si anëtare e komisionit që kam pasur në vazhdimësi takime me kryefamiljarët dhe shoqatat për personat e pa gjetur, për këtë projektligj, në radhë të parë i kam disa propozime, sepse kemi të bëjmë me dy projektligje – Projektligjin për personat e zhdukur dhe Projektligjin që e kemi miratuar për kategoritë e luftës, ditë më parë, në lexim të parë.

Kërkesa ime është se me këtë projektligj duhet në mënyrë të saktë, me nene e paragrafë të përcaktohet statusi i personave të zhdukur dhe familjeve të tyre. Kurse me projektligjin për kategoritë e luftës së fundit të UÇK-ës definohej dhe e tërë materia është për të drejtat e familjarëve që kanë persona të zhdukur.

Dhe, kërkesa ime është se, unë e di, termi ndërkombëtar për ligjin, ligji duhet të emërtohet me – Ligji për persona të zhdukur, ku nënkupton personat që janë zhdukur gjatë luftës së fundit dhe personat që zhduken në rrethana tjera. Pra, duhet të definohet edhe me këtë projektligj për të drejtat dhe përkujdesin institucional për familjet sepse të dashurit e tyre janë zhdukur gjatë luftës dhe se a i gëzojnë të drejtat dhe benificionet personat tjerë të zhdukur në rrethana tjera.

Pra, kjo materie nuk është e përfshirë, është mirë që me këtë projektligj komisioni funksional ta ketë parasysh, natyrisht se gjatë punës së komisioneve funksionale duhet të ftohen edhe kryefamiljarët apo shoqatat të cilat i udhëheqin asociacionet për persona të pagjetur sepse ligji ka

nevojë të begatohet dhe vërtet t'i garanton të drejtat e këtyre kategorive që deri më tani me plotë të drejtë mund të them se kanë mbetur pa përkujdesje institucionale. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk kemi më të lajmëruar. A ka numër të mjaftueshëm për të votuar?

Unë kisha kërkuar që, vërtet, komisionet përkatëse, tani dhjetë ditë para se të vjen ligji në seancë, kanë mundësi ta shqyrtojnë ligjin dhe komisionet përkatëse le ta shikojnë ligjin, e nëse ligji nuk i plotëson kriteret për të ardhur në Kuvend, mos të vjen, le të shtyhet... Unë po ju tregoj se në disa parlamente, në parim, për ligje flasin shefat e grupeve parlamentare. Prej deputetëve flasin të pavarurit që s'kanë grup parlamentar. Puna për bërjen e ligjit është te komisionet. Mirëpo, megjithatë, ne kemi krijuar një praktikë tjetër.

Për disa, vendosja e disa shpjegimeve. Janë disa standarde që nuk e di a mund t'i ndryshojmë ne. Prandaj, duhet të shkojmë sipas standardeve që janë vendosur, siç është edhe çështja e luftës apo e konfliktit të armatosur, janë do standarde që i ka vendosur dikush tjetër dhe ne s'mund fort t'i ndryshojmë. Ne mund të mbarojmë qejf si të duam, por janë do standarde që janë vendosur dhe ne s'mund t'i ndryshojmë.

Unë kisha dëshiruar që komisionet dhe ata që dëshirojnë të ndihmojnë komisionet, të jenë pjesë e punës së amendamentimit të ligjit, natyrisht edhe unë jam që të përfshihen jo vetëm familjarët e njerëzve të pa gjetur apo të zhdukur, si të doni po themi, por është e njëjta gjë gati dhe të gjithë ata që mund të kontribuojnë që vërtet të bëhet një ligj sa më i mirë.

Për votim, pasi kemi të pranishëm 57, edhe një tash erdh u bënë 58, mendoj ta lëmë për në vazhdim të seancës kur fillojmë me amendamente dhe duhet të kemi nga fillimi numrin mbi 61 deputetë, kështu që po e lëmë pas pauze. A jeni dakord? Faleminderit! Pauzë po bëjmë deri në ora 15:00 dhe në ora 15:00 do të vazhdojmë seancën.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYETARI I KUVENDIT: Të nderuar deputetë, fillojmë punën.

Në sallë kemi 62 deputetë, e tash u bëmë 63, që do të thotë se mund të shkojmë në procedurën e votimit.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë në parim Projektligjin për personat e zhdukur. Votojmë tash:

Ndërkohë kanë ardhur edhe 3 deputetë. Konstatoj se me 63 vota "për", asnjë "kundër" dhe asnjë "abstenim", Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për personat e zhdukur.

Në bazë të Rregullores, Kuvendi ngarkon këto komisione:

- Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, si komision funksional dhe raportues;
- Komisionet e përhershme.

Komisionet duhet që në afatin më të shpejtë të mundshëm Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

Vazhdojmë me pikën e radhës:

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për financimin e subjekteve politike

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për financimin e subjekteve politike dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij, me amendamentet e propozuara.

Para se të procedojmë me votimin e amendamenteve, ftoj kryetarin e komisionit... ose nëse nuk është paraqitur askush, vazhdojmë me votim. A jeni dakord? Atëherë, po vazhdojmë.

Votojmë amendamentin 1 dhe votojmë tash:

Me 56 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Në sallë kemi 69 deputetë.

Me 50 vota “për”, 2 “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Votojmë tash:

Me 56 vota “për”, asnjë “kundër”, 5 abstenime, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Votojmë tash:

Me 54 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5.

Votojmë tash:

Me 61 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6.

Votojmë tash:

Me 56 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7.

Votojmë tash:

Me 55 vota “për”, asnjë “kundër”, 5 abstenime, miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8.

Votojmë tash:

Me 57 vota “për”, 1 “kundër”, 5 abstenime, miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9, është i deputetes Melihate Tërmkolli, pa mbështetje të komisionit funksional. Amendamenti 9 ka vetëm një variant dhe është i deputetes Melihate Tërmkolli.

Votojmë tash:

Me 25 vota “për”, 19 “kundër”, 8 abstenime, miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10.

Votojmë tash:

Kam përshtypje, se deputetët nuk po i lexojnë amendamentet!

Me 48 vota “për”, 2 “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11, i deputetes Melihate Tërmkolli, pa përkrahjen e Komisionit.

Votojmë tash:

Urdhëroni! Deputeti Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Tash është me vonesë, kryetar, sepse amendamenti u votua, por unë si anëtar i Komisionit për Buxhet e Financa po shpreh një shqetësim dhe ka të bëjë me financimin e subjekteve politike e jo të organizmave politikë brenda për brenda partive politike. Prandaj, nëse krijohen këso paralelizmash të financimit nga buxheti i Republikës së Kosovës, kjo nuk do të mund të realizohet, prandaj këto dy nene janë të pazbatueshme në praktikë. Faleminderit!

KRYETARI: ...Mirëpo, ligji është i pazbatueshëm dhe unë po kërkoj të jeni në përgjegjësinë e deputetit. Ky ligj duhet të kthehet dhe ky ligj kështu siç është do të jetë i pazbatueshëm. Ju lutem, lexoni amendamentet dhe dikush e ka përgjegjësinë, e ju si komision është dashur në fillim ta merrni fjalën. Ju lutem!

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

Fjalën e ka Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Zoti kryetar,

Është mirë të mos ngutemi fort dhe në rend të parë komisioni funksional nuk i ka prezantuar Komisionit për Legjislacion asnjërin nga amendamentet e deputetes. Dhe, ju lutem të na e jepni fjalën kur e kërkojmë! Dhe, kjo që po ndodh tash, është kundërligjore. Ne kemi dhënë rekomandime nga Komisioni për Legjislacion dhe i ka përkrahur komisioni, është krejt në rregull, është rregull kjo. Mirëpo, amendamentet në fjalë nuk kanë qenë në komisionin funksional dhe, zoti kryetar i komisionit, të kisha lutur, ligjet nuk jemi për t'i bërë sa për t'ia mbarur qejfin dikujt. Këto ligje duhet të zbatohen. Këto ligje janë edhe nga aspekti ndërkombëtar në Raport të progresit. Dhe me këtë që votuam, ne po biem në kundërshtim me ligjet në fuqi. Forumi i grave nuk është subjekt i veçantë politik, prandaj ne e kemi financimin e subjekteve politike dhe jo as të organizatave të burrave e as të grave, prandaj kërkojmë për shkak se nuk kanë qenë në Komisionin për Legjislacion, që desha ta marr edhe fjalën....

O, kryetar, po ti në fillim, më the mos e merr fjalën, allahile! A the mos e merr fjalën?

KRYETARI: Me propozimin e kryetarit të Komisionit për Legjislacion, e tërheqim votimin dhe votojmë edhe një herë.

Votojmë amendamentin 9, të deputetes Melihate Tërmkolli, pa përkrahjen e Komisionit. Votojmë tash:

(Ndërhyrje e deputetes)

Me 6 vota “për”, 26 “kundër”, 7 abstenime, nuk miratohet amendamenti 9.

Votojmë amendamentin 11, i deputetes Melihate Tërmkolli, pa përkrahjen e komisionit funksional.

Votojmë tash:

Me 16 vota “për”, 24 “kundër”, 9 abstenime, nuk miratohet amendamenti.

Deputeti, Armend Zemaj, meqë jeni në Komision, unë kërkoj një sqarim për amendamentin 12 të komisionit funksional. Unë e kam një kërkesë, po unë po kërkoj edhe sqarim nga ti.

ARMEND ZEMAJ: Urdhëro!

KRYETARI: Dhe unë kam kërkesë që:

- Në amendamentin 12, të propozuar nga komisioni funksional, paragrafi 1, i cili thotë “për financimin e aktiviteteve të rregullta të subjekteve politike, mjetet nga fondi për mbështetjen e subjekteve politike, ndahet në mes subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvend në bazë të numrit të ulëseve, të fituara për atë mandat”. Të “fituara” të shlyhet dhe të mbetet numri “të ulëseve për atë mandat”.

ARMEND ZEMAJ: Në rregull!

KRYETARI: Sepse, këtë çështje e përcakton Kushtetuta. A jeni dakord? Faleminderit! Pra, tash votojmë amendamentin 12, me propozim që të fshihet fjala “të fituara”. Votojmë tash:

Në sallë kemi 64 deputetë.

Me 51 vota “për”, 2 “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 12.

Vazhdojmë amendamentin 13.

Votojmë tash:

Me 51 vota “për”, 1 “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 13.

Amendamenti 14, i ka dy variante:

1. Varianti i parë, është i komisionit funksional, kurse
2. Varianti i dytë, është i deputetit dhe ministrit Mahir Yagcilar, pa përkrahjen e komisionit funksional.

Urdhëro, merre fjalën, ministër!

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuari ministër,

Përafërsisht problemi është i njëjtë, sepse edhe këtu përmendet “fituar”. Mendoj se duhet të hiqet. Ka qenë vetëm kërkesa të jetë e qartë, a janë 120 vende a 100 vende. Kurrëgjë tjetër. Prandaj, edhe në këtë rast duhet të fshihet vetëm fjala “fituar”.

KRYETARI: Unë e kam të qartë! Mandatet fitohen edhe me vota të drejtpërdrejta edhe me vende të garantuara, të rezervuara, krejt e njëjta gjë është, por në Kushtetutë s’është, e po e heqim edhe këtu, po e lëmë “të vendeve në Kuvend”. Urdhëro, Armend!

ARMEND ZEMAJ: Është në rregull nëse pajtoheni gjuhësisht, por ne e kemi bërë të qartë. Mandati i fituar, mandati i ndarë, është mandat, edhe me Kushtetutë, edhe me ligj ne llogarisim mandat dhe ulëse të deputetit, pa marrë parasysh mënyrën se si vjen, vend i rezervuar, pas justifikimit është mandat i fituar. Krejt në rregull, pajtohem me këtë që të jenë mandate të ndara. Çështja që e kërkon deputeti dhe është që të merret për bazë 60% e mjeteve financiare të ndahen në bazë të numrit të

vendeve të ndara sipas rezultateve të zgjedhjeve të fundit qendrore. Kjo nuk mund të bëhet, sepse ne kemi zgjedhje lokale dhe kemi zgjedhje qendrore, prandaj këtu kemi dashur që, nëse mbahen zgjedhje lokale, merret ajo statistikë, për zgjedhjet qendrore merret statistika, prandaj këtu është komisioni i cili nuk e përkrah këtë amendament. Ndërsa, ndryshimin gjuhësor ne jemi pajtuar, edhe atëherë ta përkrahim, por edhe sot edhe atëherë llogarisim që ulësja e deputetit është mandat, pa marrë parasysh a është e ndarë apo e fituar.

KRYETARI: Unë e kam një propozim për të dalë nga kjo. Do të thotë, nuk po e votojmë variantin e deputetit, por po e bëjmë “vende të fituara dhe të garantuara” për ta plotësuar. Urdhëro! Jo, duhet ta shlyejmë, se pasi e shlyem lartë, po e shlyejmë edhe poshtë. Fjalën e ka deputeti Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, kryetar!

Këto çështje po shkojnë duke u rritur dhe duke u agzagjeruar pa kurrfarë nevoje. Në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, që është në fuqi, neni 1 thotë: “vendet e fituara” dhe pastaj shkon dhe i sqaron vendet e garantuara dhe të tjera. Por vendi i deputetit, pavarësisht nëse është ose jo i garantuar, i rezervuar, i fituar drejtpërdrejt është vend i fituar me Kushtetutë. Shikojeni pjesën e parë të Kushtetutës ku flet për Kuvendin. Prandaj, nuk e di pse do të duhej sqaruar... Ose ta bëjmë vetëm me vendet në Kuvend, por Kushtetuta e sqaron shumë mirë në fillim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Po, unë mendoj pasi e shlyem një herë “të fituara” dhe “të fituara” po e shlyejmë në tërë ligjin. A jeni dakord? Atëherë, votojmë për amendamentin 14 të Komisionit funksional, me vërejtjen që të fshihet fjala “të fituara”. Votojmë tash:

Me 58 vota “për”, 1 “kundër”, 5 abstenime, miratohet amendamenti 14.

Urdhëro, Ibrahim! Ibrahim Makolli e ka fjalën!

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, kryetar! Po kërkoj vetëm edhe një herë që ta shikoni mirë, sepse kjo mund të bie në kundërshtim pastaj me një rregull këtu që është, që “deputeti nëse lëviz nuk mund të bartë mjetet në atë grup”. Dhe nëse themi me vendet në Kuvend, vendet në Kuvend maten pastaj me numrin e deputetëve në Kuvend. Nëse nuk e themi, me vota të fituara ose me vende të fituara, lëvizja pastaj e deputetëve në vend brenda grupeve parlamentare, e tërheq me veti edhe një pjesë, bie në kundërshtim me këtë që e kemi të shkruar.

KRYETARI: Bie në kundërshtim, se vlen ajo që thuhet në Kushtetutë.

IBRAHIM MAKOLLI: Në kushtetutë, po, por cili është, si i thoni ju këtu, sa vende i ka partia.

KRYETARI: Urdhëro, Bahri Hyseni e ka fjalën.

BAHRI HYSENI: Jo, nuk bie në kundërshtim, sepse buxheti ndahet me vende të fituara në fillim, mandej ligji e sqaron. Lëvizjet e mëtutjeshme nuk e ndryshojnë buxhetin.

KRYETARI: Faleminderit! Vazhdojmë! Votojmë amendamentin 15. A ka vërejtje në amendamentin 15? Më fal, Ardian, se nuk të vërejta. Fjalën e ka Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, kryetar!

Vetëm dy fjalë. Domethënë, është parim i demokracisë edhe Kushtetuta jonë e merr për bazë si parim që mandati është i deputetit, jo i partisë. Po edhe nuk guxojmë ne të kemi provizione të cilat

krijojnë rrethana në të cilat thuhet se mandati është i dikujt, çuditshëm, që është parti e jo i deputetit që e ka marrë. Mandati është i deputetit. Faleminderit!

KRYETARI: Vazhdojmë.

Votojmë me amendamentin 15 dhe votojmë tash:

Me 54 vota “për”, 1 “kundër”, 5 abstenime, miratohet amendamenti 15.

Amendamenti 16.

Votojmë tash:

Me 53 vota “për”, 1 “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 16.

Amendamenti 17.

Votojmë tash:

Me 55 vota “për”, 1 “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 17.

Amendamenti 18.

Votojmë tash:

Me 56 vota “për”, 2 “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 18.

Amendamenti 19.

Votojmë tash:

Me 56 vota “për”, 2 “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 19.

Amendamenti 20.

Votojmë tash:

Me 54 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 20.

Amendamenti 21.

Votojmë tash:

Me 52 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 21.

Amendamenti 22.

Votojmë tash:

Me 54 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 22.

Amendamenti 23 dhe i fundit.

Votojmë tash:

Me 60 vota “për”, asnjë “kundër”, 5 abstenime, miratohet amendamenti 23.

Tani në sallë kemi 69 deputetë.

Votojmë Ligjin në tërësi dhe votojmë tash:

Me 56 vota “për”, 3 “kundër”, 3 abstenime, Kuvendi miratoi Ligjin për financimin e subjekteve politike.

Ne e kryem këtë ligj, mirëpo edhe një herë po kërkoj nga deputetët dhe mendoj se edhe administrata e ka një lloj përgjegjësie për amendamentet që nuk janë në kuadër të ligjit, të mos futen as për t’u votuar as “për”, as “kundër”. Amendamentet që fillimisht janë votuar “për”, nuk kanë qenë amendament për këtë ligj. Ligji është bërë për financimin e partive politike, jo për organizime tjera jashtë partive politike.

Vazhdojmë me pikën e radhës:

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij, me amendamentet e propozuara.

Para se të procedojmë me votimin e amendamenteve, ftoj kryetarin e Komisionit funksional për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, Esat Brajshorin...Meqë nuk është Esati, atëherë ftoj deputetin Hajredin Hyseni, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime. Fjalën e ka deputeti Hajredin Hyseni.

(Ndërhyrje e deputetes)

Kemi hyrë në procedurë, ju lutem! Deputete, fjalën nuk ta jap, por fjalën e merr kur vijmë te amendamentet, kur bëhet fjalë për atë amendament. Tash e ka fjalën raportuesi i Komisionit. Dhe, ky është rendi i fjalëve, e jo kur të doni ju ta merrni fjalën.

HAJREDIN HYSENI: Faleminderit, zoti kryetar!

Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe media, e ka shqyrtuar Projektligjin për Administratën Shtetërore, duke shqyrtuar edhe vërejtjet e komisioneve tjera, po edhe të deputetëve dhe propozimet e tyre.

Komisioni ka punuar në këtë projektligj duke ditur rëndësinë që e ka ky projektligj për funksionimin e institucioneve të Kosovës dhe duke pasur parasysh se me aprovimin e këtij projektligji përmbushet një nga pikat e Raportit të progresit që duhet t'i përmbushë Kuvendi i Kosovës, andaj thërras për t'i aprovuar amendamentet e propozuara nga komisioni me çka do të bëhet një ligj funksional për administratën shtetërore. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ju lutem, meqë ka qenë një gabim teknik, më duhet të them se amendamenti i deputetes Teuta Hadri, pa përkrahjen e Komisionit funksional, është i radhitur.

(Ndërhyrje e deputetes)

Ka qenë një gabim teknik, por është i radhitur. Prandaj, mos i jepni zjarr shumë! Teuta, a e do fjalën? Urdhëro, merre fjalën!

TEUTA HADRI: Faleminderit! Është hera e parë që ma dhe tamam kështu fjalën, si duhet. Zoti kryetar, unë ndoshta prita të vijmë amendamenti, mirëpo besoj se deputetët duhet ta kanë që qartë se për 24 orë s'kanë mund ta shqyrtojnë në komision mendimin me të cilin këta kanë dalë së pari në raport, që duhet të fshihet amendamenti. Pra, edhe nëse nuk përkrahet, unë e kam obligim t'ua shpjegoj deputetëve se duhet të jetë amendamenti dhe duhet të analizohet amendamenti këtu, sepse ka qenë amendament i gabuar edhe në mandatin e diskutimit të parë, në parim, unë e kam thënë, asnjë deputet nuk më ka kundërshtuar, as kryetari i komisionit, as anëtarët, kështu që mendoj se ka qenë në parim atje si amendament i propozuar. Mendoj se duhet të pranohet.

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Hajredin Hyseni e ka fjalën.

HAJREDIN HYSENI: Faleminderit, zoti kryetar!

Vërtet, mos radhitja e amendamentit të deputetes, besoj se është një çështje teknike, sepse komisioni e ka shqyrtuar amendamentin dhe komisioni ka konstatuar se ai amendament është i përfshirë në amendamentin e komisionit dhe për këtë edhe nuk e kemi përkrahur. Mirëpo, mos radhitja, do të thotë është shqyrtuar, mund të jetë një çështje e gabimit teknik.

KRYETARI: Vazhdojmë! A jeni dakord të vazhdojmë? Faleminderit!
I votojmë amendamentet.

Amendamenti 1.

Votojmë tash:

Me 55 vota “për”, 2 “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Votojmë tash:

Me 48 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Në sallë kemi 69 deputetë.

Votojmë tash:

Me 53 vota “për”, 1 “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Votojmë tash:

Me 59 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5.

Votojmë tash:

Me 53 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6.

Votojmë tash:

Me 53 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7.

Votojmë tash:

Me 58 vota “për”, 1 “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8, i deputetes Teuta Hadri, pa përkrahjen e komisionit funksional. Urdhëro, deputete, për sqarim!

TEUTA HADRI: Faleminderit! Unë dua të jem para deputetëve e qartë se qëllimi im kur e kam propozuar këtë amendament ka qenë jo teknik, si tha zoti Hajredin, por ka qenë kuptim përmbajtjesor, se është fjala “dekoncentrim”, e kam sqaruar edhe në mandat, në afatin e diskutimit në Parlament, në shqyrtimin e parë, se kjo fjalë “dekoncentrim” të gjithë e dimë çka do të thotë koncentrim dhe dekoncentrim, është avari, është shkarkim, nuk dihet ku ti do të koncentrohesh dhe çfarë lokali do ti të përfshish në rrethin e ngushtë lokal. Prandaj, unë e kam sqaruar shumë mirë në amendament, pra mbetet te deputetët... Unë jam në interes të ligjit, se kjo “dekoncentrim” s’di çka doni të kuptoni. Faleminderit!

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

KRYETARI: Cili është mendimi i komisionit? Të votohet! Mirë! Të votohet, por votimi është “për” dhe “kundër”. Mirë, atëherë e votojmë amendamentin 8 të deputetes Teuta Hadri, pa mbështetje të komisionit funksional.

Votojmë tash:

Me 28 vota “për”, 21 “kundër”, 9 abstenime, miratohet amendamenti 8.

Urdhëro! Deputeti Esat Brajshori e ka fjalën.

ESAT BRAJSHORI: Faleminderit, zoti kryetar!

Seriozisht, mendoj se duhet një koncentrim i deputetëve që ta dinë çka votojnë dhe pse votojnë. Në Kosovë ka dy pushtete dhe nuk ka nevojë që të nxirren amendamente të tilla. Ne e kemi trajtuar, nuk është e vërtetë se s’e kemi trajtuar në komision. E kemi trajtuar, mund t’iu referoheni procesverbaleve, zonja Teuta, nuk është që e kemi hedhur. Ngatërresa që është bërë me teknikën, në administratë sot, pse nuk e kanë sjell, nuk di dhe nuk është përgjegjësi e komisionit dhe e kryetarit. Ne e kemi trajtuar, kemi marrë ato pjesë të amendamentit tuaj që e kemi përfshirë në amendamente tjera çka ka pasur me interes. Unë mendoj që bile-bile ky amendament është edhe antikushtetues. Është Komisioni për Legjislacion e Gjyqësi që mund ta thotë më saktësisht fjalën e vet. Deputetët duhet të koncentrohen dhe të dinë çfarë po votojnë. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Edhe unë jam dakord që në Kosovë janë dy pushtete, edhe me Kushtetutë janë dy pushtete dhe administratë, përveç administratës qendrore dhe administratës komunale, nuk ka. Mendoj se ne duhet të shkojmë edhe një herë në rivotim. Urdhëro! Ta dëgjojmë çka do të thotë kryetari i Komisionit për Legjislacion. Bahri Hyseni e ka fjalën.

BAHRI HYSENI: Zoti kryetar, ne nuk do ta kishim lejuar të vijë fare amendamenti sepse është antikushtetues, po ka qenë një situatë që ky amendament fare s’ka qenë në Komision për Legjislacion. Prandaj, administrata duhet të ketë kujdes, së bashku me komisionin, edhe amendamentet e deputetëve duhet të përcillen përfundimisht me amendamentet e komisionit. Përndryshe, nuk e kishim lejuar fare të vinte, sepse dy pushtete janë, s’kemi çka të humbim kohë. Ne mund të votojmë sa të doni, por nuk dekretohet ligji.

KRYETARI: Ju lutem! Edhe unë jam i mendimit që ne duhet ta rivotojmë, se është antikushtetues dhe nuk mund ta votojmë dhe, ju lutem deputetë, bile këtu i lexoni pak përpara këto amendamente.

Votojmë edhe një herë amendamentin 8, të deputetes Teuta Hadri, pa përkrahjen e komisionit funksional.

Votojmë tash:

Me 5 vota “për”, 38 “kundër”, 9 abstenime, nuk miratohet amendamenti 8.

(Ndërhyrje e Driton Talit)

Ke të drejtë, Driton!

Tash e votojmë Amendamentin 9.

Votojmë tash:

Me 52 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10.

Votojmë tash:

Me 48 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11.

Votojmë tash:

Me 52 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 11.

Amendamenti 12.

Votojmë tash:

Me 53 vota “për”, asnjë “kundër”, 5 abstenime, miratohet amendamenti 12.

Amendamenti 13.

Votojmë tash:

Me 49 vota “për”, asnjë “kundër”, 5 abstenime, miratohet amendamenti 13.

Amendamenti 14.

Votojmë tash:

Me 54 vota “për”, asnjë “kundër”, 5 abstenime, miratohet amendamenti 14.

Amendamenti 15.

Votojmë tash:

Me 55 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 15.

Amendamenti 16.

Votojmë tash:

Me 53 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 16.

Amendamenti 17.

Votojmë tash:

Me 57 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 17.

Amendamenti 18.

Votojmë tash:

Me 53 vota “për”, asnjë “kundër”, 4 abstenime, miratohet amendamenti 18.

Amendamenti 19.

Votojmë tash:

Me 53 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 19.

Amendamenti 20.

Votojmë tash:

Me 52 vota “për”, asnjë “kundër”, 9 abstenime, miratohet amendamenti 20.

Amendamenti 21.

Votojmë tash:

Me 53 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 21.

Amendamenti 22.

Votojmë tash:

Me 54 vota “për”, asnjë “kundër”, 4 abstenime, miratohet amendamenti 22.

Amendamenti 23.

Votojmë tash:

Me 52 vota “për”, asnjë “kundër”, 4 abstenime, miratohet amendamenti 23.

Amendamenti 24.

Votojmë tash:

Me 55 vota “për”, asnjë “kundër”, 5 abstenime, miratohet amendamenti 24.

Amendamenti 25.

Votojmë tash:

Me 53 vota “për”, asnjë “kundër”, 4 abstenime, miratohet amendamenti 25.

Amendamenti 26.

Votojmë tash:

Me 53 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 26.

Amendamenti 27.

Votojmë tash:

Me 55 vota “për”, asnjë “kundër”, 5 abstenime, miratohet amendamenti 27.

Amendamenti 28.

Votojmë tash:

Me 50 vota “për”, asnjë “kundër”, 4 abstenime, miratohet amendamenti 28.

Amendamenti 29.

Votojmë tash:

Me 55 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 29.

Amendamenti 30.

Votojmë tash:

Me 53 vota “për”, asnjë “kundër”, 4 abstenime, miratohet amendamenti 30.

Amendamenti 31.

Votojmë tash:

Me 56 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 31.

Amendamenti i fundit, 32.

Votojmë tash:

Me 51 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 32.

Dhe, tani e votojmë ligjin në tërësi.

Në sallë kemi 70 deputetë.

Votojmë tash:

Pa kartelë? 2 vota. Faleminderit! “Kundër” a ka? Nuk ka!

Me 59 vota “për”, asnjë “kundër”, 4 abstenime, Kuvendi miratoi Ligjin për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës.

Në radhë është pika e gjashtë e rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për konfliktet administrative

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për konfliktet administrative dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij, me amendamentet e propozuara.

Para se të procedojmë për votim të amendamenteve, ftoj kryetarin e komisionit ose raportuesin, deputetin Esat Brajshori ta marrë fjalën.

ESAT BRAJSHORI: Faleminderit, zoti kryetar!

Tani, me idenë që të jemi më të përqendruar, unë po bëj rezymenë e këtij projektligji në mënyrë që kur të hyhet në votim, mos të ketë probleme të natyrës nganjëherë jo shumë të arsyeshme.

Pra, Komisioni ka përfunduar raportin me rekomandimet dhe ka shqyrtuar edhe raportet e komisioneve të tjera të ngarkuara për shqyrtimin e Projektligjit për konfliktet administrative dhe amendamentet e propozuara nga deputeti Riza Smaka.

Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, amendamentet e propozuara nga deputeti Riza Smaka nuk i ka përkrahur në formën siç i ka bërë, por janë të përfshira në amendamentet e komisionit. Komisionet funksionale nuk kanë pasur vërejtje dhe kanë rekomanduar që projektligji me amendamentet e propozuara mund të procedohet për shqyrtimin e dytë në mbledhjen plenare, me përjashtim të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, i cili komision, në raportin me rekomandime, pra për konfliktet administrative, ka dhënë këto vërejtje. I ka gjithsej 4 vërejtje:

1. Komisioni sugjeron të rishikohen amendamentet 1 objekti i ligjit dhe 2. qëllimi i ligjit, sepse këto dy nene kanë të njëjtën përmbajtje.
2. Amendamenti 5, të rishikohet fjala “përfundimtare”, sepse duhet të qartësohet se cilat akte janë përfundimtare.
3. Amendamenti 6, ka vërejtje në mospërfshirjen e referencave të neneve, si dhe është e panevojshme përfshirja e parimeve në këtë ligj, dhe
4. Amendamentet 7, 24, 25, 26 dhe 27 të Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media janë çështje që kanë të bëjnë me organizimin e gjykatave.

Tani Komisioni ynë ka vendosur, sipas kësaj radhitje:

Sa i përket vërejtjes së parë, ekziston dallimi në mes objektit dhe qëllimit të Ligjit.

Konsiderojmë se janë të domosdoshme ato dispozita, dallohet objekti, çka ka në përmbajtje pra ai ligj, cila është esenca përmbajtësore, rregullativa e tij, ndërkaq qëllimet e ligjit janë tjera, pra ka për qëllim t’i zgjidhë problemet e caktuara, konfliktet administrative dhe kjo duhet të mbetet, mendojmë ne.

Sa i përket vërejtjes së dytë, një vendim, një procedurë apo çështje e caktuar administrative, e cila merr formën e prerë, ajo është përfundimtare dhe atëherë mund të iniciohet vetëm konflikti administrativ.

Sa i përket vërejtjes së tretë, pra parimeve, i kemi futur parimet në këtë ligj sepse ndihmojnë shumë në zbatimin e tij dhe mendojmë që është më mirë të mbesin.

Dhe, sa i përket vërejtjes së katërt të Komisionit të respektuar për Gjyqësi dhe Legjislacion, Komisioni ynë vendosi që t'i heqë të gjitha ato amendamente që i ka propozuar ky komision, pra amendamentin 7, 24, 25, 26 dhe 27, sepse kjo çështje vërtet rregullohet me Ligjin për gjykatat.

Dhe, krejt në fund, dua të përkujtoj se edhe ky projektligj është i përfshirë në Raportin e progresit, andaj miratimi i tij do të ishte edhe një hap përpara nga ana e këtij Kuvendi në përmbushjen e infrastrukturës ligjore, planit të veprimit dhe normalisht Raportit të progresit. Faleminderit shumë!

Drejtimin e mbledhjes e merr zoti Ibrahim Gashi, anëtar i Kryesisë

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka kërkuar kryetari i Komisionit për Legjislacion, deputeti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Shkurtimisht! Pajtohem plotësisht, mirëpo vetëm mendoj që kryetari nuk e tha drejt – te objekti dhe qëllimi. Ne kemi pasur dy amendamente, tash në projektligj e keni bërë shumë mirë. Domethënë, keni intervenuar sepse ka qenë edhe objekti edhe qëllimi dhe është një, sepse tash s'i keni dy, por në amendamentet që i keni prurë në komision kanë qenë të dytë, kanë munguar referencat, që do të thotë kanë munguar paragrafet, nuk kemi ditur të cilit nen dhe ai ka qenë sugjerim që e keni përmirësuar dhe gjithçka është tash në rregull. Nuk kemi asnjë vërejtje! Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Të lajmëruar për diskutim nuk ka. Në sallë kemi 64 deputetë dhe mund të fillojmë me votimin e amendamenteve.

Atëherë, ftoj regjinë dhe deputetët të përgatiten dhe votojmë amendamentin e parë.

Amendamenti 1.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 54 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 2 abstenime, u miratua amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 51 vota “për”, 1 abstenim dhe asnjë “kundër”, u miratua amendamenti 2.

Te amendamenti 3.

Si po e shihni, kemi dy propozime: Fillimisht, votojmë propozimin e komisionit funksional.

Votojmë tash:

Me 53 vota “për”, 2 abstenime, asnjë “kundër”, u miratua amendamenti 3, versioni i komisionit funksional.

Vazhdojmë me amendamentin 4.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 52 vota “për”, 3 abstenime, asnjë “kundër”, u miratua amendamenti 4.

Amendamenti 5.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 52 vota “për”, 2 abstenime dhe asnjë “kundër”, u miratua amendamenti 5.

Amendamenti 6.

Votojmë tash:

Konstatoj e me 54 vota “për”, 3 abstenime dhe asnjë “kundër”, u miratua amendamenti 6.

Amendamenti 7. Kemi amendamentin e deputetit Riza Smaka, pa përkrahje nga komisioni.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 27 vota “për”, 24 “kundër” dhe 6 abstenime, u aprovua amendamenti 7 i deputetit Riza Smaka.

Shkojmë te amendamenti 8.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 45 vota “për”, 6 “kundër” dhe 3 abstenime, miratohet amendamenti 8, pra i deputetit Riza Smaka, po ashtu pa përkrahjen e komisionit.

Amendamenti 9.

Prapë i propozuar nga deputeti Riza Smaka, pa përkrahje të komisionit.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 25 vota “kundër”, 15 “për” dhe 9 abstenime, nuk aprovohet amendamenti 9.

Amendamenti 10.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 55 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 3 abstenime, miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 54 vota “për”, 3 abstenime dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 11.

Amendamenti 12.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 54 vota “për”, 2 abstenime dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 12.

Amendamenti 13.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 56 vota “për”, 2 abstenime dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 13.

Amendamenti 14.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 53 vota “për”, 2 abstenime dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 14.

Amendamenti 15.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 53 vota “për”, 2 abstenime dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 15.

Amendamenti 16.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 48 vota “për”, 2 abstenime dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 16.

Kisha lutur deputetët prezentë, të votojnë, mos të harrojnë, sepse kemi numër më të madh të deputetëve dhe më pak votues.

Amendamenti 17.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 51 vota “për”, 5 abstenime dhe 1 “kundër”, miratohet amendamenti 17.

Amendamenti 18.

Deputeti Riza Smaka, është propozues i këtij amendamenti, pa përkrahje të komisionit.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 30 vota “kundër”, 17 “për” dhe 10 abstenime, nuk miratohet amendamenti 18.

Amendamenti 19.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 48 vota “për”, 5 abstenime dhe 1 “kundër”, miratohet amendamenti 19.

Amendamenti 20.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 50 vota “për”, 4 abstenime, asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 20.

Amendamenti 21.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 50 vota “për”, 4 abstenime, asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 21.

Amendamenti 22.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 52 vota “për”, 3 abstenime, asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 22.

Amendamenti 23.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 53 vota “për”, 6 abstenime, asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 23.

Amendamenti 24.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 54 vota “për”, 4 abstenime dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 24.

Amendamenti 25.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 54 vota “për”, 3 abstenime, asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 25.

Amendamenti 26.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 50 vota “për”, 3 abstenime, asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 26.

Amendamenti 27.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 53 vota “për”, 5 abstenime, asnjë “kundër”, Kuvendi miratoi amendamentin 27.

Votojmë amendamentin 28, i fundit.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 55 vota “për”, 5 abstenime dhe asnjë “kundër”, Kuvendi miratoi amendamentin 28.

Dhe, tani lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votimin e Ligjit në tërësi. Të pranishëm janë 67 deputetë.

Kalojmë në votimin e Ligjit në tërësi. Regjia dhe deputetët, gati për votim dhe votojmë tash:

A ka pa kartelë “për”? 2. Konstatoj se me 60 vota “për”, 6 abstenime, asnjë “kundër”, Kuvendi miratoi Ligjin për konfliktet administrative.

Me këtë edhe përfundon pika e fundit e rendit të ditës për këtë seancë. Ju falënderoj dhe shihemi në seancat e radhës.

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve e Kuvendit të Kosovës